



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org.	Nr. Prot:
Org.Jединица	Broj Prot:
Org Unit	Prot.No: 05-6183
Nr.i faqeve	Data:
Br.stranica	Datum: 14.08.2025
No.pages	Date:
-110-	
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Zyra e Ministrat- Ured Ministra -Office of the Minister

Nr:115/VIII/2025

Datë:14.08.2025

Zëvendësministri i Ministrisë i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 11 dhe 16 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 12 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nëparografi 6.1, si dhe Kërkesës me nr. prot. 05-6099 datë 13.08.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Udhërrëfyesi Klinik „Menaxhimi i Osteoporozës”.
- II. Shtojcë e këtij vendimi është Udhërrëfyesi Klinik „Menaxhimi i Osteoporozës”.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Zëvendësministri i Shëndetësisë.

Dr. Arsim Berisha

Zëvendësminister i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- DPSSH;
- Departamentit ligjor
- Arkivit të MSh-së.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health

“MENAXHIMI I OSTEOPOROZËS”

UDHËRRËFYYES KLINIK

Këshilli Kosovar për udhërrëfyes dhe protokole klinike:

MSc. Niman Bardhi, PhD – Kryesues
Znj. Fatbardhe Murtezi – Anëtare
Dr. Shaban Osmanaj – Anëtar
Z. Mentor Sadiku – Anëtar
Dr. Teuta Qilerxhiu – Anëtare
Dr. Fakete Hoxha - Anëtare
Prof. Dr. Lul Raka – Anëtar
Prof. Dr. Prentim Rashiti – Anëtar
Dr. Valon Zejnnullahu – Anëtar
Dr. Lauras Idrizi – Anëtar
Z. Agron Bytyqi – Anëtar

Komisioni për vlerësimin e metodologjisë së adaptimit të udhërrëfyesve klinik:

Prof. Dr. Merita Berisha – Kryesuese
Dr. Drita Lumi – Anëtare
Prof. Dr. Valbona Zhjeqi – Anëtare
Dr. Merita Vuthaj – Anëtare
Mr. Sci. Ariana Qerimi – Anëtare

Grupi punues:

Dr. Jehona Ismaili – Kryesuese
Dr. Arta Baftiu – Anëtare
Dr. Ardiana Perjuci – Anëtare
Dr. Vjollca Hashani – Anëtar
Mr.Ph. Erblin Elezi – Anëtar

Përbajtja

I. HYRJE.....	7
1.1 Përse është hartuar ky Udhërrëfyes ?.....	7
1.2 Qëllimi dhe fokusi.....	7
1.3 Të dhënrat epidemiologjike	8
1.4 Popullata e cakut	9
1.5 Dedikimi.....	9
1.6 Pyetjet.....	10
II. METODOLOGJIA.....	12
2.1 Përshkrimi i procesit të zhvillimit të udhërrfyesit	12
III. REKOMANDIMET.....	14
3.1 Rekomandimet e fuqishme.....	14
3.2 Gradimi i rekomandimeve.....	14
3.3 AMSTAR2 gradimi i rishikimeve sistematike dhe metaanalizave	15
3.4 Menaxhimi jo farmakologjik i osteoporozës.....	16
3.5 Rekomandimet sipas kushteve dhe rr Ethanave.....	17
3.6 Përbledhje e Rekomandimeve Kryesore	17
3.7 Vlerësimi i riskut për fraktura në gratë pas menopauzës dhe burrat ≥ 50 :.....	18
3.7.1 Futja e FRAX kalkulatorit në njerëzit me faktorë klinikë të rezikut për fraktura fragjile:.....	18
3.7.2 Lidhur me trajimin me barna që të pengohen frakturat në gratë pas menopauzës dhe të menaxhohen pas moshës ≥ 50 :	19
3.7.3 Kur zgjidhet medikament për trajimin dhe pengimin efrakturave në gratë postmenopausale dhe meshkujt ≥ 50 :	19
3.7.4 Kur te femrat dhe meshkujt ≥ 50 vjeç është filluar trajtimi.....	20
3.7.5 Kur femrat dhe meshkujt ≥ 50 vjeç, trajtohen me glukokortikoide orale:	20
3.7.6 Kur duhet të jepen këshilla për stilin e jetës dhe regjimin dietetik:	20
3.7.7 Kur gratë në postmenopauzë apo meshkujt >50 vjeç kanë fraktura asimptomatike vertebrare:	21
3.8 Osteoporiza dhe frakturat fragjile.....	21
3.9 Vlerësimi i rezikut nga frakturat dhe gjetja e rasteve	22
3.9.1 Rekomandimet.....	22

3.10 Matja e densitetit kockor	25
3.11 Vlerësimi i faktorëve klinik të rrezikut	26
3.12 Mjetet për vlerësimin e faktorëve të rrezikut	28
3.13 Hulumtimet për Osteoporozën dhe frakturat fragjile	32
3.14 Vlerësimi i frakturave vertebrale.....	33
3.15 Skriningu dhe gjetja e rasteve	34
3.16 Strategjitë e pragut ndërhyrës.....	35
3.16.1 Rekomandimet.....	35
3.17 Vlerësimi i pragut të probabilitetit për frakturna 10 vjeçare përmes FRAX.....	36
3.18 Inicimi i medikamentit në kujdesin primar dhe sekondar	40
3.19 Inicimi i trajtimit në kujdesin sekondar.....	40
3.20 Medikamentet specifike opsoniale	40
3.20.1 Medikamentet antiresorbtive: Bisfosfonatet.....	40
3.20.2 Kundërindikacionet dhe paralajmërimet gjatë përdorimit të bisfosfonateve.....	43
3.20.3 Medikamentet antiresorbtive: Denosumab.....	43
3.20.4 Medikamentet antiresorbtive - Terapia zëvendësuese hormonale: (HRT).....	45
3.20.5 Medikamentet antiresorbtive: Calcitriol.....	45
3.20.6 Medikamentet antiresorbtive: Raloxifene	46
3.20.7 Medikamentet tjera: ranelate Strontium	46
3.20.8 Medikamentet anabolike:Teriparatide (hormone paratiroid human rekombinant [PTH]1-34)	47
3.20.9 Medikamentet anabolike: Romosozumab	48
3.20.10 Trajtimi me barna tek pacientët me rrezik të lartë për frakturna	49
3.20.10.1 Përbledhje e të dhënavë	49
3.21 Strategjitë për menaxhimin e osteoporozës dhe rrezikut nga frakturat	50
3.21.1 Kohëzgjatja dhe monitorimi i trajtimit me bisfosfonate	50
3.22 Rivlerësimi i rrezikut nga frakturat në individët nën trajtim me barna kundër osteoporozës	52
3.22.1 Rekomandimet.....	52
3.22.2 Përbledhje e të dhënavë evidente	53
3.23 Efektet anësore të rralla të terapisë afatgjatë me bisfosfonate dhe trajtimit me denosumab	53

3.23.1 Rekomandimet.....	53
3.23.2 Përbledhje e të dhënave	54
3.24 Osteoporoza e indukuar nga glukokortikoidet	55
3.24.1 Rekomandimet.....	55
3.24.2 Përbledhje e të dhënave	56
3.25 Përdorimi i terapisë deprimuese të androgjenit tek meshkujt	58
3.25.1 Rekomandimet.....	58
3.25.2 Përbledhje e të dhënave evidente	59
3.26 Gratë që marrin terapi me inhibitorë të aromatazës	60
3.26.1 Rekomandimet.....	60
3.26.2 Përbledhje e të dhënave	60
3.27 Menaxhimi frakturave vertebrale simptomatike	61
3.27.1 Rekomandimet.....	61
3.27.2 Përbledhje e të dhënave	62
3.28 Modelet e kujdesit për pengimin e frakturave.....	64
3.28.1 Rekomandimet.....	64
3.28.2 FLS modelet e kujdesit	64
3.28.3 FLS identifikimi i pacientit.....	65
3.28.4 Transmetimi i informatës tek pacienti, zbatimi dhe mbështetja.....	66
3.29 Rekomandimet për trajnim të pofesionistëve shëndetësorë	66
3.29.1 Rekomandimet.....	66
3.29.2 Përbledhje e të dhënave	67
3.29.3 Shembuj nga trajnimi përkatës	68
3.29.4 Rekomandimet për komisionerët e kujdesit shëndetësor	68
3.29.5 Rekomandimet.....	69
3.30 Rishikimi i kriterëve për përmirësim cilësor dhe afatgjatë	70
3.30.1 Standardet cilësore për Osteoporozë	70
3.30.2 Kujdesi primar	70
3.31 Përkrahja e pacientit për vetëmenaxhim të sëmundjes.....	71
3.32 Dhomat e edukimit dhe promovimit shëndetësor - ‘Këshillmorja’ për menaxhimin e sëmundjeve metabolike ”(SM).....	72

3.33 Kriteret e referimit te specialisti.....	72
IV. STANDARDET E AUDITUESHME	73
V. APLIKIMI DHE ZBATIMI I UK NË RRETHANA TONA	74
5.1 Implementimi në praktikë	74
5.2 Pikëpamjet dhe preferencat e popullatës së synuar.....	75
5.3 Procesi i Adaptimit.....	75
VI. LITERATURA	77
VII. SHKURTESAT	102
VIII. SHTOJCAT.....	103

I. HYRJE

1.1 Përse është hartuar ky Udhërrëfyes ?

Udhërrëfyesi Klinik “Menaxhimi i Osteoporozës” ka për qëllim standardizimin e menaxhimit të Osteoporozës, sëmundje kjo e cila meriton të ketë kujdes dhe trajtim bashkëkohor, në nivel me vendet e zhvilluara. Ky Udhërrëfyes i pari në Republikën e Kosovës, është punuar me shumë kujdes, gjithmonë mbështetur vetëm në të dhëna evidente të graduara të Udherrëfyesve bashkëkohorë të nxjerrë nga Shoqatat e Osteoporozës. Klinika e Reumatologjisë në QKUK në vitin 2012 ka themeluar Shoqatën e Osteoporozës (ASOK) në krye me të ndjerin prof Dr Sylejman Rexhepin, dhe po në këtë vit është mbajtur Simpoziumi i parë i Osteoporozës. Falë punës së palodhshme të reumatologëve tanë udhëhequr nga profesor Sylejman Rexhepi ne jemi anëtarësuar edhe në Shoqatën Botërore të Osteoporozës dhe Osteoartritit (IOF) në vitin 2015, andaj në vazhdimësi kemi pasur qasje në rekondimet e nxjerra nga kjo Shoqatë, si dhe Konferencat e mbajtura në qendra të ndryshme Evropiane. Vitet e fundit falë pajisjes së Qendrës Klinike Universitare me aparaturë të Densitetit Kockor DXA, është rritur dukshëm interesimi i pacientëve por edhe vetë profesionistëve shëndetësorë të niveleve të ndryshme në realizimin e matjes së Densitetit kockor. Ky senzibilizim i popullatës, profesionistëve shëndetësorë lidhur me Osteoporozën shpesh ka sjellë edhe paqartësi rrëth mjekimit, por shpesh edhe realizimin pa kriter të kësaj matje. Përmes këtij Udhërrëfyesi jemi munduar të paraqesim saktë indikacionet, kategoritë e rrezikuara, senzitivitetin dhe senzibilitetin e DXA scan. Ky Udhërrëfyes jep informacione të shumëta edhe për Medikamentet e shumëta, terapinë me suplemente, por edhe rolin e FRAZ që duhet t'u matet të gjithë pacientëve.

1.2 Qëllimi dhe fokusi

Qëllimi i adaptimit të këtij udhërrëfyesi është prezantimi i rekondimeve botërore, bashkëkohore të diagnostifikimit dhe trajtimit të Osteoporozës. Fokus i udhërrëfyesit janë pacientët e rritur pas moshës 18 vjeçare, ku osteoporoza mund të jetë sekondare nga sëmundjet inflamatore autoimune me karakter reumatizmal, osteoporozë e indukuar nga glukokortikoidet, sëmundjet endokrine. Po ashtu, gratë pas menopauses janë kategori që u kemi kushtuar shumë vëmendje gjatë hartimit të udhërrëfyesit me qëllim të sensibilizimit të kësaj kategorie por edhe gjithë popullatës, profesionistëve shëndetësorë të nivlit primar për orientimin korrekt të pacientëve drejt qendrave të kujdesit sekondar dhe terciar. Udhërrëfyesi ka për qëllim edhe hulumtimin e burrave me Osteoporozë pasi kjo sëmundje nuk lë pa prekur as ata. Udhërrëfyesi parashihet të përdoret nga profesionistët shëndetësorë në nivelin lokal dhe nacional. Qëllimi i këtij udhërrëfyesi është ndërgjegjësimi i profesionistëve shëndetësorë dhe pacientëve për rëndësinë e shëndetit kockor dhe rrezikun për fraktura në mesin e moshave të vjetra, identifikimin, vlerësimin adekuat të fragilitetit të kockës, me qëllim të reduktimit të frakturave, ruajtjen e lëvizjeve, cilësisë së jetës. Punuar nga

Grupi për rishikim të Udhërrëfyesve, ky Udhërrëfyes synon që të kyç profesionistët shëndetësorë të kujdesit primar që të hulumtojnë popullatën, në veçanti femrat e moshës 50 vjeç apo më shumë si dhe meshkujt e moshës 50 vjeç apo mbi 50 vjeç, për praninë e faktorëve të rrezikut për osteoporozë dhe fraktura si dhe në përpilimin e trajtimeve për optimizmin e shëndetit kockor dhe pengimin e frakturave. Përgjatë udhërrëfyesit, kemi përdorur termat “femra” dhe “meshkuj” për t’iu referuar seksit biologjik.

Rekomandimet e Udhërrëfyesit për trajtimin e Osteoporozës, kanë në fokus njerëzit me osteoporozë primare dhe sekondare. Udhërrëfyesi i adresohet edhe grupit të pacientëve me kancer, sëmundje serioze, apo gjendjeve aktive që nxisin zë masës kockore (p.sh., hiperpara-tiroidimi, mieloma multiple, pacientët e diagnostikuar me artrit rheumatoid, apo gjendje tjera inflamatore që kërkojnë terapi me glukokortikoide në doza të larta). Shkaktarët që nxisin osteoporozën sekondare duhet të identifikohen dhe referohen te specialistë me përgatitje përkatëse.

1.3 Të dhënat epidemiologjike

Sa i përket të dhënavë epidemiologjike në nivel vendi, për shkak të mungesës të Sistemit Informativ Shëndetësor si dhe për shkak që Osteoporoza fatkeqësisht tek ne ende nuk trajtohet në përqindje të madhe, pastaj trajtimi bëhet nga profesionistë të ndryshëm në institucione të nivelit primar, sekondar, pa ndonjë koordinim midis profesionistëve. Duke ditur se Klinika e Reumatologjisë në QKUK është qendër referente për pacientët me Osteoporozë, numri i pacientëve që marrin mjekim është në rritje, shembull vetëm në terapi me Zolendronik acid të cilin e kemi në Listën e medikamenteve Esenciale që nga viti 2020 deri tanë pra viti 2024, kemi trajtuar 1229 pacientë. Nga viti 2018 deri në vitin 2020 kemi pasur në Listën Esenciale acidin Ibandronik me të cilin kemi trajtuar rrëth 945 pacientë. Nuk duhet të harrojmë numrin e pacientëve që mjekohen me bisfosfonate në formë tabletare në mënyrë ambulantore e që nuk janë të evidentuar në statistikat tona spitalore. Po ashtu, Klinika e Onkologjisë trajton rastet e veta me Osteoporozë sekondare. Kohët e fundit trajtimi i Osteoporozës ka filluar të bëhet edhe nga mjekët endokrinologë. Kohë pas kohe hasim edhe raporte të mjekëve ortopedë, fiziatër. Kjo bën që të jemi ende shumë larg statisitikave të sakta për këtë sëmundje. Në Kanada rrëth dy milionë njerëz jetojnë me Osteoporozë, sëmundje kjo që rrit rrezikun për fraktura, shkallën e morbiditetit dhe mortalitetit, ul cilësinë e jetës. Ky hartim i Udhërrëfyesit tenton që të senzibilizoj profesionistët shëndetësorë në kujdesin dhe parandalimin e frakturave në gratë pas menopauzës dhe meshkujt mbi moshën 50 vjeçare.

- Rreziku nga frakturat rritet me moshën si rezultat i humbjes së masës kockore dhe rritjes së incidencës së frakturave. Çdo vit në Kanada, rrëth 150 njerëz në 100000 vuajnë nga frakturat e femurit, që konsiderohen si frakturat më serioze që shoqërojnë Osteoporozën. Frakturat rrisin shkallën e morbiditetit, mortalitetit, uljen e kualitetit të jetës. Aktualisht në UK, përafërsisht 549.000 raste të frakturave të reja fragile ndodhin çdo vit përfshirë

frakturat e femurit 105.000 frakturna vertebrale 86000 dhe 358000 frakturna të tjera (p.sh., frakturna të pelvikut, brinjëve, humerusit, krahut, tibiasë, fibulës, klavikulës, shpatullës, sternumit, dhe frakturnave të tjera të femurit). 33% e frakturnave përbëhen nga meshkujt (8,12,13). Këto frakturna shkaktojnë dhimbje të madhe, paaftësi për punë, reduktim të kualitetit të jetës (14,15). Në Britani të Madhe, frakturnat fragjile fajësohen për rreth 579.722 raste të humbjes së aftësisë për punë, madje edhe invaliditetit të përjetshëm gjë që mund të krahasohet me shkallën e humbjes së kualitetit të jetës që shkaktohet nga demencat (8).

- Kostoja e frakturnave fragjile, Shërbimit kombëtar Shëndetësor i kushton (NHS) mbi 4.7 miliardë £, 2.6 miliardë £ pas një frakture (1.1 miliardë £ pas një frakture të femurit 16), mbi 1.7 miliardë £ i atribohen insitucioneve për kujdesin pas frakturnave – (mbështetur në të dhënët e vitit 2017) (8). Çmimi direkt total për vitin 2019 ishte 5.4 miliardë £ që përbën 2.4% të shpënzmëve shëndetësore.

1.4 Popullata e cakut

Osteoporozë konsiderohet si sëmundje e grave të moshuara, kështu që tek meshkujt kjo gjendje shpesh nënvylerësohet, nuk trajtohet fare, përkundër dëmtimit të kualitetit të jetës si pasojë e frakturnave. Përmes hartimit të udhërrëfyesve, synohet ngritja e ndërgjegjësimit dhe rëndësisë së vlerësimit të riskut për Osteoporozë tek meshkujt.

Popullatë e cakut në këtë udhërrëfyes janë të gjitha kategoritë që profesionistët shëndetësorë i kanë hulumtuar në drejtim të Osteoporozës dhe kanë parë të rëndësishme të ndiqen, të mjekohen. Caku kryesor i hulumtimit është mosha mbi 50 vjeç, gratë pas menopauzës, por edhe meshkujt pas moshës 50 vjeçare. Duke e ditur se sëmundjet endokrine, reumatologjike (sidomos ato autoimune ku përdoret në kohë të gjatë terapia me glukokortikoide), sëmundjet onkologjike, nxisin Osteoporozën, këto kategori të pacientëve janë cak i hulumtimit për Osteoporozë pavarësisht nga mosha, pasi sëmundja mund t'i prek edhe moshat e reja.

1.5 Dedikimi

Audience e cakut për këtë udhërrëfyes janë profesionistët dhe institucionet e kujdesit shëndetësor të të gjitha niveleve, e në veçanti udhërrëfyesi u dedikohet profesionistëve shëndetësor të nivelit primar pasi ata janë kontakti i parë me pacientin, më pas profesionistë të kujdesit spitalor - dytësor dhe tretësor, ku trajtohen pacientët me Osteoporozë.

Gjithashtu ky udhërrëfyes si audiencë ka edhe politikëbërësit, menaxherët e institucioneve shëndetësore, drejtuesit e Departamentit Farmaceutik në MSH, të cilët janë drejtpërdrejtë përgjegjës për sigurimin e aparaturës dhe medikamenteve për menaxhimin e kësaj gjendje klinike.

Udhërrëfyesi do të jetë i qasshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë të niveleve të tjera të kujdesit shëndetësor, për pacientët, kujdestarët e pacientëve me qëllim që të informohen sa më mirë për këtë gjendje klinike dhe t'u mundësohet të marrin vendime, duke qenë mirë të informuar për gjendjen e tyre shëndetësore.

1.6 Pyetjet

Ky udhërrëfyes i përmban mbi 30 pyetje shëndetësore të cilat nuk ka qenë fare e lehtë t'i përpilojmë duke u nisur nga fakti se kemi të bëjmë me një sëmundje komplekse multidisciplinare. Së bashku me anëtarët e grupit jemi munduar, gjithmonë konform udhërrëfyesve të huaj, por edhe sfidave me të cilat përballemi në punën tonë të përditshme të përfshijmë në pyetësor faktorët, shkaqet, mjekimin medikamentoz, efektet anësore të terapisë medikamentoze, kohëzgjatjen, komplikimet e sëmundjes. Më poshtë janë të renditura pyetjet shëndetësore të cilat gjatë procesit të adaptimit të udhërrëfyesit janë diskutuar si nga vet grapi i adaptimit ashtu edhe nga grapi i rishqyrtimit të jashtëm. Këto pyetje kanë në brendi shumë nënpyetje që jemi munduar t'i shtjellojmë në shumë drejtime njëkohësisht, pasi kjo sëmundje prek shumë disciplina mjekësore, kështu që secili profesionist shëndetësor shpresojmë të gjejë përgjigjen në paqartësitë që mund t'i ketë hasur gjatë punës së tij dhe menaxhimit të kësaj sëmundje.

1. Çfarë sëmundje është Osteoporoza?
2. Kush rrezikohet nga kjo sëmundje, cila kategori e popullatës duhet hulumtuar?
3. Roli i ushqimit në pengimin e Osteoporozës.
4. Roli i DXA scan në zbulimin e Osteoporozës, sa është sensitive si metodë?
5. Roli i FRAX score dhe senzitiviteti i tij.
6. A duhet hulumtuar meshkujt për Osteoporozë?
7. Kur duhet të fillohet trajtimi me bisfosfonate?
8. Sa duhet të zgjas trajtimi dhe kur duhet bërë ndryshim të medikamentit?
9. Sa shpesh mund të bëhet DXA scan?
10. A mund të vazhdohet terapia me Bisfosfonate duke u mbështetur vetëm në FRAX score?
11. Kush duhet të mjekoj Osteoporozën?
12. Roli i profesionistëve të shëndetit primar në detektimin e rasteve me

Osteoporozë?

13. Sa është rreziku nga frakturat osteoporotike mbështetur në vlerat e DXA scan shoqëruar me FRAX score?
14. A mund të merret terapia suplementare vetëm me vitaminën D pa kalcium?
15. Kur mund të fillohet trajtimi me Denosumab, sa gjatë dhe çka nëse ndërpritet?
16. Terapia anabolike sa gjen vend në trajtimin e Osteoporozës postmenopauzale?
17. Terapia hormonale a është e sigurt dhe efikase në trajtimin e Osteoporozës?
18. Strontium raneleati, a mund të përdoret për trajtimin e Osteoporozës?
19. A duhet çdo herë para marrjes së terapisë me antiresorbtivë të matet niveli i Kalciumit në gjak? Pse?
20. Sa ka rol korseti spinal në pengimin e frakturave të reja osteoporotike?
21. Në sëmundjet inflamatore autoimune kur duhet të fillohet trajtimi me bisfosfonate, apo duhet të mbështetemi vetëm në vlera të DXA scan?
22. Sa kanë ndikim sëmundjet endokrine në shfaqjen e Osteoporozës?
23. Detektimi i Osteoporozës në moshat e reja, cilat janë shkaqet?
24. A duhet të përsëritet DXA scan çdo vit, nësë po në cilat raste?
25. Si mund të zbulojmë rastet që rrezikohen nga frakturat?
26. A jep Osteoporoza dhimbje?
27. Sa lejohet Aktiviteti fizik të rastet me Osteoporozë?
28. Sa ndikon pesha trupore në shfaqjen e Osteoporozës?
29. Sa ndikon predispozita gjenetike në shfaqjen e Osteoporozës?
30. Terapia me Teriparatid a ka epërsi ndaj terapisë me Denosumab?
31. Romosozumab sa gjatë mund të përdoret tek pacienti me Osteoporozë?
32. A guxojmë të ndërprejmë terapinë me Denosumab pa kaluar në terapi tjetër, sa rrezikohemi nga frakturat?
33. A është i sigurt Denosumab tek Insuficiencia renale?
34. A guxojmë të rekmandojmë terapinë me Zolendronic acid në pacientët më Insuficiencë të veshkës?
35. Sa gjatë mund të jepet terapia me Zolendronic acid, sa shpesh lejohet të jepet, apo varet nga indikacionet?

II. METODOLOGJIA

2.1 Përshkrimi i procesit të zhvillimit të udhërrfyesit

Ky udhërrfyes eshtë hartuar nga grapi punues multidisciplinar i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe është shqyrtuar nga recensemtët:

1.Prof Dr Venera Berisha Muharremi interniste- endokrinologe Klinika e Endokrinologjisë QKUK

2.Prof dr Ali Lahu internist -reumatolog Klinika e Reumatologjisë QKUK

3.Dr Avni Kryeziu internist - reumatolog mr sci Klinika e Reumatologjisë QKUK

Hartimi i udhërrfyesit është mbë shtetur nga Ministria e Shëndetësisë si dhe nga Shoqata e Reumatologëve të Kosovës dhe Shoqata e Osteoporozës.

Me rekomandim të Ministrisë së Shëndetësisë, të gjithë anëtarët e përgjedhur për adaptimin e udhërrfyesit kanë qenë të obliguar të deklarohen rreth konfliktit të interesit si dhe ta nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit.

2.2 Përshkrimi se si informacioni i mbledhur është përdorur për të informuar procesin e adaptimit

Grupi për adaptimin e Udhërrfyesit (GAU), si grup multidisciplinar, është përbërë nga 5 anëtarë të emëruar nga Ministria e Shëndetësisë – Republika e Kosovës (shih shtojcën 1). Anëtarët paraprakisht nuk janë trajnuar për metodologji të hartimit të udhërrfyesve dhe protokolleve të organizuar nga MSH. Kjo gjë ka ndikuar shumë në realizimin e Udhërrfyesit, në kohëzgjatjen kohore e peripecitë e shumta.

Me rekomandim të Ministrisë së Shëndetësisë, të gjithë anëtarët e përgjedhur për adaptimin e udhërrfyesit kanë qenë të obliguar të deklarohen rreth konfliktit të interesit si dhe ta nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit. Kërkimet e grüpuit sa i përket hulumtimit të literaturës, në veçanti janë fokusuar në udhërrfyesit si: NICE, NOGG, Udhërrfyesi Osteoporozës i Shoqatës Kanadeze si dhe udhërrfyes tjerë të publikuar dhe përditësuar në 5 vitet e fundit. Të gjitha kërkimet për t'u përcaktuar për udhërrfyesin se cili është më i përshtatshëm për t'u adaptuar dhe praktikuar në praktikën tonë punuese të përditishme janë kryer në gjuhën angleze. Ky udhërrfyes është përgatitur duke adaptuar Udhërrfyes të Shoqatave të Osteoporozës si Shoqatës Britanike “*National Osteoporosis Guideline Group*”(NOGG) *guidance*.¹⁻³ Kanadeze, që kishin për qëllim parandalimin dhe mjekimin e Osteoporozës me një qëllim që të reduktohet reziku nga frakturat fragjile. *National Osteoporosis Guideline Group* (NOGG) *guidance* 1-3. Qëllimi i Udhërrfyesit është që të përcillet diagnostikimi i osteoporozës, opzionet terapeutike të disponueshme, qasja ndaj pengimit të frakturave fragjile në gratë pas menopauzës dhe meshkujt me moshë mesatare 50 vjeç. Duke ditur se frakturat fragjile dhe Osteoporozës janë jo të zakonshme para menopauzës dhe tek meshkujt < 50 vjeçare, nëse këto paraqiten në këtë periudhë atëherë duhet bërë hulumtime të

mëtejme me qëllim të zbulimit të shkaqeve tjera të Osteoporozës dhe vlerësimit gradual për opsonet e trajtimit. Referimi tek specialisti i domosdoshëm. Udhërrëfyesi NOGG mbështetet në të dhënat evidente të nevojshme për përditësimin e këtyre rekomandimeve. Qëllimi i këtij udhërrëfyesi është që të ofrohen rekomandime klinike të pranueshme ku integrohen efikasiteti klinik i evidentuar, dhe siguria e medikamentit. Ky dallon nga National Institute for Health and Care Excellence (NICE), i cili fokusohet në vendosjen e kriterëve për vlerësimin e kost-efektivitetit. Rekomandimet e NOGG janë vlerësuar si kost-efektive në kohën e përpilimit. NICE ka vlerësuar romosozumab si medikament në "pritje" në listë preeliminare për shkak të kost-efektivitetit. (5).

Ky udhërrëfyes është përgatitur nga grupei punues dhe është aprovuar pas konsultimit me udhëheqësit përgjegjës. Udhërrëfyesi është hartuar për të gjithë profesionistët shëndetësorë të përfshirë në parandalimin dhe trajtimin e Osteoporozës dhe frakturave fragjile. Këtu përfshihen profesionistët e kujdesit primar, përfshirë profesionistët e kujdesit sekondar si eumatologët, gjinekologët, endokrinologët, biokimistët klinikë dhe kirurgët ortopedë. Konkludimet dhe rekomandimet janë të përmirësuara në vazhdimësi bazuar në cilësinë e informacionit, nivelin e të dhënavë evidente ku rekomandimi është bazuar. Rishikimet sistematike, metanalizat dhe trialet klinike të radomizuara janë shfrytëzuar që të ofrohen të dhëna evidente. Të dhënat evidente janë përditësuar duke shfrytëzuar PubMed që të identifikohen rishikimet sistematike dhe metanalizat nga korriku 2018 deri në maj 2024. Cilësia e rishikimeve sistematike dhe metaanalizave të shfrytëzuara në formulimin e këtyre rekomandimeve është bërë duke shfrytëzuar AMSTAR2. Rekomandohet që Udhërrëfyesi të përbajtë dhëna më të reja se 5 vjet. Përmirësime <5 vite bëhen nëse janë aprovuar barna të reja apo ka ndryshime madhore të dhënavë evidente. Ndryshimet minore zgjerimi i ndonjë indikacioni, të dhënat e reja për sigurinë e medikamentit, apo ndryshimet në tërësi të karakteristikave të medikamentit do të dalin në faqe nëse nevojitet. Ky Udhërrëfyes përbën punë në kornizë, prej të cilave protokolet lokale duhet të hartohen që profesionistët shëndetësorë të marrin këshillat e nevojshme. Implementimi i këtij Udhërrëfyesi duhet të bëhet në nivel lokal dhe nacional. Rekomandimet e këtij udhërrëfyesi duhet të përdoren që të shtohet mundësia e marrjes së vendimeve menaxheriale, por jo që të zëvendësohen gjykimet klinike në kujdesin individual të pacientëve në praktikën klinike.

Fjalët kyçe gjatë kërkimit kanë qenë:

Osteoporoza, Frakturat Osteoporotike, Terapia antiresorbitive, anabolike

Kriter kryesor për t'u përcaktuar për adaptimin e njërit nga këta udhërrëfyes ishin pyetjet shëndetësore më të aplikueshme në praktikën tonë klinike.

Pas përcaktimit për pyetjet më të rëndësishme dhe rekomandimet më të aplikueshme, jemi përcaktuar për adaptimin e 4 udhërrëfyesve:

- I. Udhërrëfyesi i NOGG - National Guidline Group UK (NICE): (i përditësuar në Gusht

2021).

2. Udhërrëfyesi Kanadez Osteoporosis Canada 2023 Guideline Update Group.
3. Udhërrëfyesi klinik praktik për diagnozën dhe trajtimin e Osteoporozës postmenopauzale, Përditësim 2020 Shoqata Amerikane e endokrinologëve klinikë.
4. Udhërrëfyesi i mbështetur në të dhëna evidente për trajtimin e Osteoporozës tek meshkujt.

Në fazën përgatitore të procesit, i kemi ndarë detyrat sipas prioriteteve dhe përgatitjes profesionale të secilit anëtar të grupit.

III. REKOMANDIMET

Rekomandimet e nxjerra nga ky udhërrëfyes janë graduar në mënyrë sistematike sipas informacioneve që janë të disponueshme që të indikohet niveli i evidencës në të cilin rekomandimet janë mbështetur. Janë dy rekomandime të forta të nxjerra nga ky udhërrëfyes të bazuara në balancin midis efekteve të dëshiruara dhe të padëshiruara, cilësia e të dhënave evidente, vlerat dhe preferencat. Kuptimi i këtij fornulimi ka shumë rëndësi, kur këto rekomandime duhet t'i përshtatim në praktikën klinike.

3.1 Rekomandimet e fuqishme

Fillojnë me foljet vepruese si “këshillohet”, “vlerësohet”, “vazhdohet”, “matet”, “ofron”, “plan”, “referohet”, “udhërrëfyes”, “fillo” dhe të ngajshme. Rekomandimi i fuqishëm aplikohet kur klinicisti arsyeton se shumica e pacientëve duhet të marrin trajimin, apo kur përshtatja me rekomandime, mund të shfrytëzohet si indikator cilësor, si dhe devijimi nga ky rekomandim do të shtyj klinicistin të arsyetoj vendimet e tij.

3.2 Gradimi i rekomandimeve

Rekomandimet sipas *Grading of Recommendations Assessment, Development, and Evaluation GRADE* klasifikimit binar të rekomandimeve si i fortë (po ashtu të njohur diskret ose rekomandimeve të kualifikuara) 311. Rekomandimt janë nxjerr pasi është bërë vlerësimi i balancit midis efekteve të dëshirueshme dhe jo të dëshirueshme

-Sa më e largët diferenca midis efekteve të dëshirueshme dhe të padëshirueshme, aq më i fortë është rekomandimi.

Cilësia e të dhënave evidente – Sa më i lartë kualiteti i të dhënave aq më shumë rekomandimi do të cilësohet si **i fuqishëm**.

Vlerat dhe preferencat – Sa më shumë variable . paqartësi në vlerësimë dhe preferencë, aq më shumë rekomandimi cilësohet si kondicional - **me kusht**.

Çmimet (vendosja e të dhënave)-Sa më i lartë cmimi i një ndërhyrje terapeutike (psh; më shumë burime konsumohen) aq më shumë ka të ngjarë që një rekomandim të jetë **me kusht**.

Shembull një ekomandim i fuqishëm vendoset kur klinicistët konsiderojnë se shumica e njerëzve vendosin të fillojnë terapinë , apo kur përshtatja në rekomandim mund të shfrytëzohet si indikator i kualitetit dhe shmangia nga ky rekomandim do të shtyj klinicistin që këtë ta arsyetoj.NICE rekomandon që të përdoret ‘offer’(apo fjalë të ngajshme të aksionit si ‘measure’,‘advise’,‘commission’or ‘refer’) kur përshkruhet një rekomandim i fuqishëm.313.

A Rekomandimi me kusht përdoret ku klinicisti klinik ekzaminon dosjen e pacientit dhe përgatitet të diskutoj me pacientin , për vlerat dhe preferencat e tij apo kur dosja e diskutimit . është indikator i kualitetit. të jetës më tepër sesa kurs i veprimit, Kur të dhënat janë të pamjafueshme apo apo janë të dyshimta, rekomandimet nuk mund të bëhen.

3.3 AMSTAR2 gradimi i rishikimeve sistematike dhe metaanalizave

Sekzioni	Referenca	Tipi I studi mi	AMSTAR 2 shkallëzimi	Referencat
	Baietal2020	MA	Ulët	59
	Gausdenetal2017	SR	Mesme	101
	Johannesdottiretal2018	SR	Ulët	41
	Kanisetal 2016	SR	Mesme	78
3.Vlerësimi i rrezikut nga frakturnat dhe gjetja e rasteve	Marshalletal1996	MA	Ulët në nivel kritik	28
	Merlijnetal2019	SR&MA	Kritik	108
	Mortensenetal2020	SR&MA	Mesme	65
	Singh-Ospinaetal2017	SR&MA	Ulët	72
	Vilacaetal2020	SR&MA	Ulët	58
	Zhangetal 2020	SR&MA	E ulët	110
4.Pragui ndërhyrjes terapeutike dhe strategjite	Kanisetal 2016	SR	Mesme	78

e menaxhimit

5Menaxhimi jo farmakologjik i osteoporozës.	Babatundeetal2020	SR&MA	Mesme	161
	El-Khouryetal2013	SR&MA	Mesme	167
	Darlingetal 2019	SR&MA	Mesme	145
	Fabianietal2019	SR&MA	Mesme	142
	Gillespieetal 2012	SR&MA	Lartë	171
	Groenendijketal2019	SR&MA	Mesme	144
	Iguaceletal2018	SR&MA	Lartë	147
	Ho. ëetal2011	SR&MA	Lartë	159
	Jepsenetal 2017	SR&MA	Mesme	172
	Kah. ëatiletal2018	SR&MA	Mesme	156
	Kelleyetal2000	SR&MA	Mesme	162
	Kemmleretal2020	SR&MA	Ulët	160
	Kunutsoretal2018	SR&MA	Mesme	164
	Minetal 2017	SR&MA	Ulët	175
	Shenetal 2015	SR&MA	Mesme	174
	Sherringtonetal2017	SR&MA	Ulët	170
	Sherringtonetal2019	SR&MA	Lartë	168
	Yaoetal2019	SR&MA	Medium	152
	Zhaoetal 2019	SR&MA	Ulët	169

3.4 Menaxhimi jo farmakologjik i osteoporozës

Grave pas menopauzës dhe burrave mbi moshën ≥ 50 vjeçare me osteoporozë që janë në rrezik të lartë për fraktura fragjile u rekomandohet :

- 1.Dietë e shëndetshme e pasur dhe balancuar mirë (Rekomandim i fuqishëm).
- 2.Marrje adekuate e kalciumit (minimumi 700mg ditë.) e preferueshme që të mirret përmes dietës apo suplementeve. (rekomandim i fuqishëm).
- 3.Të konsumohet vitamina D nga ushqimet, të përshkruhet vitamina D në formë të suplementeve së paku 800IU/ditë nëse është identifikuar mungesë e vitaminës apo faktorë të rrezikut që cojnë në deficit të vitamines D .Individët që janë në qëndrim shtëpiak apo jetojnë në qendra residenciale

apo shtëpi kujdesi infermieror kanë më shumë nevojë për suplemente me Kalcium dhe vit D që të arrihen nivele të rekomandueshme . (Rekomandim i fuqishëm).

4.Kombinimi i ushtrimeve të rregullta të peshë ngritjes dhe forcimit muscular, mbështetur në kërkesat individuale dhe aftësinë .(Rekomandim i fuqishëm).

5.Këshilla për ndërprerjen e duhanit nëse ndonjë individ është duhanpirës.(Rekomandim i fuqishëm).

6.Këshilla për ndërprerjen e alkoolit nën ≤ 2 njësi /ditë (Rekomandim i fuqishëm).

7.Vlerësimi i rrëzimeve duhet të mirret parasysh te të gjithë pacientët me osteoporozë dhe fraktura fragjile, atyre me rrezik duhet t'u ofrohen programe të ushtrimeve për përmirësim balanci apo ushtrime të kombinuara sipas protokolit. (Rekomandim i fuqishëm).

3.5 Rekomandimet sipas kushteve dhe rrëthanave

Këto rekomandime fillojnë me termin “konsidero”. Rekomandimi me kusht kur klinicisti mbështetet në të dhënat evidente brenda kontekstit më të gjerë shëndetësor dhe social, e më pas diskuton me pacientin, duke marrë parasysh preferencat e pacientit, duke i sqaruar dhe prezantuar dokumentacionin që është indikator i cilësisë, në të cilin është shumë më mirë të mbështetemi sesa të veprojmë në mënyrë vetanake.

3.6 Përbledhje e Rekomandimeve Kryesore

Ky udhërrëfyes përbledh vlerësimin, diagozën dhe trajtimet bashkëkohore të Osteoporozës, përfshirë rekomandimet për pengimin e frakturnave fragjile. Ky aplikohet në gratë postmenopausale dhe meshkujt mbi moshën 50 vjeçare apo më shumë.

Tabela 1:Interpretimi I fuqisë së rekomandimeve sipas GRADE qasjes 12,13

Kriterët	Interpretimi nga pacientët	Interpretimi nga profesionistët shëndetësorë	Interpretimi nga grupi punues
----------	----------------------------	--	-------------------------------

Rekomandimet e fuqishme për apo kundër

Pasoja të dëshirueshme QARTË jashtë peshës	Shumica e individëve në këtë situatë do të rekomandonin kursin, e veprimit vetëm një pjesë e vogël nuk do ta rekomandonin.	Shumica e individëve do të duhet të pranonin kursin e e rekomanduar të veprimit. Përputhja me këtë rekomandim sipas udhërrëfyesit mund të shërbej si kriter cilësor apo indikator i performancës.	Rekomandim et mund të adaptohen si policë në shumë situata.
Pasojet e padëshirueshme në shumë cilësimë (apo vice-versa)		Vendimet formale nuk duken të ndihmojnë që të marrin vendime sipas vlerësimeve dhe preferencave.	
Rekomandimet shtesë për apo kundër			
Pasojet e dëshirueshme Me siguri JASHTË PESHËS	Shumica e individëve në këtë situatë do të donin kursin e sugjeruar të veprimit, por shumë nuk do ta pranonin.	Klinicistët duhet të dinë që vendimet e ndryshme do të janë të pranueshme për secilin person dhe klinicistët duhet të ndihmojnë secilin person përmes menaxhmentit, duke pas parsysh vlerësimet dhe preferencat e seclit person.	Përpilimi i policës do të kërkoj debate substanciale dhe përfshirjen e palëve të ndryshme të interesuara.
Pasoja të padëshirueshme në shumë cilësimë (apo vice-versa)		Vendimet mund të janë të dobishme për ti ndihmuar njerëzit që të marrin vendime në përshtatje me vlerat dhe preferencat..	

Prezantim i mirë praktik

- Qëndrimi i mirë praktik është një veprim i nevojshëm në praktikën shëndetësore, por që mbështetet nga dëshmitë indirekte që nuk dëmtojnë sigurinë e të dhënavë.
- Implementimi i këtyre qëndrimeve duhet të rezultoj me rezultate pozitive të mëdha.
- Përbledhjet e mëtejme të dëshmive do të kishin vlerë të pakët në punimin e udhërrëfyesve.

Note:GRADE=Grading of Recommendations Assessment, Development and Evaluation.

3.7 Vlerësimi i riskut për frakturne në gratë pas menopauzës dhe burrat ≥50:

3.7.1 Futja e FRAX kalkulatorit në njerëzit me faktorë klinikë të rrezikut për frakturne fragjile:

- Të matet BMD në pacientët me rrezik intermediar për frakturne përmes FRAX që të përcaktohet rreziku nga frakturnat për 10 vitet e ardhshme.

2. Të matet BMD në pacientët me rrezik të lartë dhe shumë të lartë nga frakturat përmes FRAX që të vendoset për mjekimin – llojin e medikamenteve.
3. E konsiderueshme edhe imazheria në pacientët me dhimbje në fundshpinë që kanë faktorë rishku për osteoporozë apo në pacientët ku kemi humbje të lartësisë trupore $\geq 4\text{cm}$, kifozë përdorim aktual apo kohë të gjatë të terapisë orale me glukokortikoide apo BMD T-score ≤ -2.5 .
4. Vlerëso rrezikun nga rrëzimet në pacientët me Osteoporozë dhe frakturna fragjile dhe atyre me risk të lartë, programe trajnimi që të përmirësohet balanci dhe forca muskulare.

3.7.2 Lidhur me trajtimin me barna që të pengohen frakturat në gratë pas menopauzës dhe të menaxhohen pas moshës ≥ 50 :

1. Ofro trajtimin me barna në pacientët me risk të lartë dhe shumë të lartë për frakturna.
2. Nëse matja e BMD nuk është praktike si pasojë e (p.sh. fragjilitetit), shfrytëzo online NOGG pragun ndërhyrës mbështetur në FRAX, që të merret vendimi për trajtim.
3. Konsidero sidomos në të moshuarit trajtimin me barna, në ata me frakturna primare apo frakturna fragjile kohët e fundit.

3.7.3 Kur zgjidhet medikament për trajtimin dhe pengimin e frakturnave në gratë postmenopausale dhe meshkujt ≥ 50 :

1. Shqyrto nivelin e rrezikut nga frakturat, çfarëdo faktori klinik shtesë të rrezikut, zgjedhjen që e bën pacienti, po ashtu duhet të vlerësohet raporti çmim–efektivitet i trajtimit, kur vendoset për trajtim të veçantë me medikament.
2. Fillo trajtimin shpejt pas frakturnave fragjile pasi rreziku nga frakturnat e reja është i lartë menjëherë pas fraktureve dhe ky rrezik mbetet i lartë.
3. Konsidero referimin e pacientit me rrezik të lartë te specialisti i Osteoporozës në nivelin sekondar me qëllim të vlerësimit për terapi parenterale (disa mund të kenë nevojë për terapi anabolike sidomos nëse ka frakturna multiple vertebrale. Indikacion për vlerësim specialistik në nivel sekondar kanë pacientët me frakturna vertebrale 1 [brenda dy viteve të fundit], ≥ 2 frakturne të vertebrave
4. (çfarëdo niveli që ndodhin). BMDT-shkallëzimi ≤ -3.5 , trajtimi me glukokortikoide ($\geq 7.5\text{mg/ ditë}$ meprednisolone apo të tjera. Prania e faktorëve klinikë të shumtë të rrezikut, në veçanti në prani të frakturnave aktuale), indikatorë të frakturnave të reja.
5. Në pacientët tjerë ku indikohet trajtimi, ofro terapinë antiresorbitive me bisfosfonate orale (alendronate ose risedronate) ose forma intravenoze zoledronik acid.
6. Konsidero format alternative të trajtimit, nëse kjo linjë e parë e trajtimit me bisfosfonate, është jo e pranueshme apo jo e tolerueshme p.sh. Denosumab, ibandronate, terapia

zëvendësuese hormonale, raloxifene apo strontium ranelate.

7. Më pas trajtimi me teriparatide ose romosozumab. Fillo alendronat, zoledronate ose denosumab pa vonesë.

3.7.4 Kur te femrat dhe meshkujt ≥ 50 vjeç është filluar trajtimi

1. Rregullisht të përcillet reagimi në terapi, përshtatja, toleranca.
2. Mbani mend: Kërkohet trajtim afatgjatë zakonisht pasi osteoporiza është gjendje kronike për të cilën aktualisht nuk ka shërim.
3. Planifiko pëershkrimin e bisfosfonateve orale për të paktën 5 vite, apo bisfosfonateve intravenoze për të paktën 3 vite e më pas rivlerëso rrezikun për frakturna. Trajtim aftagjatë kërkohet në pacientët mbi moshën ≥ 70 vjeçare, me frakturna vertebruale apo të femurit doza të larta të glukokortikoideve (≥ 7.5 mg/ditë apo prednisolone ekivalente mbi 3 muaj), apo që gjatë trajtimit kanë pësuar frakturna fragjile. Në pacientët me rrezik të ulët, ndërprerja e përkohshme e trajtimit prej 18-36 muaj duhet të merret në konsideratë vetëm pas 5 viteve të mjekimit me bisfosfonate orale apo pas 3 viteve me bisfosfonate intravenoze.
4. Para fillimit të trajtimit me denosumab, sigurohu për planifikimin afatgjatë të menaxhimit të osteoporozës.
5. Mos e ndërprej trajtimin me Denosumab pa planifikuar terapinë pasuese antiresorbitive, aty ku funksioni renal lejon.
6. Rivlerëso rrezikun për frakturna pas çdo frakture të re.
7. Rivlerëso rrezikun për frakturna prej 18 muaj -3 vite pasi është ndërprerë trajtimi.

3.7.5 Kur femrat dhe meshkujt ≥ 50 vjeç, trajtohen me glukokortikoide orale:

1. Nëse fillohet me dozë ≥ 7.5 mg/ditë prednisolone apo doza ekivalente
2. Për tre muajt e ardhshëm në të njëjtën kohë fillo me barna osteoprotektive pa realizuar DXA scan e cila mund të bëhet më vonë.
3. Ofro terapinë antiresorbitive me bisfosfonate orale (alendronate ose risedronate) ose zoledronik acid intravenoz, dhe në ata me rrezik të lartë për frakturna vertebruale, duhet të merret në konsideratë trajtimi me anabolikë.
4. Konsidero denosumabin si medikament alternativ

3.7.6 Kur duhet të jepen këshilla për stilin e jetës dhe regjinin dietetik:

1. Rekomando dietë të shëndetshme të balancuar mirë, konsumim të moderuar të alkoolit dhe ndërprerje të duhanit.
2. Sigurohu për marrjen adekuate të suplementeve, me kalcium dhe vitamin D.
3. Inkurajo pacientin për kombinimin e ushtrimeve ngritje e peshave trupore dhe forcim muskular.
4. Lidhur me shërbimet për parandalimin e frakturnave:

5. Pacientët që përjetojnë frakturne fragjile duhet të kenë qasje në shërbimet multidisciplinare për frakturne me qëllim të përcjelljes, monitorimit dhe trajtimit.

3.7.7 Kur gratë në postmenopauzë apo meshkujt >50vjeç kanë frakturne asimptomatike vertebrale:

1. Sigurohu që shërbimet imazherike të evaluojnë shtyllën kurrizore në të gjitha drejtimet, në gratë pas menopauzës me moshë ≥ 50 vjeçare me qëllim të raportimit të frakturnave vertebrale, duke shfrytëzuar metodat standarde.
2. Të merren në konsideratë programet që mundësojnë forcim progresiv të muskujve, duke përfshirë muskujt ekstensorë të shpinës.
3. Të hulumtohen shkaqet bazë të frakturnave fragjile.
4. Të fillohet trajtimi intensiv me qëllim të reduktimit të riskut nga frakturnat.

Të dhënat e prezantuara në udhërrëfyes konfirmojnë rekomandimet tjera të shumëta të dhëna nga udhëheqësit dhe profesionistët shëndetësorë, siç janë kriterët përmirësimin e kujdesit primar dhe sekondar.

3.8 Osteoporozë dhe frakturnat fragjile

- Definicioni bazë i Osteoporozës është bërë nga OBSH në vitin 1994, si sëmundje progresive sistematike skeletale që karakterizohet nga humbja e masës kockore mikroarkitekturës së indit kockor që ka për pasojë rritjen e fragilitetit kockor dhe mundësinë për frakturna.
- Pasi përkeqësimi mikroarkitektural nuk mund të matet klinikisht, pëershkrimi bëhet mbështetur në matjen e densitetit kockor (BMD) shkallëzimi <-2.5 . Gjatë viteve ky është adaptuar si definicion klinik; Sidoqoftë ky kufizim i fokusimit në të dhënat e BMD, më vonë është bërë i qartë. BMD sot shikohet si tërësi por gjithmonë duke vlerësuar faktorët e riskut të cilët sot konsiderohen si të domosdoshëm.
- Signifikanca klinike e Osteoporozës qëndron në frakturnat në rrjaje. Përafërsisht një në dy të rritur gra dhe një në pesë meshkuj do të përjetojnë një apo disa frakturne fragjile (frakturne traumatike nga rëni të lartësia) gjatë jetës së tyre. Në Britani të Madhe prevalenca e frakturnave të qafës së femurit BMD T score $7. \leq -2.5$, në moshën 50 vjeçare apo më shumë, është 6.8% në meshkuj dhe 21.8% në femra. 8. Megjithatë shumica e njerëzve që përjetojnë frakturne fragjile kanë BMD në qafën e femurit mbi -2.5 , që reflekton kontributin e shumë faktorëve të tjerë midis BMD dhe rrezikut për frakturna. 9-11. Faktorët e tjerë të rrezikut si rrëzimet aksidentale shpesh mund të bashkëekzistojnë me faktorët e tjerë të rrezikut për osteoporozë, e si rezultat nevojën për kyçjen e shërbimit të frakturnave me qëllim të trajtimit të tyre.
- Vendet e zakonshme të frakturnave fragjile përfshijnë trupat e vertebrave, femurin, pjesën distale të radiusit, pjesën proksimale të humerusit si dhe pelvikun. Frakturna e femurit është

frakturna më e zakonshme që kërkon trajtim urgjent kirurgjik në të moshuarit. Është po ashtu shkaku më i zakonshëm i vdekjeve si pasojë e rrëzimeve. Pas frakturave të femurit ditët mesatare të qëndrimit janë 20 ditë, që përbëjnë 1/2 e miliona hospitalizimeve për çdo vit, me rreth 3,602 shtretër 1-23.

- Në Britaninë e Madhe shkalla e frakturave variron sipas shtrirjes gjeografike, racës, nivelit socioekonomik (24).
- Sikurse në shumë shtete me nivel të lartë sociekonomik, incidenca e frakturave në raport me moshën dhe gjininë ngelet stabile, megjithëse është vënë re rritje e incidencës së frakturave të femurit në mesin e meshkujve në Britani të Madhe (27, 28.). Shërbimet preventive në SHBA, kanë gjetë të dhëna të mjaftueshme për aftësinë që ka BMD dhe FRAX në identifikimin e rrezikut nga frakturat osteoporotike dhe që kjo terapi redukton shkallën e frakturave në gratë pas menopauzës (73). Shoqatat amerikane për shëndet kockor shfrytëzojnë qasje të ngjashme sikur në përditësimet tona, që të hulumtojnë (p.sh. gratë pas menopauzës dhe meshkujt ≥ 50 vjeçare me histori për frakturna apo faktorë klinikë të rrezikut) dhe rekomandojnë trajtimin e të gjitha frakturave qoftë të femurit, humerusit, pelvikut apo pjesës distale të krahut me densitet të ulur kockor. BMD T-score ≤ -2.5 , masë të ulët kockore dhe USFRAX 10-vjeçar probabilitet për frakture të femurit $\geq 3\%$ apo frakturna madhore osteoporotike $\geq 20\%$. Udhërrëfyesit kombëtarë për Osteoporozë të Birtanisë së madhe shfrytëzojnë procesin hulumtues në dy etapa për të identifikuar njërzit me rrezik të lartë për frakturna, në përputhje me moshën sa i përket ndërhyrjes farmakologjike (75). Shumica e Udhërrëfyesve klinikë rekomandojnë vlerësimin e frakturave vertebruale në pacientët me faktorë rizu (76).

3.9 Vlerësimi i rrezikut nga frakturat dhe gjetja e rasteve

3.9.1 Rekomandimet

1. Vlerësimi i FRAX duhet të bëhet në çdo grua pas menopauzës, apo tek meshkujt mbi moshën ≥ 50 vjeçare, me faktorë rreziku klinikë për frakturna fragjile pasuar nga matja e densitetit kockor, referimi në kohë dhe fillimi i trajtimit kur është e nevojshme (*rekomandim i fugishëm*).
2. Kur përdoret FRAX për llogaritjen e probabilitetit për frakturna, duhet bërë gjykim klinik kur rreziku klinik tejkalon faktorët që përfshihen në FRAX (*rekomandim i fugishëm*).
3. Llogaritja aritmetike e probabilitetit për frakturna osteoporotike madhore (MOF: pjesa lumbale, femuri supi, apo humerusi), frakturave të femurit mund të shfrytëzohet në praktikën klinike, duke përfshirë edhe faktorët shtëse klinikë të rrezikut si përdorimi i glukokortikoideve, densiteti kockor në pjesën lumbale shumë i ulur, diabeti tip 2, anamneza pozitive për rrëzime (*rekomandim shtesë*).
4. Vlerësimi i frakturave të vertebrave (VFA) indikohet në gratë pas menopauzës me moshë

mesatare ≥ 50 vjeç nëse pacienti jep anamnezë pozitive se ka humbur lartësinë e trupit mbi $\geq 4\text{cm}$, kifoza, marrja aktuale ose kohë të gjatë e terapisë me glukokortikoide orale, BMD T-score ≤ -2.5 qoftë në pjesën lumbale ose regjionin e femurit apo në rastet me fillim akut të dhimbjes së shpinës me faktorë reziku për osteoporozë (*rekomandim i fuqishëm*).

5. T-scores në meshkuj dhe femra që rezulton nga matja e densitetit kockor në qafën e femurit llogaritet duke shfrytëzuar vlerat normale të BMD tek një grua e shëndoshë e moshës së re nga NHANES III (*rekomandim i fuqishëm*).
6. DXA scan rezultati duhet të raportohet brenda tre javësh nga realizimi, nga profesionistë shëndetësorë të trajnuar në interpretim të DXA scan dhe në kordinim me standarde të raportuara kombëtare dhe ndërkombëtare (*rekomandim i fuqishëm*).
7. Pacientët me osteoporozë apo frakturna fragjile duhet të hulumtohen për shkaktarë bazë, ku përfshihen edhe testet rutinore të gjakut (*rekomandimi fuqishëm*).
8. Shfrytëzimi i ultrazërit kuantitativ nuk rekomandohet për diagnozën e osteoporozës. (*rekomandim i fuqishëm*).
9. QCT-matjet e qafës së femurit janë BMD në gratë pas menopauzës me moshë mesatare ≥ 50 vjeç dhe mund të shfrytëzohen për diagnostikim oportunistik të osteoporozës dhe për marrjen e vendimeve individuale duke shfrytëzuar FRAX (*rekomandim shtesë*).
10. Diagnostika Kompjuterike shtesë vjen në konsiderim me qëllim të përmirësimit, raportimit standard me CT të performuar ne gratë pas menopauzës me moshë mesatare ≥ 50 vjeç që të përmirësohet gjetja oportunistike e frakturnave vertebrrale, (*rekomandim i kushtëzuar*).

Tabela 2: Rekomandimet për aktivitetin fizik dhe ushqimin me qëllim të rrëzimit të frakturnave në gratë pas menopauzës dhe meshkujt e moshës 50 vjeçare apo më shumë *

Rekomandimet	Fuqia e rekomandimeve dhe saktësia e dëshmive †
--------------	---

1.Ushtrimet‡

Ne rekomandojmë ushtrime fizike dhe të balancit \geq dy herënë javë që të redukojmë rrezikun nga rrëzimet .

Rekomandim i fuqishëm të dhëna evidente të moderuara

Vërejtje : paraqitja e vështirësive me rritjen e frekuencës së ushtrimeve, rritjen e volumit, shfaqja e rezistencës .Sfidat gjatë ushtrimeve të balancit

Ngritura e peshave trupore deri në kufirin që lejon stabilitetin,

- Reagojmë nga ngjarjet që çrrregullojnë balancin si (p.sh., kapja dhe hedhja e topit l),
- Ruajtja e balancit gjersa lëvizim (p.sh., Taichi, qëndrimi me thembra të ngritura), dhe
- Reduktimi i sipërfaqes bazë (p.sh. qëndrimi me një këmbë).

Aktiviteti fizik rrit mundësinë për kryerjen e aktiviteteve të përditshme si ulja ngritura nga karriga , ngjitja e shkallëve).

1.2 Ne sugjerojmë ushtrime progresive të rezistencës dy herë në javë ,përfshirë Rekomandime me ushtrimet me target muskujt ekstensorë të abdomenit dhe muskujt abdominalë. s. kusht , shkallë e ulët e Vërejtje Ushtrimet e rezistencës përfshijnë ushtrimet kur grupet e muskujve madhorë: (p.sh. ekstremitetet e sipërme dhe të poshtme , ,kraharoni,supet ,shpina),punojnë kundër rezistencës p.sh. mbajtja e frysës dhe nxjerrja) rrisin vëllimin (p.sh. ..peshat)).Shumë ushtrime të rezistencës do të konsideroheshin ushtrime funksionale..

1.3.Ne propozojmë që njerëzit që do të marrin pjesë në aktivitete të tjera si (p.sh. „ecja ushtrimet me impakt, joga, pilates qoftë për argëtim apo arsyë të tjera t'i nxisim t'i bëjnë ato ushtrime). Aktivitet tjera fizike mund të lejohen por jo si zëvendësim për ushtrimet e rezistencës dhe balancit.

Rekomandime me kusht , shkallë shumë e ulët e dëshmisë të dhënavë evidente

Vërejtje: Duhet të nxisim çdo lloj të aktivitetit fizik: 24 orë në përputhje më Udhërrëfyesit e Lëvizjeve si p.sh.,bërrja e ushtrimeve fizike nga të moderuara deri më të rënda në kohëzgjatje $\geq 150\text{min} / \text{javë}$,por me prioritet ushtrimet e balancit , rezistencës.Nëse njerëzit marrin pjesë në ushtrimet me impakt duhet filluar nga ato të moderuara si. (p.sh. .vrapi i tenisi, kërcimi) apo me impakt të lartë (p.sh., hedhjet poshtë apo lart),duhet ushtruar vetëm nëse ndikimi në frakturna i aktivitetit fizik është i ullët , apo fare, apo nëse këto ushtrime nuk ndikojnë negativisht në njerëzit me frakturna paraprake.(p.sh. , anamneza pozitive për frakturna të shpinës, apo rreziku 10 vjeçar për frakturna $\geq 20\%$ illogaritur me FRAX score).

1.4.Aktivitetet që kërkojnë lëvizjë të shpejta , të përsëritura, me peshë, si Qëndrim i mirë praktik përdredhjet, përkuljet eshpini, duhet modifikuar , në veçanti pas frakturnave apo kur rreziku për frakturna është i lartë..

1.5.Atëherë kur nevojitet duhet kërkuar ndihmë nga profesionistët e terapisë fizikale të trajnuar në Osteoporozë, ushtrimet e lejuara , intensitetin dhe progredimin, modifikimin e aktivitetit fizik, sidomos pas frakturnave aktuale apo nëse rreziku për frakturna është i lartë.. Kur kjo nuk është e mundur duhet drejtuar Institucioneve përgjegjëse për Osteoporozë..§

2. Ushqimi ¶

2.1.Njerëzit qe iu përbahen rekomandimeve për konsumimin e ushqimit të pasur me Rekomandime me kalcium ne nuk rekomandojmë marrjen e suplementeve me kalcium që të pengojmë kusht shkallë e frakturnat..

Vërejtje :Shoqatat Kanadeze rekomandojnë marrjen e suplementeve me kalcium e dëshmisë. 1000mg/d(meshkujt e moshës 51–70vjeç dhe 1200 mg/d (femrat > 50 vjeç dhe meshkujt > 70 vjeç).

2.2.Ne sugjerojmë marrjen e vitaminës D sipas rekomandimeve të Shoqatave Kanadeze për shëndetin kockor.

Vërejtje : Institutet Kanadeze të Shëndetit publik rekomandojnë marrjen e vitaminës D 600 IU/d (mosha 51–70vjeç) dhe 800 IU/d (mosha > 70 vjeç për femra dhe meshkuj. Kjo sasi e vitaminës D nuk mund të merret nga ushqimet e pasura me vitamin D Instituti për Shëndet publik i Kanadasë rekomandon që adultët e moshës mbi , 50 vjeç të marrin suplemente me vitamin D prej 400 IU ditë si shtesë ndaj ushqimeve të pasura , me vitaminë D– me qëllim që të arrihet niveli i kërkuar i vit D..Për njerëzit me rrezik përmungesë të vitaminës D, suplemente shtesë të vitaminës D duhet të jepen..**

2.3.Për njerëzit që përcjellin Udhëzuesit kanadezë të Ushqyeshmërisë, nuk rekombandojmë marrjen e suplementeve me proteina , vitaminë K apo magnez. që të pengohen frakturat.	Rekomandimet me kusht me shkallë të ulët të evidencës proteinat,vitaminë K),shkallë shumë e ulët e evidencës - (magnezi)
2.4.Për njerëzit që janë në trajtim me barna, duhet të përcaktohet plani I 2.4.për rëndësinë e suplementeve me kalcium dhe vitaminë D3 ne menyrë individuale Megjithëse pacientët në terapi medikamentoze zakonisht marrin, së paku 400IU/ditë vitamin D dhe deri 1000mg/ditë suplemente me kalcium, planifikimi i marrjes së ushqimeve të pasura me kalcium apo suplementeve duhet bërë në mënyrë individuale mbështetur në faktorët e rezikut që mund të çojnë në pamjafuteshmëri. **	Qëndrim i mirë praktik

3.10 Matja e densitetit kockor

1. Rreziku për frakturna rritet në vazhdimësi me ulje të densitetit kockor (BMD). Rishikimet sistematike dhe metaanalizat në popullatën e hulumtuar përmes teknikave absorbiometrike, tregojnë që rreziku nga frakturna rritet përafërsisht dy-fish për çdo devijim standard (SD) uljes së BMD (28,29) (niveli i evidencës I a). Shkalla e rezikut nga frakturnat dallon varësisht nga teknika dhe vendi i matjes, mosha e personit dhe tipi i fraktureve (29) (niveli i evidencës Ia). Vlera parashikuese e BMD për frakturnat e femurit mund të jetë aq e saktë dhe precise sa mund të jetë shtypja e lartë e gjakut për goditje në tru (30) (niveli i evidencës IV).
2. OBSH dhe fondacioni Ndërkombëtar për Osteoporozë (IOF) rekombandojnë që teknologjia për matjen e BMD të jetë absorbiometria me rreze X-dual (DXA), aplikuar në regionin e femurit për shkak të vlerës prediktive të lartë në vlerësimin e fraktureve (31,32) (niveli i evidencës Ia). Matjet e regionit të qafës së femurit përmes DXA shfrytëzohen në FRAX. ®.Shpina nuk është gjithmonë pjesë e besueshme për vlerësimin e rezikut në diagnostikimin e osteoporozës në të moshuarit për shkak të prevalencës së madhe të ndryshimeve degenerative, të cilat shoqërohen me artefakte dhe rrisin vlerën e BMD. Megjithatë rezultati në një person të moshuar që tregon ulje të densitetit kockor, është gjithmonë valid dhe klinikisht i dobishëm, veçanarisht në ata njerëz me disproporcione

midis densitetit kockor të ulët në pjesën lumbale krahasuar me regjionin e femurit.

3. Matja e densitetit kockor në të njëjtin nivel në femra dhe meshkuj tregon risk të njëjtë për frakturna (33,34) (niveli i evidencës IIa). Kështu që vlerat referente të rekomanduara për femra dhe meshkuj, për transgjinorë, përmes të cilave llogaritet densiteti kockor në qafën e femurit dhe femurin total, në USA rrjedhin nga NHANES III mbijetesa për gratë e racës së bardhë 20-29 vjeç (32,35).
 4. Vlerat referente nga të cilat T score i pjesës lumbare dhe distale të parakrahut llogaritet si në femra dhe në meshkuj të të gjitha etniciteteve, janë vlera të fabrikuara të DXA Scaner. – 3.5.
 5. Osteoporoza mund të diagnostikohet në bazë të matjes së denistetit kockor T-score në femurin total, qafën e femurit ose pjesën lumbare. Megjithatë detektimi i riskut nga frakturnat nuk është përmirësuar nga matjet e densitetit kockor në pjesë të ndryshme (36,37) (niveli i evidencës IIa). Kur matja e denistetit kockor në pjesën e femurit për shkaqe teknike nuk është e mundur, apo nëse vlerat e densitetit kockor në pjesën lumbale janë të tjera, atëherë ato matje mund të shfrytëzohen për diagnozë. Diagnoza e Osteoporozës mund të bëhet nga matjet T- score në pjesën distale të parakrahut. (1/3radius), kur matjet nuk mund të interpretohen as nga pjesa lumbale e as nga femuri, apo kur pesha e pacientit e tejkalon limitin e lejueshëm të tavolinës së DXA (35) (niveli i evidencës IV).
 6. Matjet serike të BMD mund të shfrytëzohen për monitorimin e përgjigjes ndaj tretmanit (38). Matjet serike të pjesës lumbale tregojnë ndryshime më të mëdha të lidhura me trajtimin, andaj janë vend i preferuar për matje, megjithatë nëse vihen re ndryshime degenerative atëherë matjet bëhen në femur me qëllim të monitorimit.
 7. Validiteti i matjeve përmes Fbmd varet nga cilësia e kontrollit, andaj ekipet kombëtare dhe ndërkontebtare kanë publikuar standartet për raportimin e DXA Scan (35,39).
 8. Matjet e densitetit kockor përmes tomografisë së kompjuterizuar kuantitative QCT-në regionin e qafës së femurit janë ekuivalente me matjet e DXA scan. (40-42). Vlerat e matjeve të qafës së femurit dhe femurit total të llogaritura nga projeksionet dy dimensionale të bëra përmes tomografisë së kompjuterizuar kuantitative (QCT) korrespondojnë me vlerat T score të fituara me DXA scan. Kështu densiteti kockor i matur përmes absorbiometrisë CT X-ray të qafës së femurit mund të përfshihet në FRAX (35,43-45) (niveli i evidencës IIa). Teknikat tjera për vlerësimin e BMD, përfshijnë ultrazërin kuantitativ, që vlerësohet si më pak valid krahasuar me teknikat tjera absorbiometrike.

3.11 Vlerësimi i faktorëve klinik të rrezikut

1. Vlerësimi i rezultateve të BMD duhet bërë duke marrë parasysh edhe faktorët klinikë të rrezikut që veprojnë pavarësisht nga BMD. Me rëndësi të veçantë është mosha që i kontribon këtij rreziku pavarësisht BMD (11,46) (Niveli i evidencës Ia).
 2. Faktorët klinikë shtesë janë identifikuar që të kenë kontribut në rritjen e rrezikut nga

frakturat pavarësish nga mosha dhe BMD:

3. Indeksi i ulur i masës trupore (BMI) është faktor signifikant i rrezikut për frakturne të femurit, por pesha e BMI në parashikimin e frakturave tjera është shumë e vogël kur bëhet në kuadër të BMD (47) (Nivel i evidencës Ia).
4. Të dhënët anamnestike për frakturne primare, në veçanti nga traumat me shkallë të ulët, në vende karakteristikë për osteoporozë, janë faktorë rreziku për frakturne të reja (48). Rreziku shfaqet në pjesët e pavarura nga BMD (49). Rreziku nga frakturne është dyfish më i madh në prani të një frakture primare morfometrike verbale përfshirë frakturat asimptomatike, të moderuara apo të rënda (Grada 2ose 3) 49,50 (niveli i evidencës Ia). Rreziku është më i madh kur kemi më shumë se një frakture vertebrale. Pas frakturës, rreziku për frakture pasuese është më i lartë menjëherë pas frakturës, më shumë se 1/3 e frakturave brenda 10 vjeçarit të parë ndodhin brenda vitit të parë (51,52) (Nivel i evidencës Ic).
5. Anamneza familjare pozitive për frakturne të femurit, është rrezik signifikant i pavaruar nga BMD (53) (Nivel i evidencës Ia).
6. Duhanpirja është faktor rreziku që pjesërisht është i varuar nga BMD 54 (Nivel i evidencës Ia).
7. Terapia orale me glukokortikode rrit rrezikun nga frakturat varësish nga dozimet. Rreziku nga frakturat si rezultat i kortikosteroideve nuk çon si i vetëm në humbjen e masës kockore, pasi janë identifikuar edhe faktorë të pavarur të rrezikut (55,56) (Nivel i evidencës Ia).
8. Konsumimi i alkoolit ka treguar ndikim në rrezikun nga frakturat varësish nga doza e konsumuar. Nëse komsumi i alkoolit është rreth 2 njësi apo më pak brenda 24h, nuk është vënë re rritje e rrezikut nga frakturat. Marrja e 3 apo më shumë njësi të alkoolit brenda 24 orësh shoqërohet me rritje të rrezikut nga frakturna (57) (Nivel i evidencës Ia).
9. Ka shumë shkaqe tjera sekondare që ndikojnë në osteoporozë (p.sh., sëmundja inflamatore e zorrës, çrregullimet endokrine), por në shumicën e rasteve mbetet e paqartë se deri në çfarë nivel rreziku nga frakturat lidhet me BMD të ulur apo faktorë tjerë të rrezikut si përdorimi i glukokortikoideve. Për dallim artriti reumatoid rrit rrezikun nga frakturat pavarësish nga BMD dhe përdorimi i glukokortikoideve (56) (Nivel i evidencës Ia).
10. Diabeti melit (si typ 1 ashtu edhe typ 2) shoqërohet me një rrezik të lartë nga frakturat e femurit dhe ato jo vertebruale. Në diabetin tip2 kohëzgjatja e sëmundjes dhe terapia me insulinë kohë të gjatë, rrisin rrezikun për frakturna, që është pjesërisht i varur nga BMD 58,59; (Nivel i evidencës Ia) (60,61).
11. Përdorimi i faktorëve klinikë të riskut të kombinuar, që të parashikohen rreziku nga frakturat, rezulton i afërt me rezultatet e BMD si e vetme (62). Shfrytëzimi i faktorëve klinikë të rrezikut plotësuar nga BMD është optimal, por matja e densitetit kockor BMD mund të jetë target për pacientët me rizik të pragut të ulët, rizik të lartë apo rizik shumë të lartë. Ekzistojnë shumë faktorë tjerë klinikë të rrezikut që nxisin frakturna e që nuk janë përfshirë në FRAX, përfshirë ata që veprojnë si të vetëm duke reduktuar BMD, nuk janë vlerësuar drejt si faktorë rreziku apo si faktorë rreziku jo të rëndësishëm për t'u trajtuar

(11,63). Kujdesi nga rrëzimet, është shembull ku rreziku nga frakturat mund të jetë i madh dhe trajtimi me barna që ndikojnë në metabolizmin kockor si të vetme, nuk veprojnë në faktorë të rrezikut (64).

12. Përpos glukokortikoideve shumë barna tjera mund të rrisin rrezikun nga frakturat e femurit, përfshirë hormone tiroidiene, inhibitoret e aromatazës për trajtimin e kancerit të gjirit, deprimuesit e androgjeneve për trajtmin e kancerit të prostatës 65-69 (Niveli i evidencës Ia). Thiazolidinedionet që shfrytëzohen për trajtmin e diabetit typ 2, po ashtu rrisin rrezikun nga frakturat (70,71).
13. Shumë barna tjera shoqërohen me rritje të rrezikut nga frakturat, përfshirë antidepresivët, antiparkinsonikët, antipsikotikët, anksiolitikët, benzodiazepinat, sedativët, antagonistët e receptorëve H₂, inhibitorët e pompës protonike (65-69). Niveli deri ku rreziku nga frakturat i ndërmjetësuar nga BMD e ulur, rrezimet, apo faktorë tjerë, është i ndryshëm në secilin rast dhe arsyja nuk dihet. Ndikimi i steroideve në shëndetin kockor në individët transgjinorë është i paqartë.
14. Markerët biokimikë të remodelimit kockor kanë potencial që të ndikojnë si faktorë rreziku por me siguri kanë rol më të madh në monitorimin e trajtimit. (73-75); (Niveli i evidencës Ia).

3.12 Mjetet për vlerësimin e faktorëve të rrezikut

1. IOF dhe OSH rekomojnë që rreziku nga frakturat të paraqitet si rrezik absolut me probabilitet 10 vjeçar (11). Rreziku absolut nga frakturat varet nga mosha dhe jetëgjatësia por edhe nga faktorë aktual të rrezikut. Periudha 10 vjeçare mbulon kohën nga fillimi i trajtimit deri në periudhën ku edhe nëse trajtimi ndërpritet benefitet nga trajtmi vazhdojnë të jenë prezente. Periudhat më të shkurta kohore nuk futen në vlerësim të rrezikut. (76,77.)
2. Algoritmat që kanë përfshirë peshën e faktorëve klinikë të rrezikut në rrezikun nga frakturat me apo pa informatën për BMD, janë zhvilluar në vitin 2008 përmes Qendrës kolaboruese për Sëmundje metabolike të kockave në Sheffield. FRAX mjeti (www.shef.ac.uk/frax/) logarit probabilitetin 10 vjeçar të një frakte të femurit dhe/apo të një frakte madhore osteoporotike. Një frakture madhore osteoporotike është një frakture klinike e shpinës, femurit, parakrahut, ose humerusit. Ky mjet është vlersuar dhe pranuar nga tudimet e pavarura kohore. (46,78); (Niveli i evidencës Ia).
3. Q Frakturna mbështetet në studimin prospektiv kohort të hapur të Britanisë së Madhe nga të dhënat e mbledhura rutinore ku janë futur numër i madh i faktorëve klinikë. Vlerësimi bëhet në periudhë nga 1-10 vjet, për incidencën e frakturnave të femurit ose frakturnave madhore osteoporotike. NICE ka rekomanuar përdorimin e mjeteve për vlerësimin e faktorëve të rrezikut (FRAXose QFracture) (80). Pasi FRAX dhe QFrakturna ndajnë rrugë të ndryshme (probabiliteti i frakturnës ku numërohet edhe rreziku nga mortaliteti në rastin e FRAX, dhe rreziku kumulativ nga frakturna në rastin QFrakturnës). Dy kalkulatorët nuk

mund të shfrytëzohen njëkohësisht. Si shtesë, BMD nuk mund të përfshihet në vlerësimet e QFrakture.

Përfundimisht, NOGG pragu i intervenimit, rekomanduar nga *E Quality Standards*, bazohet në FRAX probabilitetin dhe nuk mund të shfrytëzohen për vlerësimin e rrezikut nga frakturnat që rrjedh nga QFrakture apo kalkulatorët tjerë (78,81).

4. Hyrja në FRAX përfshin moshën dhe gjininë, BMD. Faktorët klinikë të pavarur të rrezikut janë listuar në tabelën 1. BMD e qafës së femurit, është një parametër hyrës i mundshëm. Faktorët dytësorë të listuar vlerësojmë të janë të ndërmjetësuar nga BMD e ulët dhe nuk bartin ndonjë peshë kur BMD e qafës së femurit futet në FRAX.

Tabela 3 Faktorët e rrezikut klinik të përfshirë në vlerësimin e probabilitetit të frakturnës FRAX

Mosha

Gjinia

Indeksi i masës trupore BMI i (llogaritur përmes peshës dhe gjatësisë në kg/m²)

Frakturna fragile t.ë mëparme, përfshirë frakturnat morfometrike vertebrare

Anamneza famijare pozitive për frakturna

Trajtimi aktual me glukokortikoide t (çfarëdo doze, një muaj 3 muaj apo më shumë)

Duhanpirja aktuale

Konsumimi i alkoolit njësi apo më shumë /ditë

Artriti rheumatoïd

Shkaqet sekondare të osteoporozës përfshirë:

Diabetin tip 1

Hipertiroidizmi i patrajtuar kohë të gjatë

Hipogonadizmi i patrajtuar / menopauzë e parakohshme (<45 vjeçare)

Malnutricioni kronik/malabsorbimi

Sëmundjet kronike të mëlçisë

Insuficiencia renale kronike pa hemodializë (p.sh. ,CKD3a– 5)

BMD i regionit të qafës së femurit

N.B.Faktorët klinikë shtesë të rrezikut që ndikojnë në FRAX score janë të listuar si më poshtë
Tabela 3.

- Llogaritja përmes FRAX nuk merr për bazë Medikamentet për trajimin e osteoporozës

primare apo edhe faktorët e rëndë klinikë të rrezikut. Për shembull të dhënët anamnestike për dy frakturna primare bartin rrezik më të lartë sesa një frakturë e vetme. Frakturna vertebrale e mëparme bart dy herë më shumë rrezik krahasim me rastet kur nuk kemi frakturë të mëparme. Tek përdorimi i glukokortikoideve dozimi po ashtu ka rëndësi dhe diskutohet pjesërisht në NOGG Udhërrëfyesin. Pasi nuk është e mundur që në algoritimin e FRAX score të përfshihen të gjitha modelet një vlerësim i mirë klinik duhet të bëhet para interpretimit të të dhënave të FRAX score.

- Lëndimet e rënda dhe të lehta ekzistojnë në vazhdimësi dhe kanë signifikancë klinike me impakt të lartë apo të ulët. Frakturnat në kuadër të osteoporozës janë shpesh si pasojë e traumave të rënda për dallim nga frakturnat primare. Ato shoqërohen me BMD të ulët dhe rrezik për frakturna në të ardhmen. Ky rrezik është gati i njejtë si për frakturnat që ndodhin pa trauma të rënda (48.)
 - Megjithëse FRAX ka të përfshira numër të kufizuar të variablate, procedura aritmetike të thjeshta janë të disponueshme (tabela 2) të cilat mund të përdoren si vlerësues shtesë të probabilitetit për frakturna të femurit dhe frakturna madhore, me qëllim të vlerësimit të drejtë, duke pasur njohuri për: Eksposimi i lartë, i moderuar apo i ulët ndaj glukokortikoideve (82) (Niveli i evidencës IIa)
 - Të dhënët konkurrente në BMD pjesa lumbale (83,84) (Niveli i evidencës Ia)
 - Informimi për score të pjesës trabekulare të kockës (TBS) (85) (niveli i evidencës Ia). Vlerat e TBS mund të futen në faqen e FRAX të Britanisë së Madhe.
 - Gjatësia axis këmbë (86) (Niveli i evidencës Ib)
 - Anamneza pozitive për rrëzime (87) (Niveli i evidencës IIa)
 - Shteti i lindjes (Niveli i evidencës Ib)
 - Diabetes mellitus tip 2 (89) (Niveli i evidencës Ib)
 - Tek frakturnat madhore aktuale osteoporotike (MOF)52 r aplikimi i FRAX sugjeron përritje të x%, andaj duhet të aplikohet në proporcion me vlerat e FRAX original. P.sh. ngritja e probabilitetit të FRAX 30% për 10% na jep probabilitetin prej $30 \times 1.10 = 33\%$. Nuk ka ndonjë të dhënë evidente bazë e cila do të mund të na informonte për vlerësimin e vendimeve. Vendimi duhet të merret duke pas parasysh faktorin më dominant p.sh. atë faktor që do të ketë impakt më të lartë në vlerësimin e probabilitetit (Niveli i evidencës IV).

Tabela 4: Vendimet e përaferta dhe konsideratat për probabilitetet e frakturnave të femurit dhe frakturnave madhore osteoporotike, që duhet të shtohen në interpretimin e FRAX score

Variabla e rrezikut	Përshtatja e FRAX *	Qasja
Ekspozimi në doza të moderuara dhe të larta të glukokortikoideve	Doza të moderuara (2.5–7.5mg ditë) janë minimumi i dozave të lejuara për llogaritjen e FRAX score, dhe vlerat e pa përpunuara të FRAX për doza të larta (>7.5 mg ditë), Probabiliteti për MOF ngritet për t15% ndërsa për fraktura të femurit deri 20% ¥	Përshtatja automatike që mund të gjindet ne faqen e FRAX score Kanisetal2011 ⁸²
Të dhënat konkurrente për pjesën lumbale	Rritja/ zvogëlimi i probabilitetit MOF për 10% për Leslie et al çdo shkallë tëdiferencës T score midis LS and FN* 2011Johanssonetal2014 ⁸ 3,84	
Shkalla e kockës trabekulare (TBS)	Rritja e probabilitetit për MOF 30% për çdo devijim standard (SD) zvogëlon TBS	Vlerësimi i TBS mund të bëhet përmes UK FRAX website.McCloskey et al 2016 ⁸⁵
Gjatësia aksis këmbë (HAL)	Rritja e probabilitetit për fraktura të femurit për 30% për çdo vlerë të devijimit standard SD rrit gjatësinë axis këmbë HAL	Leslieetal2016 ⁸⁶
Historia për rrëzime	Rritja e probabilitetit për MOF dhe fraktura të femurit për 30% të dhënat për rrëzime aktuale (≥ 2 rrëzime brenda vitit)	Masudetal2011 ⁸⁷
Vendi i lindjes	Shfrytëzo FRAX score modelin duke cekur vendine lindjes, pasi rreziku mund të lidhet me vendin e origjinës, karakteristikat e tij	Johanssonetal2015 ⁸⁸ . Wändelletal2021 ⁹⁰
Diabetes mellitus Tip 2 II	Shtyp ‘po’ në rubrikën e FRAX për artrit rheumatoïd	Përshtatjet tjera në Leslieetal2018 ⁸⁹
MOF aktuale	Nënvizo rritjet e probabilitetit për fraktura.	Kanisetal2020 ⁵²

*Vlerat e ulëta të probabiliteteve të FRAX të përshtatur duhet bërë vetëm në kontekst të vlerave më të larta të besueshme të matjeve përmes BMD, e jo në bazë të rezultateve diskordante si pasojë e artefakteve, p.sh. ndryshimet degenerative.

- Megjithëse diabeti bart në vete një rrezik për fraktura mbi dhe nën rrezikun e përshkruar me FRAX, ende ekzistojnë të dhëna joëmpirike prej të cilave do të rekomandohej përshtatja e UK. Ndërkohë të njëjtat përshtatje mund të shfrytëzohen edhe për diabetin typ 2 (Nivel i evidencës IV).
- Po ashtu vlerat e FRAX kanë treguar se janë jo të afektuara gjerësisht nga statusi socioekonomik, dallimet në ndërtimin e trupit dhe sëmundjet renale kronike (Nivel i

evidencës Ib).

- Përshtatja e FRAX probabiliteteve që përfshijnë llogaritjen e numrit dhe rëndesës së frakturave vertebrale nuk mund të bëhet aktualisht, pasi të dhënët e duhura empirike mungojnë.
- Rreziku më së miri u prezantohet pacientëve me variabla numerike me frekuencë të thjeshta, framing pozitiv dhe negativ p.sh., 23% rreziku për 100 “njërz si ty”, brenda 10 viteve të ardhshme, “23 pacientë do të pësojnë fraktura dhe 77 pacientë nuk do të pësojnë fraktura”. Përshkrimi vetëm me fjalë i rrezikut si p.sh.: “Ju keni shanca të mëdha që të keni fraktura” është jo efikas dhe nuk e pajis pacientin me detajet e duhura që e ndihmojnë të marrë një vendim informativ. Kështu, pacientët do të kenë përceptime të ndryshme, interpretime të ndryshme të asaj se çka është risk i ulët dhe çka është risk i lartë? Është shumë më e lehtë për pacientët që të kuptojnë numrat dhe frekuencat e thjeshta (p.sh., 1 në 100)r sesa përqindjet. Grafikët dhe pikrogramët përbëjnë informacion numerik të lehtë për t'u kuptuar, andaj duhet të shfrytëzohen kur nevojitet (94) (Niveli i evidencës IV).

3.13 Hulumtimet për Osteoporozën dhe frakturat fragjile

ab. Vlerësimi diagnostik i individëve me osteoporozë duhet të përjashtoj sëmundjet që e imitojnë osteoporozën, identifiko shkakun, (s)e osteoporozës dhe përfshijë menaxhimin e çfarëdo sëmundje shoqëruesse. Hulumtimet e zakonshme janë paraqitur në tabelën 3.

Tabela 5. Hulumtimet klinike të propozuara për hulumtimin e osteoporozës dhe frakturave fragjile.

<i>Rutinore</i>	<i>Procedurat tjera nëse indikohen</i>
• Historia klinike	• Elektroforeza në serum, imunoglobulinat
• Ekzaminimi fizik përfshirë matjen e lartësisë dhe vlerësimin e kifozës torakale	• në serum,
Hemogrami	• Hormoni paratiroid (PTH) ^b
• Eritrosedimentacioni apo proteina-C reaktive	• Testosteroni në serum, FSH, LH
• Nveli i kalciumit në serum, albuminat totale, kreatinina, fosfataza alkaline, transaminazat	• Kortizoli plazmatik 24 orësh testi i suprimimit të deksametazonit
• Niveli në serum i 25-hydroxyvitaminD	• Prolaktina në serum
• Hormonet tiroidiene	• Magnezi në serum në rast të hipokalcemisë
	• Antirupat indorë transgultaminazë, +/- endomysialtrupat (hulumtimi i sëmundjes coeliaca)
	• Ekskretimi i kalciumit urinar
	• Markerët e remodelimit kockor (p.sh., CTX, PINP) ^c
	• Grafitë e shtyllës kurriore në projekzion lateral DXA scan e indikuar pas vlerësimit me FRAX ose me qëllim të përcjelles së densitetit kockor
	• Scintigrafië e kockës

Persistenca e vlerave të ulëta të fosfatazës alkaline nuk duhet të anashkalohet pasi mund të jetë shkak i ndonjë sëmundje metabolike bazë.

PTH duhet të matet nëse niveli i kalciumit në serum është mbi $\geq 2.6 \text{ mmol/l}$ dy herë, ose $\geq 2.5 \text{ mmol/l}$ dy herë nëse dyshohet në hiperparatiroidizmin primar (95).

Parimisht matet për të vlersuar remodelimin kockor në përgjigje ndaj terapisë antiresorbitive. CTX reflekton resorbimin kockor, PINP formimin kokcor CTX duhet matur në mëngjes në gjendje esell.

Hulumtimet tjera si biopsia e kockës dhe testet gjenetike për osteogjenezës imperfecta mund të bëhen strikt vetëm në qendra të specializuara.

3.14 Vlerësimi i frakturave vertebrale

ac. Shumica e frakturave vertebrale nuk marrin vëmendjen e duhur mjekësore andaj ngelin të padiagnostikuara (96). Frakturat vertebrale të moderuara apo të shkallës së rendë, madje edhe kur

janë asimptomatike janë faktorë të fuqishëm për frakturna të shpinës, por edhe pjesëve të tjera të skeletit. (50,97,98) (Nivel i evidencës Ia). Vlerësimi i rizikut nga frakturat vertebruale (VFA) duhet marrë në konsideratë.

b. Në individët me rrezik të lartë për frakturna duke shfrytëzuar grafinë e shtyllës kurrizore në planin lateral, ose DXA scan (99) (Nivel i evidencës Ia). Shkalla e rrezatimit është shumë më e vogël në krahasim me grafitë.

ad. Identifikimi i frakturave osteoporotike mund të bëhet ndonjëherë edhe krejt rastësish përmes imazheve radiologjike të kraharorit ose pjesës abdominale që bëhen për indikacione të tjera.

ae. Diagnostikimi i frakturave vertebruale osteoporotike bëhet shpesh edhe përmes CT scan që bëhet për indikacione krejt tjera, duke marrë parasysh që vertebrat dhe dy femurat gati gjithmonë mund të shihen në imazhe përkatëse (101) (Nivel i evidencës Ia). Identifikimi i frakturave vertebruale përmes CT së kompjuterizuar (CAD) mund të përmirësoj metodat standarde (102-105) (Nivel i evidencës IIb). CAD metodat kanë shkallë të lartë senzitivitetit, specificitetit dhe afinitetit në detektimin e frakturave vertebruale (Nivel i evidencës IV).

3.15 Skriningu dhe gjetja e rasteve

af. Tani nuk ka ndonjë dokument të përgjithshëm të pranueshëm për popullatën me qëllim të identifikimit të njerëzve me osteoporozë, por duke ditur faktorët e rrezikut që ndikojnë në densitetin kockor mund të përmiresohet parandalimi i rrezikut nga frakturat. Ka mundësi që në të ardhmen të implementohen strategji të reja.

ag. Një trial hulumtues i tipit skrining në Britani të Madhe ka shfrytëzuar FRAX score me qëllim të identifikimit të osteoporozës në gra dhe llojin e trajtimit në ato me rrezik të lartë nga frakturat e femurit. Vlerësimi i rrezikut përmes matjes së densitetit kockor në qafën e femurit dhe llogaritjen me FRAX score në individët me rrezik të mesëm dhe të lartë nga frakturat, është zbatuar në qendrat e kujdesit primar ku janë përfshirë rreth 12500 gra të moshës 70-85 vjeç. Pas 5 viteve krahasur me qendrat standarde të kujdesit primar ky program skriningu ka arrit të ulë numrin e frakturave të femurit në 28%. Rezultate të ngjashme janë vënë re në studimin Danez (106) që nuk tregoi rezultate të mira në Norvegji (107). Metaanaliza e tri trialeve klinike tregoi që ky program + skriningu ka reduktuar frakturat e femurit rreth 20% (108) (niveli i evidencës Ia).

ah. Në mungesë të një dokumenti skrining strategjia për gjetjen e rasteve është e nevojshme për shkak të frakturave fragjile apo prezencës së faktorëve tjerë të rrezikut. Ka edhe shumë faktorë tjerë të rrezikut jashtë atyre të përfshirë në FRAX, e që mund të shfrytëzohen si trigger për vlerësimin e faktorëve të rrezikut (shih tabelën 4), përfshirë kifozën torakale dhe humbjen e lartësisë trupore ($> 4\text{cm}$), madje duke e krahasuar me gjatësinë e një adulti të ri të shëndoshë apo kur pacienti nuk posedon dosje nga matjet e mëparme (Nivel i evidencës IIa), malatsorbimi pas kirugjisë bariatrike (110) (Nivel i evidencës Ia).

Tabela 6. Faktorët klinikë të rrezikut për osteoporozë /frakturna jo të përfshirë në FRAX, e që duhet përfshirë në vlerësimin e rrezikut nga frakturnat

Kifoza torakale; Humbja e lartësisë (>4cm); Rrezimet dhe/apo fragiliteti kockor

Sëmundjet inflamatore: p.sh., spondiliti ankilozant, artritet tjera inflamatore sëmundjet e indit lidhor lupusi eritematoz sistemik.

Sëmundjet endokrine p.sh., Diabeti melit tip 1 dhe tip 2, hipertiroidizmi, hipogonadizmi, Sindroma Cushing.

Çrregullimet hematologjike /sëmundjet malinje mieloma multiple, talasemia, sëmundjet e muskujve, mioziti, miopatitë dhe distrofitë, sarkopenia.

Sëmundjet e mushkërive: p.sh., astma, fibroza cistike SPOK, HIV

Sëmundjet neurologjike / psikiatrike p.sh., sëmundja Parkinson dhe sëmundjet shoqëruese skleroza multiple epilepsia, insultet, depresioni, demenza

Mungesat në ushqim si kalciumi, vitamin D [ki parasysh që mungesa e vitaminës D mund t'i kontribuojë rritjes së rrezikut nga frakturnat përmes mineralizimit keokor të mangët (osteomalacia) e më pak Osteoporozë] Sindromat e malabsorbimit të lidhura me kirurgjinë bariarrike apo të tjera. Medikamentet p.sh.

Disa imunosupresivë (calmodulin/inhibitorët e calcineurinë fosfatazës s) (kalimi) trajtimi me hormone tiroide (levothyroxine dhe /apo liothyronine). Pacientët me kancer të tiroides me TSH të suprimuar janë në rrezik të pjesëshëm. Medikamentet që ndikojnë prodhimin e gonadeve (inhibitorët e aromatoazës, terapia depriviuese e androgjeneve, medroxyprogesterone acetate, agonistët e gonadotropinës antagonistët e receptorëve të gonadotropinës)

Disa nga Medikamentet antidiabetike (p.sh., thiazolidinediones)

Disa nga antiepileptikët (p.sh., fenitoinë dhe karbamazepinat)

3.16 Strategjitet e pragut ndërhyrës

3.16.1 Rekomandimet

1. Një vlerësim fillestar me FRAX që tregon probabilitetin 10-vjeçar për frakturna madhore osteoporotike (MOF i shpinës, parakrahut apo humerusit, regionit të femurit mund të shfrytëzohet për identifikimin e paienteve me shkallë të ulët, të mesme dhe të lartë të rrezikut (*rekomandim i fuqishëm*)).
2. Konsideratë e veçantë ndaj të moshuarve, gjatë trajtimit sidomos në ata me frakturna paraprake ose aktuale fragjile, vlerësimi i riskut nga frakturnat, dhe udhëzimi për përdorimin e medikamenteve (*rekomandim i fuqishëm*).
3. Meshkujt dhe femrat me rrezik të lartë nga frakturnat (shih figurën 1), duhet bërë DXA scan nëse kërkohet një matje bazike e cila krahasohet me matjet tjera në të ardhmen (*rekomandim i fuqishëm*).
4. Burrat dhe gratë me rrezik të ndërmjetëm nga frakturnat (p.sh. midis pragut të sipërm dhe të

poshtëm, duhet referuar për matje të densitetit kockor). Më pas probabiliteti nga frakturat duhet të rivlerësohet përmes FRAZ (*rekomandim i fugishëm*).

5. Kur BMD përfshihet në vlerësimin e FRAZ nëse rreziku është shumë i lartë, i lartë, apo i ulët përcaktohet nga vlerat më të larta të dy matjeve - vlerësimi me të rrezikut (*rekomandim i fugishëm*).

6. Në burra dhe gra me rrezik të ndërmjetëm nga frakturat, nëse matja e densitetit kockor nuk mund të bëhet, kundërindikohet apo është jo praktik (p.sh., individët fragjilë) trajtimi me barna duhet bërë nëse ka histori për fraktura fragjile, apo nëse rreziku nga frakturat e tejkalon pragu e lejueshëm (*rekomandim i fugishëm*).

7. Burrat dhe gratë me risk të ulët për fraktura, pa fraktura të mëparme fragjile, duhet të sigurohen që rreziku nga frakturat është i ulët andaj duhet ofruar këshilla për stilin e jetesës (*rekomandim i fugishëm*).

8. Pacientët me rrezik shumë të lartë për fraktura duhet të referohen tek specialisti i Osteoporozës në kujdesin sekondar, për vlerësim dhe trajtim parenteral (disa mund të kenë nevojë për terapi me anabolikë të linjës së parë sidomos ata me fraktura vertebrare multiple. Indikacionet për referim tek specialisti përfshijnë (*rekomandime sipas rrëthanave*):

- Prania e një faktori të vetëm të rrezikut por që ka rëndësi siç është:
 - Frakturë vertebrare kohët e fundit [brenda dy viteve]
 - ≥ 2 fraktura vertebrare [kurdo që të kenë ndodhur]
 - BMDT-Score ≤ 3.5
- Trajtimi me doza të larta të glukokortikoideve [≥ 7.5 mg/ditë prednisolone ose ekvivalent mbi 3 muaj çon në humbje të shpejt të densitetit kockor, duhet filluar me bisfosfonate orale)
- Prania e faktorëve multiple të rrezikut nga frakturat në veçanti të frakturave fragjile kohët e fundit, që tregojnë për rrezik të lartë për fraktura të reja.
- Apo indikatorë të tjera që tregojnë rrezik shumë të lartë nga frakturat.

9. Zgjedhja e trajtimit duhet bërë varësisht nga niveli i rrezikut, faktorët shtesë të rrezikut, rapporti kosto-efektivitet dhe preferencat e pacientit (*rekomandim i fugishëm*).

10. FRAZ dhe linku i saqes NOGG, duhet përfshirë në dosjen elektronke të pacientit (*rekomandim i fugishëm*).

3.17 Vlerësimi i pragut të probabilitetit për fraktura 10 vjeçare përmes FRAZ

Qasja e rekomanduar për marrjen e vendimeve është mbështetur në probabilitetin e frakturave që derivon nga FRAZ dhe mund të aplikohet si në femra ashtu edhe në meshkuj (78). Kjo qasje mbështetet nga analiza e kost-efektivitetit duke apilikuar bisfosfonatet orale dhe venoze (111,112) (Niveli i evidencës Ib). Pragu i vlerësimit të probabilitetit të frakturave madhore osteoporotike brenda 10 viteve paraqitet në Figurën 1.




Figura 1: NOG Vlerësimi për pragun e shfaqjes së frakturave madhore osteoporotike, (MOF) në Britani të Madhe përmes përdorimit të FRAX score.

Individët me shkallë të probabilitetit nën pragun vlerësues të lejuar (LAT) duhet këshilluar për ndërrimin e stilit të jetesës. Ata individë që kanë rrezik të ndërmjetëm midis pragut të sipërm (UAT) dhe të poshtëm vlerësues (LAT) më pas vlerësohen përmes matjes së BMD. Nëse pas kryerjes së BMD probabiliteti shtrihet mbi apo nën pragun e lejuar, këshillat për ndërrimin e stilit të jetës duhet rekomanduar (3,78). Pacientët me probabilitet mbi pragun e lejuar vlerësues duhet të konsiderohen për trajtim. (UAT) Ata pacientë që kanë probabilitet mbi pragun me rrezik shumë të lartë duhet referuar te specialisti. (VHRT). Kur matja e BMD nuk konsiderohet praktike (p.sh. në pacientë fragjilë apo që e kanë të pamundur të rrinë shtrirë në tavolinën densitometrike). Pacientët me probabilitet mbi pragun e lejuar duhet t'i nështrohen trajtimit.

Tabela 11. Efikasiteti kundër frakturave i medikamenteve të aprovuara kundër osteoporozës kur jepen së bashku me kalcium dhe vitamin D3 në gratë pas menopauzës si dhe meshkujt

Intervenimi	Frakturnat vertebralle	Frakturnat jo vertebrale	Frakturnat e femurit	Të dhënat evidente për superioritetin ose inferioritetin e parandalimit të frakturave vertebrale në gratë pas menopauzës me rrezik të lartë nga frakturnat	Të licencuar a për përdorim tek meshkujt
Romosozumab	Ib	IIb	IIb	Superior ndaj Alendronate(Ib)	Jo
Teriparatide	Ia	Ia	Ia	Superior ndaj Risedronate(Ib)	Po
Alendronate	Ia	Ia	Ia	Inferior ndaj Romosozumab(Ib)	Po

Ibandronate	Ib	Ib	NAE	NAE	Jo
Risedronate	Ia	Ia	Ia	Inferior ndaj Teriparatide (Ib)	Po
Zoledronate	Ia	Ia	Ia	NAE	Po
Calcitriol	Iia	NAE	NAE	NAE	Po
Denosumab	Ia	Ia	Ia	NAE	Po
HRT	Ia	Ia	Ia	NAE	Jo
Raloxifene	Ia	NAE	NAE	NAE	Jo
StrontiumRanelate	Ia	Ia	IIb	NAE	Po

Nivel i evidencës (shih Shtojca 3). HRT: hormone replacement therapy. NAE: No available evidence.

a. Frakturat vertebrale

Efikasiteti i medikamenteve të listuara në tabelën 6 është paraqitur me qëllim të parandalimit të frakturave vertebrale. Teriparatide dhe romosozumab janë treguar superior ndaj risedronatit dhe alendronatit në reduktimin e rrezikut nga frakturat verterbrale fragile në gratë me osteoporozë pas menopauzës me rsik të lartë për fraktura.

b. Frakturat e femurit

Shumë nga medikamentet e listuara në tabelën 6 është treguar se reduktojnë incidencën e frakturave të femurit me përjashtim të ibandronatit, calcitrolit dhe raloxifene.

c. Frakturat jo vertebrale

Medikamentet e listuara në tabelën 6 (me përjashtim të calcitrolit dhe raloxifene) është treguar se reduktojnë incidencën e frakturave jo vertebrale.

d. Fillimi i medikamentit

Tabela 12: Kohëzgjatja dhe efekte e terapisë për mjekimin e Ostroporozës në femrat pas menopauzës dhe meshkujt e moshës 50 vjeç apo mbi moshën 50 vjeç *

Rekomandimet

Fuqia e rekondimit
dhe saktësia e të
dhënavë
evidente†

5.Kohëzgjatja dhe ndikimi i terapisë

5.1 Pacientët në terapi me bisfosfonate sugjerojmë që fillimi i trajtohen me bisfosfonate në kohëzgjatje 3–6 vjet.

Vërejtje: Terapia 6 vjeçare është e përshtashme për individët me histori për fraktura

Rekomandimet
me kusht me
shkallë të ulët të

të femurit, vertebrave, frakturna multiple të vertebrave, ose individët me faktorë rreziku për humbje të masës kockore apo frakturna.[‡] Kur përdoret zoledronik acid, dhënia e dozave më rrallë sesa rekomandohet mund të jetë e nevojshme. Nëse kemi përgjigje jo adekuate apo shqetësim për ndonjë frakturnë gjatë terapisë me bisfosfonate, përvoja praktike tregon nëse duhet të zgjatet mjekimi apo të ndërpritet dhe të bëhet rivlerësimi i shkaktarëve sekondarë, si dhe të kërkohet ndihmë nga ekspertët përkatës nëse nevojitet.⁴⁶

5.2..

Vërejtje: Përgjigjen jo adekuate në trajtim duhet ta konsiderojmë nëse kemi > 1 frakturnë apo densiteti kockor bie (p.sh. $\geq 5\%$) përkundër përshtatjes në protokolin terapeutik (>1 vit). Megjithatë jo gjithmonë ulja e densitetit kokcor apo frakturnat indikojnë përgjigje jo adekuate në terapi (p.sh. shkaqet e osteoporozës sekondare, rënet, BMD gabimet që çojnë në pasaktësi).

5.3. Për njerëzit në terapi me Denosumab ne sugjerojmë mosndërprerjen e terapisë. Vërejtje: Skema terapeutike me Denosumab, çdo 6 muaj, duhet dhënë me rregull pa u vonuar më shumë se një muaj për shkak të rrezikut nga humbja kockore dhe frakturnat e vertebrave. Kohëzgjatja e terapisë mund të vlerësohet pas 6–10 vite dhe varet nga terapia paraprake me bisfosfonate si dhe vlerësimi individual i rrezikut nga frakturnat atipike të femurit si dhe osteonekroza e nofullës.

5.4 Për pacientët ku Denosumab ndërpritet pas 4 dozave ne sugjerojmë kalimin në bisfosfonate 6 muaj pas dozës së fundit të terapisë me Denosumab, me qëllim që të reduktojmë rrezikun nga humbja e masës kockore. Ne rekomandojmë terapinë me bisfosfonate për një vit, e me pas duhet bërë rivlerësimi për nevojën e kalimit në terapi tjeter.

Vërejtje: Ndërprerja e terapisë me denosumab, mund të jetë e përshtatshme për njerëzit ku Denosumabi nuk garanton më cilësi për shkak të intolerancës apo kundërvindikacioneve.

5.5. Në pacientët ku Denosumab ndërpritet ≥ 5 dozave, ku rreziku nga humbja e shpejt e masës kockore apo frakturnat e vertebrave është i madh (p.sh. ata me frakturna prevalente). Përvoja praktike përfshin kërkimin e këshillave nga ekspertët e osteoporozës se si të kalohet në terapi tjetër.

5.6.Pas ciklit me terapi anabolike, ne rekomandojmë që të kalohet në terapi antiresorbitive me qëllim të rritjes së densitetit kockor.

sigurisë ;

Qëndrim i mirë praktik

Rekomandimet me kusht

Shkalle shumë e ulët e sigurisë së të dhënavë evdente

Rekomandimet me kusht

Shkalle e ulët e sigurisë së të dhënavë evidente

Qëndrim I mirë praktik

Rekomandim me kusht, të dhëna evdente të moderuara

Shënim:BMD=bone mineral density.

*ShihFigura 2 fpër qasje të integruar .

†ShikoTabela 1për definicione .

‡Shihfaktorët e rrezikut në Figurën1 dhe Shtojca1,Tabela suplementare 5 (shkaqet e Osteoporozës sekondare) gjinden në www.cmaj.ca/lookup/doi/10.1503/cmaj.221647 tab-me përbajtje të përafërt

3.18 Inicimi i medikamentit në kujdesin primar dhe sekondar

Bisfosfonatet orale dhe venoze, denosumab, raloxifene, calcitriol dhe HRT mund të rekomandohen nga klinicisti në kujdesin primar ose sekondar. Nëse Denosumab fillohet në kujdesin primar, konsultimi me kolegë të kujdesit sekondar këshillohet për shkak të nevojës që të kemi një plan afatgjatë të personalizuar për menaxhimin e osteoporozës, para fillimit të Denosumab, që të mundësohet ndërprerja e Denosumabit pas planifikimit, nëse është e nevojshme.

Pasi përdorimi i calcitrolit mbështetet vetëm nga të dhënët evidente të shkallës IIa përdorimi i tij është i kufizuar, zakonisht vetëm nga profesionistët e kujdesit sekondar. Strontium ranelate mund të ordinohet nga klinicistët e kujdesit primar dhe sekondar, por nëse fillohet në kujdesin primar duhet përfshirë konsultimi i klinicistëve të kujdesit sekondar.

3.19 Inicimi i trajtimit në kujdesin sekondar

Teriparatide dhe romosozumab duhet të ordinohen nga klinicistë të kujdesit sekondar në UK, që të dy jepen përmes sistemit "shërbim shtëpiak", që gjithashtu merren me edukimin e pacientit.

e. Rendi i trajtimit

Çdo pacient që e ka ndërprerë denosumabin, romosozumabin apo teriparatide kërkon terapi të radhës, zakonisht duke kyçur medikamentet antiresorbitive të cilat duhet planifikuar në kohën kur terapia fillestare rikyçet, me qëllim që të mos shkaktohet "boshllëk" në trajtim.

3.20 Medikamentet specifike opsonale

3.20.1 Medikamentet antiresorbitive: Bisfosfonatet

Acid Alendronik 70mg njëherë në javë rekomandohet për trajtimin e osteoporozës postmenopauzale një herë në javë me rrugë orale në osteoporozën tek meshkujt, osteoporozën e indukuar nga glukokortikoidet si dhe në prandalimin e osteoporozës postmenopausale dhe osteoporozës së indukuar nga glukokortikoidet.

- a. Doza prej 70mg javë konsiderohet ekivalente me dozën e aprovuar paraprakisht prej 10 mg/ditë.
- b. Në gratë pas menopauzës me osteoporozë, acidi alendronik është treguar se redukton

frakturat vertebrale, jo vertebrale dhe frakturat e femurit (179) (Niveli i evidencës Ib). Aprovimi i përdorimit të acidit alendronik në meshkujt me osteoporozë dhe femrat që marrin glukokortikoide është bërë në bazë të studimeve për strukturën e BMD (180,181) (Niveli i evidencës Ib). Edhe pse doza ditore e acidit alendronik 10mgs) është licencuar për përdorim në meshkujt dhe është ekuivalent me dozën javore prej 70 mg ditë (Niveli i evidencës IV).

c. Efektet e zakonshme anësore të acidit alendronik përfshijnë simptomat e traktit të sipërm gastrointestinal, çrregullime në zorrë, kokëdhimbje dhe dhimbje muskuloskeletale.

d. Acidi alendronik duhet të merret në mëngjes esëll së paku 30 min para ushqimit apo lëngjeve (përpos ujit) apo medikamenteve të tjera madje edhe suplementeve duke përfshirë kalciumin. Tabletat duhet të gëlliten me një gotë ujë të pastër (~200ml) derisa pacienti qëndron ulur apo në këmbë. Pacientët nuk duhet të shtrihen për 30 minuta pas marrjes së tabletës. Acidi Alendronik është i disponueshëm në formë të efervetave apo tabletave solubile 70 mg që treten me një gotë ujë (³120ml).

Acidi Risedronik 35mg një herë në javë me rrugë orale rekomandohet për trajtmin e osteoporozës postmenopausale, meshkujt me osteoporozë si dhe pengimin e osteoporozës së indukuar nga glukokortikoidet në femrat.

a. Doza prej 35mg/ditë javore konsiderohet ekuivalente me dozën e aprovuar paraprakisht prej 5mg ditë.

b. Në gratë pas menopauzës me osteoporozë aicid risedronik, është treguar që redukton frakturat vertebrale dhe jo vertebrale (182,183) (Niveli i evidencës Ib). Në popullatën e gjërë në gratë e moshuara, acidi risedronik redukton rrezikun nga frakturat e femurit në mënyrë signifikante, efekt shumë më i madh në gratë pas menopauzës (64) (Niveli i evidencës Ib). Aprovimi për përdorimin e acidit risedronik në meshkuj me osteoporozë dhe gratë pas menopauzës që marrin glukokortikoide. është bërë në bazë të studimeve për strukturën e BMD (184-186) (Niveli i evidencës Ib).

c. Efektet e zakonshme anësore përfshijnë simptomat e traktit të sipërm digestiv, çrregullimet e zorrëve, kokëdhimbjen dhe simptomat muskuloskeletike.

d. Acidi risedronik duhet të merret pas një nate esëll së paku 30 min para ushqimit apo pijes (me perjashtim të ujit), apo produkteve tjera medicinale si dhe suplementeve (përfshirë kalciumin). Tabletat duhet të përtypen të tëra me një gotë ujë të pastër gjersa pacienti qëndron ulur apo në këmbë. Pacientët nuk duhet të shtrihen për së paku 30 min pas marrjes së tabletës.

Acidi Ibandronik 150mg një herë në muaj apo 3 mg si injeksion intravenoz (zakonisht jepet për 15-30 sekonda duke e shtyrë përmes kanilës në trajtë të fluturës çdo 3muaj, i rekomanduar për trajtimin e osteoporozës te gratë pas menopauzës.

a. Doza prej 150mg / muaj dhe 3mg çdo 3 muaj intravenoz konsiderohet ekuivalente.

- b. Në gratë pas menopauzës me osteoporozë, acidi ibandronik 2.5mg ditë ka treguar efekt në reduktimin e incidencës së frakturave vertebrrale (187) (niveli i evidencës IIb). Në analizën post hoc në gratë pas menopauzës me rrezik të lartë për fraktura (me BMD të qafës së femurit T score nën 3.0), është treguar një reduktim signifikant i frakturave jo vertebrrale (188) (niveli i evidencës Ib). Nuk ka të dhëna të disponueshme për të treguar efikasitetin në reduktimin e rrezikut për fraktura të femurit. Aprovimi për përdorimin e dozës prej 150 mg njehërë në muaj dhe 3 mg intravenoz çdo 3 muaj është bërë në bazë të strukturës së BMD (189,190) (niveli i evidencës Ib).
- c. Efektet anësore të zakonshme të terapisë orale përfshijnë shqetësimet e pjesës së sipërme të traktit gastrointestinal dhe çregullimet e zorrës. Administrimi intravenoz mund të shoqërohet me reaksione të fazës akute, simptoma të ngjashme me gripin, zakonisht janë kalimtare dhe zakonisht shfaqen pas injeksionit të parë.
- d. Forma orale e bisfosfonateve duhet të merret në mëngjes esëll një orë para se të merren ushqime apo lëngje (përpos ujit), apo produkte tjera medicinale si suplementet (përfshirë kalciumin). Tabletat duhet të përtypen me një gotë ujë (180 deri 240ml) gjersa pacienti qëndron ulur apo në këmbë. Pacientët nuk duhet të shtrihen një orë pas marrjes së tabletës.

Acidi Zoledronik 5mg një herë në vit me infusion intravenoz (5mg/100ml infusion që jepet së paku brenda 15 minutave përmes kanilës intravenoze), rekomandohet për trajtimin e osteoporozës postmenopauzale, tek meshkujt me osteoporozë dhe gratë në postmenopauzë me osteoporozë të indukuar nga glikokortikoidet.

- a. Në gratë postmenopauzale me osteoporozë, acidi zoledronik 5 mg një herë në vit është treguar se redukton incidenten e frakturave vertebrrale dhe jo vertebrrale si dhe frakturave të femurit (191). (niveli i evidencës Ib). Aprovimi për përdorimin e acidit Zolendronik në meshkujt me osteoporozë, në meshkujt dhe femrat që marrin glukokortikoide, është bërë mbështetur në studimet për ndërtimin e BMD (192,193) (niveli i evidencës Ib).
- b. Kur jepet menjehërë pas frakturave të femurit në meshkuj dhe femra acidi zoledronik 5mg, pacienti mund të ketë më pak fraktura dhe shkallë më të ulët të mortalitetit brenda 3 viteve (130) (niveli i evidencës Ib).
- c. Kur jepet (pa suplemente të kalciumit) çdo 18 muaj në gratë me osteopeni ka më rrallë fraktura vertebrrale jo vertebrrale dhe fraktura të femurit (138,194) (niveli i evidencës Ib). Një ulje edhe pse jo signifikante e mortalitetit në gratë pa fraktura, më pak raste me kancer të gjirit dhe kancere të tjera janë raportuar si fenomene pas një studimi 6 vjeçar.
- d. Efektet anësore më të zakonshme shfaqen zakonisht pas infusionit të parë që mund të minimizohen me dhënen e paracetamolit (195). Shkalla e filtrimit glomerular (eGFR) duhet të kalkulohet para inicimit të trajtimit me vëmendje të shtuar ndaj pacientëve me pamjaftueshmëri të veshkës. Të monitorohet çdo rritje në serum e kreatininës apo reduktim i

filtrimit glomerular. MHRA rekomandon shfrytëzimin e klirensit të kreatininës në vend të filtrimit glomerular që të merren vendime terapeutike në pacientët e moshës mbi 75vjeç dhe/apo BMI <18 ose $>40\text{kg}/\text{m}^2$. Një rritje incidencës së fibrilacionit atrial simptomatik, është raportuar si efekt anësor serioz në studimin trial të fazës III trial (191) (niveli i evidencës Ib).

3.20.2 Kundërindikacionet dhe paralajmërimet gjatë përdorimit të bisfosfonateve

Bisfosfonatet orale dhe intravenoze kundërindikohen në pacientët me hipokalcemi, hipersenzitivitet në bisfosfonate, në gratë shtatëzënë apo me gjidhënje.

Bisfosfonatet orale kundërindikohen në pacientët me abnormalitete të ezofagut, ku kalueshmëria nëpër ezofag vonohet si në struktura, akalazion dhe pamundësi për të qëndruar ulur apo në këmbë për të paktën 30-60 min. Ato duhet të përdoren me kujdes në pacientët me çrrregullime tjera gastrointestinale.

- a. Acidi Zoledronik dhe risedronik kundërindikohen në pamjaftueshmëri të rëndë të veshkës ($\text{GFR} \leq 35 \text{ ml}/\text{min}$ për acidin zoledronik dhe $\leq 30 \text{ ml}/\text{min}$ për acidin risedronik), gjersa acid ibandronik dhe alendronik duhet të jepen me shumë kujdes ($\text{GFR} \leq 35 \text{ ml}/\text{min}$ për acidin alendronik dhe $\leq 30 \text{ ml}/\text{min}$ për acidin ibandronik).
- b. Hipokalcemia preekzistuese duhet të hulumtohet dhe kur lidhet me mungesën e vitaminës D, duhet dhënë vitaminë D (p.sh., 100.000 deri 300.000 IU me rrugë orale ose si dozë sulmi në doza të ndara) para se të fillohet trajtimi me zolendronik acid.
- c. Efektet e rralla anësore të trajtimit të zgjatur me bisfosfonate përfshijnë osteonekrozën e nofullës dhe frakturat atipike femorale.

3.20.3 Medikamentet antiresorbitive: Denosumab

Denosumab është antitrup monoklonal human kundër receptorëve aktiv të faktorit nuklear KappaB Ligand (RANKL), një rregullator madhor i zhvillimit të osteoklasteve dhe aktivitetit të tyre. Është aprovar për trajtimin e Osteoporozës postmneopauzale dhe tek meshkujt me rrezik për frakturna, për trajtimin e humbjes kockore shoqëruar me ablacion hormonal në meshkujt me kancer të prostatës dhe rrezik të lartë për frakturna si dhe për trajtimin e humbjes kockore shoqëruar me përdorim afatgjatë të terapisë me glukokortikoide sistemike në adultët me frakturna fragjile (196) (niveli i evidencës Ib).

Denosumab jepet me rrugë subkutane 60 mg njëherë në 6 muaj është treguar se Denosumab ulë rrezikun për frakturna vertebruale dhe jo vertebrale, frakturna të femurit në gratë pas menopauzës që kanë osteoporozë (197). Siguria dhe efikasiteti i trajtimit janë treguar deri 10 vite (198) (niveli i

evidencës Ib). Aprovimi për përdorim të Denosumabit në meshkuj me osteoporozë është bërë në bazë të studimeve për ndërtimin e densitetit kockor (199) (niveli i evidencës Ib).

- a. Denosumabi kundërindikohet në pacientët me hipokalcemi apo me hipersenzitivitet në ndonjërin nga përbërësit e formulës së medikamentit. Përdorimi i tij nuk rekomandohet në shtatëzëni apo në moshën nën <18 vjeç.
- b. Hipokalcemia si efekt trajtimit me denosumab, rrit shkallën e dëmtimit të veshkës andaj pacientët duhet të këshillohen që të raportojnë simptomat e hipokalcemisë. Hipokalcemia preekzistuese duhet të hulumtohet dhe nëse është pasojë e mungesës së vitaminës D duhet trajtuar me vitamin D (p.sh. dozat prej 100.000 deri 300.000IU) në formë orale si dozë sulmi në doza të ndara, para se të fillohet trajtimi me denosumab. Marrja adekuate e kalciumit dhe vitaminës D është e rëndësishme tek të gjithë pacientët, vecanarisht në ata me dëmtim të funksionit renal.
- c. Qëndrimet e SPC citojnë që çdo pacienti duhet t'i matet niveli i kalciumit para se cilës dozë të terapisë me Denosumab. Në pacientët e predispozuar për hipokalcemi (p.sh. pacientët me klirens të kreatininës $<35\text{ml/min}$), niveli i kalciumit në serum duhet të matet dy javë pas dozës iniciale (200).
- d. Efektet anësore përfshijnë infekzionet e lëkurës me predominim të celulitit, ekzemës, hipokalcemisë dhe flatulencës. Efektet anësore të rralla të denosumabit përfshijnë osteonekrozën e nofullës dhe frakturat atipike të femurit.
- e. Ndërprerja e Denosumabit çon në ulje rapide të densitetit kockor dhe ngritjen e faktorëve të remodelimit kockor mbi vlerat e para fillimit të trajtimit (201-203) (niveli i evidencës Ib).
- f. Pacientët që ndërprejnë Denosumabin kanë rrezik të lartë për frakturna multiple vertebrare. Në analizën posthoc nga studimi FREEDOM dhe zgjerimi i tij gratë ku është ndërprerë denosumab kanë pas një rritje të rrezikut për frakturna vertebrare për një periudhë 3-6 muaj pasi injeksionit të fundit të denosumabit. Nga pacientët që pësojnë frakturna vertebrare, 60.7% kanë frakturna multiple krahasuar me 38.7% të atyre që kanë ndërprerë terapinë placebo (204,205) (niveli i evidencës Ib).
- g. Rritja e rrezikut për frakturna vertebrare që përcjell ndërprerjen e terapisë me Denosumab tregon nevojën për shqyrtojmë mundësinë e trajtimit me terapi alternative antiresorbitive pas tërheqjes së terapisë me denosumab. Infusioni intravenoz prej 5mg i acidit zoledronik, 6 muaj pas injeksionit të fundit të Denosumab redukton mundësinë e humbjes kockore, megjithëse ky efekt nuk shihet te të gjithë pacientët dhe mund të mos vërehet brenda vitit, sidomos te pacientët e mjekuar me Denosumab mbi 3 vite (206-210, 211) (niveli i evidencës IIa dhe IIb). Monitorimi i markerëve të remodelimit kockor për 3 dhe 6 muaj pas infusionit me Zoledronik acid mund të ndihmoj në vlerësimin e periudhës kohore për dhënen e infusionit të ardhshëm. Kur markerët e remodelimit kockor nuk janë të disponueshëm, një infusion i dytë me

Zoledronik acid pas 6 muajve duhet të propozohet (212) (niveli i evidencës IV). Dhënia orale e acidit alendronik 70mg një herë në javë, është treguar që mban densitetin kockor për 12 muaj në shumicën e pacientëve, pasuar terapinë me Denosumab të dhënë për një vit, megjithëse humbje madhore e kockës nuk është vënë re (213) (niveli i evidencës Ia). Mbështetur në vështirësitë që pasojnë ndërprerjen e Denosumab, konsideratë e veçantë duhet para fillimit të kesaj terapië në femrat e reja pas menopauzës dhe meshkujt e rinjë.

3.20.4 Medikamentet antiresorptive - Terapia zëvendësuese hormonale: (HRT)

Terapia zëvendësuese hormonale HRT përfshin numër të madh të formulimeve të estrogjenit, dhe kombinimeve të progesteronit, disa nga të cilat janë aprovuar për parandalimin e osteoporozës postmenopauzale në gratë me rrezik për frakturna fragjile. Estrojenet e konjuguara 0.625mg ditë \pm 2.5mg/ditë siç janë medroxyprogesterone acetate është treguar të janë efikase në reduktimin e rrezikut për frakturna vertebruale dhe jo vertebruale si dhe frakturna të femurit në gratë postmenopausale të selektuara jo në bazë të densitetit të ulët kockor apo rrezikut të lartë për frakturna (214,215) (niveli i evidencës Ib).

- Raporti benefit-risk në përdorimin e terapisë zëvendësuese hormonale në gratë pas menopauzës të moshave 53-79 vjeç, është rishikuar në vitin 2017. Gratë që përdorin terapi vetëm me estrojen krahasuar me placebo kanë rrezik signifikant më të ulët nga frakturat, por rrezik signifikant më të lartë nga sëmundjet e fëshikëzës së tëmthit, insultet, tromboembolizmi venoz dhe inkontinenca urinare. Gratë që përdorin terapi të kombinuar estrojen me progestin krahasuar me placebo kanë rrezik signifikant më të ulët për frakturna, por rrezik signifikant më të lartë për kancer invasiv të gjirit, por edhe demencës, sëmundjeve të fëshikëzës së tëmthit, insulteve, inkontinencës urinare, trombomebolizmit venoz (216) (niveli i evidencës Ib).
- Një rishikim më origjinal i bërë kohët e fundit ka konkluduar se profili benefit-risk mbështet përdorimin e terapisë zëvendësuese hormonale në menaxhimin e osteoporozës në gra < 60 vjeç të cilat kanë hyrë së fundi në menopauzë (brenda 10 viteve), që kanë simptoma të menopauzës dhe kanë rrezik të ulët për efekte anësore (217) (niveli i evidencës IIa).

3.20.5 Medikamentet antiresorptive: Calcitriol

Calcitriol (1,25-dihydroxyvitamin D₃) është formë aktive e vitaminës D e aprovuar për trajtimin e osteoporozës postmenopauzale. Përdoret si formë orale në dozë prej 0.25 μ g dy herë në ditë. Vepron duke inhibuar resorbimin kockor. Është treguar se redukton rrezikun nga frakturat vertebruale në gratë pas menopauzës me osteoporozë, por nuk ka treguar efekt në pengimin e frakturave jo vertebruale dhe frakturave të femurit (218) (niveli i evidencës IIb). Është i kundërindikuar në pacientët me hiperkalcemi apo kalcifikime metastatike. Duke marrë parasysh se kalcitrol mund të

shkaktoj hiperkalcemi ose hiperkalciuri, niveli i kalciumit në serum dhe niveli i kreatininës duhet të monitorohet në muajin 1, 3 dhe 6 pas trajtimit fillestar dhe më pas çdo 6 muaj.

3.20.6 Medikamentet antiresorptive: Raloxifene

Raloxifene është modulator selektiv i receptorëvë estrogjenikë që inhibon resorbimin kockor. Është aprovuar për trajtimin dhe pengimin e osteoporozës në gratë pas menopauzës. Raloxifene është treguar se redukton rrezikun nga frakturat vertebrale por nuk ka ndikim në reduktimin e rrezikut nga fraktuar jo vertebrale apo të femurit (219) (niveli i evidencës Ib).

- a. Raloxifene merret si terapi orale në dozë të vetme ditore 60mg, mund të merret në çdo kohë pavarësisht nga ushqimi.
- b. Raloxifene kundërindikohet në gratë në fazën e reproduksionit, tek gjakderdhjet gjinekologjike të rënda, sëmundjet e mëlçisë dhe veshkës, si dhe në gratë me histori për tromboembolizëm venoz.
- c. Efektet anësore përfshijnë ngërrçet e këmbës, enjtjet dhe simptomat vasomotore. Është raportuar shkallë e ulët e rrezikut nga tromboebolia venoze dhe goditjet në tru (220) (niveli i evidencës IIa) kështu që duhet të përdoret me kujdes në gratë me histori për insulte apo faktorë të rrezikut për insulte.
- d. Në fazën III të trialit klinik, gratë e trajtuara me raloxifen kanë ulje signifikante të rrezikut për të zhvilluar kancer të gjirit (221) (niveli i evidencës Ib).

3.20.7 Medikamentet tjera: ranelate Strontium

Strontium ranelate merret në dozë prej 2g një herë në muaj natën si suspension oral në trajtë të granulave që treten në ujë së paku dy orë pas ushqimit apo konsumimit të produkteve të kalciumit. Si një metal alkaljin tokësor, ai (i afërt me kalciumin) përbëhet nga kalciumi i tretur në hydroksiapatite. Mekanizimi i tij i veprimit nuk dihet në tërësi por të dhënat sugerojnë për efekt të dobët antiresorbtiv derisa ndihmon formimin kockor.

- a. Në gratë pas menopauzës me osteoporozë, strontium ranelate 2g/ditë, është treguar se redukton incidencën e frakturave vertebrare dhe jo vertebrare (222,223) (niveli i evidencës Ib). Disa fraktura të femurit janë raportuar me analizën post hoc të gratë me rrezik të lartë për fraktura të femurit (p.sh. mosha ≥ 74 vjeç me BMD T-score të qafës së femurit ≤ -2.5)
- b. Aprovimi për përdorimin e tij në meshkuj me osteoporozë është bërë në bazë të studimeve për ndërtimin e BMD (224) (niveli i evidencës Ib).
- c. Efektet anësore të zakonshme përfshijnë nauzenë dhe diarrenë.

- d. Është vënë re rritje signifikante e troboembolizmit venoz në fazën III të trialit klinik (225).
- e. Kundërindikacionet përfshijnë infarktin e kaluar të miokardit, insultet, tromboembolizmin venoz, analiza post hok ka treguar rritje të infarktit të miokardit dhe çrregullimeve të sistemit nervor qendror përfshirë sëmundjet cerebrovaskulare në pacientët që marrin strontium ranelate krahasuar me placebo (226).
- f. Prodhuesi rekomandon që ky medikament të mos përdoret në pacientët me GFR<30ml/ml.
- g. Numri i madh i atomeve në përberje të strontiumit krahasuar me kalciumin, jep artefakte duke "rritur" BMD kur futet në matriksin kockor (227). Kështu që kur strontium ranelate ndërpritet, ky efekt zgjatet, medikamenti eliminohet gradualisht duke ndikuar në rezultat gjatë monitorimit të BMD.

3.20.8 Medikamentet anabolike:Teriparatide (hormone paratiroid human rekombinant [PTH]1-34)

Nëse jepet me ndërprerje, teriparatide ka efekte anabolike skeletale, që më së shumti vërehen në trabekulën kockore. Teriparatide është aprovuar për trajtimin e osteoporozës postmenopausale në gratë dhe meshkujt me rrezik për fraktura fragjile, si dhe osteoporozën që shoqëron terapinë sistemike me glukokortikoide në femra dhe meshkuj me rrezik nga frakturat fragjile.

- a. Teriparatide jepet me rrugë subkutane si injekzion subkutan në dozë 20 µg/ditë. Kohëzgjatja e trajtimit është e kufizuar në 24 muaj.
- b. Teriparatide kundërindikohet në pacientët me hiperkalcemi, sëmundje metabolike të kockave, si osteoporoza dhe osteogjeneza imperfekte, por edhe të tjera si sëmundjet kronike të veshkëve, sëmundjet malinje që prekin skeletin, rrezatimet, si dhe gratë shtatëzënë apo me gjidhënie. Teriparatide duhet të përdoret me kujdes në pacientët me pamjaftueshmëri të moderuar të veshkës.
- c. Nivelet e PTH duhet të janë normal para fillimit të terapisë me teriparatide, kështu që niveli duhet të përcakohet edhe kur kemi normokalcemi.
- d. Efektet anësore përfshijnë kokëdhimbjen, mundimin, hipotensionin postural, dhimbjet në këmbë. Një ngritje e ndjeshme dhe kalimtare e nivelit të kalciumit në serum mund të pasoj injekzionin Teriparatide.
- e. Teriparatide është treguar efikas në reduktimin e frakturave vertebrale dhe jo vertebrale në gratë pas menopauzës që kanë osteoporozë (228) (niveli i evidencës Ib). Nuk janë gjetur të dhëna efikase për incidencën e frakturave të femurit, por rishikimet sistematike dhe metaanalizat kanë treguar OR për rrezikun nga frakturat e femurit prej 0.44 (95% CI: 0.22, 0.87; p=0.019) në pacientët që trajtohen me teriparatide krahasuar me placebo, kur frakturat e

femurit merren si pikë referuese. Nuk janë vënë re benefite signifikante sa i përket frakturave të ekstremiteteve të sipërme (229) (niveli i evidencës Ia). Këto gjetje më pas janë suportuar nga metaanaliza e ngjajshme e RCT, që ka raportuar HR of 0.35 (95% CI: 0.15, 0.73) për frakturne femurit në pacientët e trajtuar me teriparatide krasuar me placebo (230) (niveli i evidencës Ia).

- f. Aprovimi për përdorimin e teriparatide në meshkuj me osteoporozë si dhe në meshkuj dhe femra me osteoporozë të indukuar nga glukokortikoidet është bërë në bazë të studimeve për strukturën e BMD (231,232) (niveli i evidencës Ib).
- g. Teriparatidi forma biosimilare tani është e pranishme në treg, gjë që do të përmirësojë kost-efektivitetin krasuar me formën gjenerike të Teriparatide.

3.20.9 Medikamentet anabolike: Romosozumab

Romosozumab është antitruk human monoklonal që lidhë dhe inhibon sklerostinën. Ai ka veprim të dyfishtë, stimulon formimin kockor dhe inhibon resorbimin kockor. Është i aprovuar për trajtimin e osteoporozës së rëndë në gratë pas menopauzës me rrezik të lartë për frakture. Aktualisht nuk është aprovuar për përdorim tek meshkujt. Jepet si injekzion subkutan në dozë prej 210 mg (administrohet në trajtë të dy injeksioneve subkutane 105mg secila) një herë në muaj. Kohëzgjatja e trajtimit është e kufizuar në 12 muaj.

- a. Në gratë pas menopauzës me osteoporozë që kanë marrë romosozumab 210mg apo placebo subkutan një herë në muaj për 12 muaj pasuar nga dhënia e denosumab 60mg subkutan në dy grupet për 12 muaj, frakturnat e reja vertebruale si dhe frakturnat klinike janë të reduktuara në mënyrë signifikante. Në gratë që trajtohen me romosozumab, krasuar me placebo gjatë 12 muajve, si dhe pas 24 muajsh niveli i frakturave vertebruale është dukshëm më i ulët në gratë e trajtuara me romosozumab gjatë 12 muajve 15 (niveli i evidencës Ib).
- b. Në studimin krasues kontroll tek gratë pas menopauzës me osteoporozë të rëndë, dhënia subkutane e romosozumab 210mg një herë në muaj për 12 muaj pasuar nga dhënia orale e acidit alendronik 70mg një herë në javë për 12muaj është krasuar me dhënen e acidit alendronik 70mg një herë në javë për 24muaj (116). Frakturnat e reja vertebruale, jo vertebruale, frakturnat klinike dhe të femurit janë në mënyrë signifikante më të ulëta në gra të trajtuara me romosozumab pasuar nga acidi alendronik, sesa në ato të trajtuara me alendronat si medikament i vetëm (niveli i evidencës Ib). Reduktëm i madh signifikant i rrezikut nga frakturnat e reja vertebruale dhe frakturnat klinike është vënë re tek romosozumabi krasuar me acidin alendronik për 12 muaj. Një rritje signifikante e incidencës së sëmundjeve kardiovaskulare është vënë re në grupin me romosozumab krasuar me grupin që përdorin acid alendronik 115 (niveli i evidencës Ib).

- c. Romosozumab kundérindikohet në pacientët me hipokalcemi, hipersenzitivitet ndaj ndonjërit prej përbërësve të formulës, apo tek njerëzit me histori për infarkt të miokardit apo insulte.
- d. Kur duam të vendosim për dhënien e romosozumab tek ndonjë pacient, duhet vlerësuar rrezikun nga frakturnat dhe insultet kardiovaskulare, pas një viti të përdorimit.
- e. Hipokalcemi transitore është vënë re në pacientët që marrin romosozumab. Hipokalcemia duhet korrigjuar para fillimit të trajtimit dhe pacientët duhet të marrin suplemente me kalcium dhe vitaminë në mënyrë adekuate. Pacientët me pamjaftueshmëri të rëndë të veshkës apo që janë në dializë kanë rrezik të lartë për të zhvilluar hipokalcemi. Osteonekroza e nofullës dhe frakturnat atipike të femurit janë raportuar rrallë pas përdorimit të romosozumab.

3.20.10 Trajtimi me barna tek pacientët me rrezik të lartë për fraktura

3.20.10.1 Përbledhje e të dhënave

- a. Dy studime krahasuese të randomizuara kontrolluese në gratë pas menopauzës me osteoporozë të rëndë kanë demonstruar efikasitet superior ndaj frakturnave të agjentëve anabolikë skeletal krahasuar me medikamentet antiresorbitive. Dhënia subkutane e romosozumab prej 210mg një herë në muaj rezulton me reduktim signifikant të rrezikut të frakturnave vertebrale, klinike dhe frakturnave të femurit brenda 24 muajve (reduktim i rrezikut 48%, 19%, 27% dhe 38% respektivisht) dhe reduktim signifikant i rrezikut nga frakturnat vertebrale klinike brenda 12 muajve krahasuar me acidin alendronik, formën orale 70 mg, një herë në javë. Në frakturnat vertebrale studimi për trajtimet krahasuese në gratë me Osteoporozë (VERO), teriparatide subkutan, 20 µg një herë në ditë, është shoqëruar me frakturna të reja vertebrale dhe frakturna klinike, krahasuar me acidin risedronik 35mg një herë në javë (56% dhe 52% respektivisht) pas dy vitesh të trajtimit (233) (niveli i evidencës Ib). Këto studime tregojnë arsyet që lejojnë që teriparatide dhe romosozumab mund të përdoren si linjë e parë e trajtimit në gratë pas menopauzës me rrezik të lartë për frakturna. Studimet krahasuese të agjentëve antiresorbitive dhe anabolikë nuk janë raportuar tek meshkujt.
- b. Pasuar ndërprerjen e trajtimit me teriparatide apo romosozumab, markerët e remodelimit kockor rriten dhe shihet një rënje e BMD. Pasi kohëzgjatja maksimale e trajtimit me teriparatide është 24 muaj dhe me romosozumab 12 muaj, terapia pasuese me antiresorbativ kërkohet me qëllim që të mbeten efektet e duhura në kockë.
- c. Që të dy acidi alendronik dhe denosumab kanë treguar që rrisin BMD në pjesën lumbale dhe femurit, pasuar terapinë qoftë me teriparatide ose romosozumab (116,234-237). Në studimin e zgjeruar FRAME, efektet beneficiale të romosozumab për 12 muaj terapi ndikimi në rrezikun nga frakturnat vertebrale dhe jo vertebrale ka mbetur prezent gjatë periudhës prej

24 muajsh nga trajtimi me denosumab (238) (niveli i evidencës IIb).

d. Kur gratë kanë kaluar nga terapia me bisfosfonate orale në teriparatide ose romosozumab, është vënë re një pakësim i rritjes së densitetit kockor në regjionin lumbal dhe të femurit krahasuar me periudhën kur këta agjentë janë përdorur. Ky efekt diskret është më i lartë tek teriparatidi sesa romosozumabi, vecanarisht tek frakturat e femurit (239,240) (niveli i evidencës IIb). Ndikimi i këtyre efekteve, nëse veç ka ndonjë, në rritjen e rrezikut për fraktura është i panjohur.

e. Në gratë e trajtuar paraprakisht me denosumab, e që kalojnë në teriparatide vërehet një humbje transitore e masës kockore në regjionin spinal dhe humbje më e madhe më e gjatë e humbjes kokcore në regjionin e femurit (235). Kur romosozumab jepet pas Denosumab, shihet një rënie e rritjes së BMD në regjionin spinal dhe regjionin e femurit (241) (niveli i evidencës IIb). Ndikimi i këtyre efekteve në rrezikun nga frakturat është i panjohur.

3.21 Strategjité për menaxhimin e osteoporozës dhe rrezikut nga frakturat

3.21.1 Kohëzgjatja dhe monitorimi i trajtimit me bisfosfonate

Osteoporoza, është gjendje afatgjatë për të cilën aktualisht nuk ka shërim, andaj kërkohet trajtim gjatë tërë jetës, për të monitoruar dhe penguar frakturat.

3.21.1.1 Rekomandimet

1. Planifiko përshkrimin e bisfosfonateve orale (acidit alendronik, acidit ibandronik dhe acidit risedronik) për së paku 5 vite dhe më pas rivlerëso rrezikun nga frakturat. Trajtimi i gjatë së paku 10 vite, rekomandohet në gratë dhe burrat (*rekomandim i fugishëm*) (shih figurën 4):

- Mosha ≥ 70 vjeç në kohën kur është filluar terapia me bisfosfonate
- Ata të cilët kanë histori për fraktura vertebruale apo të femurit në të kaluarën (s)
- Trajtimi me glukokotikoide orale $\geq 7.5\text{mg}$ prednisolone/ditë apo ekivalent
- Ata që kanë përjetuar një apo më shume fraktura fragjile gjatë 5 viteve nga trajtimi (nëse trajtimi nuk ka ndryshuar).

2. Planifiko që të përshkruhen bisfosfonate intravenoze (pra zoledronik acid) së paku 3 vite e më pas që të rivlerësohet rreziku nga frakturat. Trajtimi më i gjatë së paku 6 vite, rekomandohet në gratë dhe burrat (*rekomandim i fugishëm*) (shih figurën 5):

- Mosha ≥ 70 vjeç në kohën kur terapia me bisfosfonate është filluar
- Ata që kanë fraktura paraprake të vertebrave apo femurit (s)

- Trajto me glukokortikoide orale $\geq 7.5\text{mg}$ prednisolone/ditë ose ekivalente
- Ata që përjetojnë një apo disa frakturna fragile gjatë 3 viteve të para të trajtimit (nëse trajtimi nuk është ndryshuar).

3. Nëse frakturë e re ndodh pasi terapia me bisfosfonate është ndërprerë, rivlerëso shfrytëzimin e FRAX dhe rifillo trajtimin (*rekomandim i fuqishëm*).

4. Nëse trajtimi me bisfosfonate është ndërprerë dhe nuk është shfaqur asnjë frakturë e re, duhet rivlerësuar duke përdorur FRAX pas 18 muajve për risedronik acid dhe acid ibandronik, dy vite për acid alendronik dhe 3 vite për acid zolendronik, që të informohet nëse trajtimi duhet rifilluar (*rekomandim i fuqishëm*).

3.21.1.2 Të dhënrat evidente

- a. Terapia me bisfosfonate shoqërohet me efekte të rralla por serioze, sidomos frakturna atipike të femurit (AFF) dhe osteonekrozë tënofullës (ONJ). Duhet definuar kohëzgjatja optimale e terapisë me bisfosfonate, me qëllim që të sigurohemi që rreziku nga frakturnat është reduktuar duke ulur rrezikun nga nekroza avaskulare e femurit dhe ostenekroza enofullës (AFFsONJ), përmes meaxhimit të vazhdueshëm.
- b. Bisfosfonatet mbisin kohë të gjatë në kocka duke treguar benefite një kohë të gjatë pas ndërprerjes së terapisë. Kjo ka rritur mundësinë që në disa pacientë të kemi benefit në periudhat e trajtimit, të rivendoset balancë midis rrezikut dhe benefitit (242) (niveli i evidencës IIa), në të cilët trajtimi është ndërprerë pas disa vitesh dhe nevoja përrikyçje në terapi duhet rivlerësuar patjetër. Rishikimi i terapisë në pacientët me bisfosfonate është gjithashtu kritik, andaj çdo pacient duhet vlerësuar në mënyrë individuale që të vlerësohet rreziku relativ dhe benefitet, pasi nuk ka protokol standard për të gjithë pacientët (205) (niveli i evidencës IIa). Pasi trialet klinike më të rendësishme e kanë limituar kohëzgjatjen në tri vite, rekondimet përpërdorim më të gjatë dhe për pushim nga terapia janë bazuar në të dhëna të kufizuara nga studimet e gjera në gratë pas menopauzës (244,245) (niveli i evidencës IIa). Aktualisht nuk ka të dhëna evidente që do të mbështesin rekondimet specifike tek meshkujt.
- c. Tërheqja e bisfosfonateve nga terapia shoqërohet me ulje të BMD dhe rritje të markerëvë të remodellimit kockor, pas 2-3 vitesh për acidin alendronik (246,247) (niveli i evidencës Ib), dhe 1-2 vite për acidin ibandronik dhe acidin risedronik (248,249) (niveli i evidencës Ib). Në rast të t'rheqjes së acidit Zolendronik nga terapia 3 vite pas trajtimit, është vënë re një ulje e vogël e BMD, në 3 vitet e ardhshme pa trajtim (250) (niveli i evidencës Ib). Krahasimi midis acidit alendronik dhe Zolendronik gjatë 3 viteve ka tregar se pacientët e trajtuar me acid alendronik kanë shënuar reduktim më të madh të densitetit kockor të femurit dhe rritje më të madhe të PINP, përkundër trajtimit afatgjatë me acid alendronik duke mbështetur t'rheqjen më

të shpejtë të medikamentit kahasuar me zolendronik acid (251) (niveli i evidencës IIb).

Në trialin klinik për intervenim ne fraktura (*Fracture Intervention Trial Long-term extension study of alendronate* (FLEX)), në mënyrë signifikante janë vënë re më shumë fraktura vertebrale në gratë paraprakisht të trajtuara me acid alendronik për 5 vite, që kanë vazhduar me acid alendronik edhe për 5 vite të ardhshme, kahasur me gratë që pas 5 viteve me acid alendronik kane kaluar në placebo (247) (niveli i evidencës Ib). Në studimin **HORIZON (Health Outcomes and Reduced Incidence with Zoledronate Once Yearly)** rreziku nga frakturat vertebrale morfometrike ka qenë në mënyrë signifikante më i ulur në gratë që kanë vazhduar terapinë me Zoledronic acid 3 vite pas terapisë fillestare prej 3 vitesh, kahasuar me grupin e grave që kanë kaluar në placebo (250) (niveli i evidencës Ib). Analizat post hoc nga terapia me acid alendronik dhe zolendronik, studime të gjera kanë treguar se gratë shumë më tepër përfitojnë nga terapia afatgjatë me bisfosfonate nëse kanë densitetin kockor në regionin e femurit të ulur ($T\text{-score} < -2.0$ sipas FLEX dhe ≤ -2.5 sipas HORIZON), kahasuar me ato gra që kanë fraktura vertebrale apo ato që kanë pas një apo disa incidente me fraktura gjatë periudhës fillestare të trajtimit 3-5 vite (70) (niveli i evidencës IIb). Moshat e vjetra po ashtu shoqërohen me rrezik të lartë për fraktura pas ndërprerjes së terapisë me acid alendronik (252) (niveli i evidencës Ib).

3.22 Rivlerësimi i rrezikut nga frakturat në individët nën trajtim me barna kundër osteoporozës

3.22.1 Rekomandimet

5. Rishikimi i përshtatjes ndaj trajtimit në gratë dhe meshkujt që gjersa janë nën trajtim pësojnë fraktura fragjile (përshtatje e dobët llogaritet kur së paku 80% e trajtimit është bërë saktë) dhe hulumtimi i shkaqeve sekondare të osteoporozës (*rekomandim i fugishëm*).
6. Vlerësimi i rrezikut nga frakturat në pacientët që marrin trajtim, duhet bërë duke shfrytëzuar FRAX score me BMD përmes rregullimit aritmetik duke futur në llogaritje edhe faktorët tjera të riskut. Nëse nga FRAX score rezulton se probabiliteti për fraktura e tejkalon pragun më të ulët për intervenim, atëherë duhet të vazhdohet trajtimi me medikamente (*rekomandim i fugishëm*).
7. Nëse markerët biokimikë të remodelimit kockor indikojnë relaps nga suprimimi i remodelimit kockor dhe/ose BMD është ulur si pasojë e ndërprerjes së bisfosfonateve, atëherë duhet të merret në konsideratë rikyçja në terapi (*rekomandim me kusht*).
8. Pas 10 viteve në trajtim me bisfosfonate, trajtimi i çdo pacienti duhet bërë në baza individuale (*rekomandim me kusht*).

3.22.2 Përbledhje e të dhënave evidente

- a. Ndërprerja e trajtimit ndaj Osteoporozës, qofshin këto bisfosfonate apo denosumab, shoqërohet me rritje të rrezikut për frakturna fragjile. Kështu që kjo ndërprerje e terapisë antiresorptive (e quajtur “pushim nga medikamentet”) nuk ka gjetur mbështetje në rishikimet e evidencuara (205) (niveli i evidencës IIa).
- b. Rivlerësimi i rrezikut nga frakturnat në individët e trajtuar bëhet në bazë të FRAX me matjen e densitetit kockor në regjionin e femurit 141 (niveli i evidencës IIb). Sipas NOGG, pragu i ndërhyrjes mund të shfrytëzohet që të merret vendim se kur të ndërpritet trajtimi për një periudhë kohore. (figura 4 dhe 5). Ndërsa, FRAX nuk mund të përdoret për vlerësimin e përgjigjes në trajtim (141) (niveli i evidencës IIb), ai luan një rol në rivlerësimin e rrezikut aktual për frakturna që të përcaktohet shkalla e indikacionit për vazhdimin ose jo të trajtimit.
- c. Detektimi i efektit të medikamentit dhe indikacionit për vazhdim, duke përdorur densitetin kockor dhe ndryshimet në faktorët e remodelimit kockor, përbëjnë informacion që ndikon në menaxhimin klinik. Megjithatë nuk ka të dhëna të mjaftueshme që lidhin pragun e ndryshimit të densitetit kockor apo markerëve kockor, që do të kishte rëndësi klinike gjatë marrjes së medikamentit.

3.23 Efektet anësore të rralla të terapisë afatgjatë me bisfosfonate dhe trajtimit me denosumab

3.23.1 Rekomandimet

9. Gjatë terapisë me bisfosfonate ose denosumab, inkurajo pacientët që të mbajnë higjenë orale të mirë, që të bëjnë kontrolla të rregullta dentare dhe të raportojnë çdo simptomë orale siç është lëvizja e dhëmbëve, dhimbja apo enjtja (*rekomandim i fuqishëm*).
10. Në pacientët me sëmundje të rëndë të dhëmbëve që kërkojnë terapi me bisfosfonate, apo denosumab, shikimi i dhëmbëve, trajtimi nga kirurgu oral me përvojë duhet bërë para fillimit të administrimit të medikamentit, duke pasur parasysh se trajtimi duhet filluar sa më parë te pacientët me frakturna fragjile; ekipa multidisciplinare kyçet me qëllim të inkurajimit dhe këshillimit të çdo pacienti (*rekomandim me kusht*).
11. Gjatë trajtimit me bisfosfonate apo denosumab, edhe pse pacientët në përgjithësi duhet minimizuar procedurat invasive dentare, kur patjetër indikohet, ato kryhen pa komplikime në shumicën e pacientëve. Kur procedurat dentare kërkohen, nuk ka të dhëna të disponueshme për kohën e ndërprerjes së terapisë që të reduktohet rreziku nga osteonekroza e nofullës (ONJ). Çdo mjek duhet ta marrë vendimin klinik në baza individuale mbështetur në vlerësimin benefit-risk, duke siguruar që pacientët të vazhdojnë të kujdesen për dhëmbët e tyre duke mbajtur higjenë

orale (*rekomandim i kushtëzuar*).

12. Gjatë terapisë me bisfosfonate apo denosumab, duhet të këshillohen pacientët që të raportojnë çdo dhimbje të msukujve, pelvikut ose femurit. Nëse këto simptoma shfaqen, atëherë duhet bërë grafi e femurit scintigrafî, apo MRI (*rekomandim i fuqishëm*).

13. Nëse identifikohet nekrozë avaskulare e femurit, atëherë duhet bërë grafi e femurit kontralateral (*rekomandim i fuqishëm*).

14. Të gjithë pacientët që zhvillojnë nekrozë avaskulare të femurit duhet referuar tek specialisti i osteoporozës që të informohet për menaxhimin dhe shëndetin kockor në të ardhmen (*rekomandim i fuqishëm*).

15. Në pacientët që zhvillojnë nekrozë avaskulare të femurit, duhet ndërprerë bisfosfonatet apo trajtimin me denosumab (*rekomandim i kushtëzuar*).

3.23.2 Përbledhje e të dhënave

- a. Osteonekroza e nofullës (ONJ) ndodh shumë rrallë në pacientët që marrin bisfosfonate apo denosumab për trajtimin e osteoporozës. Incidencia e vlerësuar në pacientët që marrin bisfosfonate është 10-100/100.000 persona në vit – sipas trialeve klinike. Faktorët e rezikut për ONJ përfshijnë higjenën e dobët orale, sëmundjet e dhëmbëve, kancerin, duhanpirjen, kemioterapinë dhe/apo glukokortikoidet (253,254) (niveli i evidencës IIa). Incidencia e Osteonekrozës së nofullës është më e madhe në dozat e larta të bisfosfonateve apo denosumabit, kur përdoren tek pacientët me sëmundje malinje, metastaza kockore. Programi Skocez për efikasitetin klinik dentar ka përpiluar udhërrëfyes për menaxhimin e higjenës orale në pacientët me medikamente antiresorbitive (255).
- b. Osteonekroza e kanalit të jashtëm auditiv, pas trajtimit me bisfosfonate është përshtkuar shumë rrallë në raportimet klinike, me pacientët me simptome të infeksionit kronik të veshit. Faktorët e mundshëm të rezikut janë steroidet, kemioterapia dhe/ose infeksionet dhe traumat (256) (niveli i evidencës IV).
- c. Frakturnat atipike të femurit (AFF), kryesisht të regjionit subtrohanterik dhe diafizal janë raportuar rrallë në pacientët që marrin bisfosfonate apo denosumab për të trajtuar osteoporozën. Përkuljet e femurit, përdorimi i kortikosteroideve janë idenifikuar si faktorë të rezikut (257). Rishikimi i fundit i bërë nga ASBMR TaskForce për menaxhimin e pacientëve me osteoporozë në terapi me kohë të gjatë me bisfosfonate, kërkimi sistematik i literaturës ka treguar se reziku absolut është i ulët, duke u radhitur midis 3.2-50 raste /100,000 persona – të eksponuar në vit (258,259) (niveli i evidencës IV). Ky vlerësim është bërë në përdorimin e bisfosfonateve në kohëzgjatje të dyfishtë kohore (>3 vite, mesatarja e kohës 7 vite), dhe ulet edhe më pas ndërprerjes së terapisë 258,259 (niveli i evidencës IV) (260) (niveli i evidencës

IIa).

d. Në studimin nacional kohort Danez, shfrytëzimi i alendronatit mbi 10 vite, është shoqëruar me ulje të rrezikut nga frakturat e femurit për 30% dhe pa rritje të rrezikut të frakturave të subtrochanterit, qafës së femurit, duke mbështetur një raport të pranueshëm midis bilancit benefit-risk në rrezikun nga frakturat në të ardhmen (261) (niveli i evidencës IIb).

e. Frakturat atipike të femurit janë zakonisht bilateral, shoqëruar me dhimbje prodromale, djegësimë. Dhimbja prodromale mund të ndihet në muskuj, kërdhokulla apo femur për ditë të tëra, javë apo muaj para frakturës. Ndërprerja e bisfosfonateve apo denosumabit, këshillohet në pacientët që zhvillojnë fraktura atipike, aktivitet me peshë ngritje i cili duhet reduktuar, marrje adekuate e kalciumit dhe vitaminës D duhet të bëhet në mënyrë adekuate si dhe trajtimet alternative duhet marrë në konsideratë. Trajtimi kirurgjik me ndërhyrje në palcën kockore duhet të merret në konsideratë. (258,259) (niveli i evidencës IV).

f. Ka pak të dhëna për trajtimin medikamentoz dhe efektin e tij në përmirësimin e kualitetit kockor, tek nekroza avaskulare e femurit AFF. Megjithatë dokumente aktuale nga ekspertët ndërkombe tarë mbështetur nga përditësimet sistematike kanë propozuar matje praktike që të ndihmojmë në menaxhimin e pacientëve (262) (niveli i evidencës IV). Pas një nekroze avaskulare të femurit nëse rreziku nga frakturat fragjile, është i ulët atëherë nuk jepen medikamente. Nëse rreziku nga frakturat është i lartë dhe nëse është bërë fiksim kirurgjik në dy anët e frakturës, atëherë duhet marrë në konsideratë dhënia e teriparatide, romosozumab, raloxifene, apo HRT. Efekti potencial i teriparatidit është në rigjenerimin e kockës pas nekrozës avaskulare, por të dhëna të limituara kanë treguar tendencë më të lartë të revaskularizimit pas trajtimit kirurgjik të nekrozës avaskulare të femurit. Nuk ka të dhëna evidente se teriparatide stimulon remodelimin kockor tek nekroza avaskulare por ka të dhëna të limituara se ky rigjenerim ndodh më shpejt pas intervenimit kirurgjik (plotësisht dhe jo plotësisht). Megjithatë tek nekroza avaskulare e menaxhuar në mënyrë konservative nuk është vënë re përmirësimi i modelimit kockor, rigjenerimit p.sh. me teriparatid 262 (niveli i evidencës IV). Raporti benefit-risk pas përdorimit të bisfosfonateve apo denosumabit pas nekrozës avaskulare të femurit duhet të ndiqet me kujdes, e nëse këto opsione terapeutike merren në konsideratë, atëherë duhet të aplikohen para intervenimit kirurgjik. Përdorimi i agentëve anabolike pas nekrozës avaskulare të femurit bëhet duke vlerësuar situatën e përgjithshme dhe rrezikun për fraktura (niveli i evidencës IV).

3.24 Osteoporoza e indukuar nga glukokortikoidet

3.24.1 Rekomandimet

16. Pasi humbja e masës kockore dhe rritja e rrezikut për fraktura ndodh herët pas inicimit të

terapisë me glukokortikoide orale, trajtimet për mbrojtjen e kockës duhet filluar në pacientët siç vijon në të njëjtën kohë me terapinë me glukokortikoide pa pritur vlerësimin e densitetit kockor, i cili duhet përcjellë më vonë (*rekomandim i fugishëm*):

- a. Tek çdonjëri me frakturna fragjile paraprake,
- b. Gratë e moshës ≥ 70 vjeç,
- c. Gratë pas menopauzës dhe meshkujt e moshës ≥ 50 vjeç, dozat e përshkruara të glukokortikoideve p.sh. ≥ 7.5 mg/ditë ose prednisolone ose ekuivalent gjatë 3 muajve (që është ekuivalente me dozën prej ≥ 30 mg/ditë të prednisone për 4 javë brenda 3 muajve),
- d. Gratë pas menopauzës dhe meshkujt ≥ 50 vjeç me FRAX probabilitet për frakturna madhore osteoporotike apo frakturna të femurit që kanë kaluar pragu e ndërhyrjes.

17. Bisfosfonatet orale (alendronate ose risedronate) apo acidi zoledronik intravenoz janë medikamentet me kosto efektive të linjës së parë për mbrojtjen kockore. Denosumab është alernativë e radhës. Teriparatide mund të jetë medikamenti i linjës së parë në pacientët me rrezik të lartë për frakturna (*rekomandim i fugishëm*).

18. Marrja adekuate e kalciumit duhet bërë përmes dietave, suplementeve kur është e nevojshme. Marrja adekuate e vitaminës D duhet bërë me suplemente kur kërkohet (*rekomandim i fugishëm*).

19. Nëse terapia me glukokortikoide ndërpritet, tërheqja nga medikamentet protektive të kockës duhet konsideruar të bëhet në të njëjtën kohë, duke bërë rivlerësimin e rrezikut nga frakturnat përmes FRAX, probabiliteti për frakturna madhore osteoporotike dhe frakturna të femurit shtrihet nën pragun minimal për intervenim (*rekomandim i fugishëm*).

20. Nëse glukokortikoidet përdoren kohë të gjatë, mbrojtja kockore duhet bërë në shumicën e rasteve (*rekomandim i fugishëm*).

21. Pacientët që marrin glukokortikoide në doza të vogla apo të moderuara, me FRAX afér por nën pragun minimal për intervenim terapeutik, duhet rivlerësuar me FRAX dhe BMD 12-18 muaj pas fillimit të terapisë me glukokortikoide (*rekomandim me kusht*).

Terapia protektive e kockës mund të jetë e nevojshme në disa gra para menopauzës dhe meshkuj të rinjë sidomos në ata me histori paraprake për frakturna, që marrin glukokortikode në doza të larta (≥ 7.5 mg/ditë apo prednisolone apo ekuivalent rreth 3 muaj). Duhet vëmendje dhe kujdes kur përshkruhen medikamente në gratë gjatë periudhës riproduktive. Referimi drejt kujdesit sekondar në rastet komplekse është shpesh i nevojshëm.

3.24.2 Përbledhje e të dhënave

- a. Edhe pse udhëzimet për parandalimin dhe menaxhimin e osteoporozës së indukuar nga glukokortikoidet janë zhvilluar në shumë shtete, ka të dhëna se në Britani të Madhe vlerësimi i rrezikut nga Osteoporozë dhe menaxhimi janë jo adekuat në pacientët që përdorin

glukokortikoide orale kohë të gjatë (263) (niveli i evidencës IIIb). Humbja e masës kockore dhe rritja e rrezikut për fraktura ndodh shpejtë pas fillimit të terapisë me glukokortikoide dhe rritet me rritjen e dozave të glukokortikoideve (55,264). Rritja e rrezikut për fraktura është vënë re në frakturat vertebruale, jo vertebrale, përfshirë frakturat e femurit dhe është pjesërisht i pavarur nga densiteti kockor BMD (56) (niveli i evidencës Ia).

b. Aprovimi për përdorimin e terapisë protektive ndaj osteoporozës në pacientët që marrin glukokortikoide orale, bazohet në studimet për ndërtimin e densitetit kockor, që është pjesë e trialit klinik. Faza III ku ceken bisfosfonatet (181,186,193,265,266). Aprovimi i ardhshëm është bërë për Denosumab duke përdorur të njëjtën metodologji. Pengimi i frakturave nuk është konsideruar si efikas në shumë konkludime të nxjerra nga trialet klinike (196). Megjithatë, edhe pse jo konkluzion primar, në studimin e radomizuar klinik në formë të trialit të kontrolluar me kohëzgjatje nga 18-36 muaj, ku është krahasuar teriparatide me alendronate, më tepër participantë kanë pasur fraktura vertebruale në grupin me teriparatide krahasuar me alendronat, por pa efekt në frakturat jo vertebrale. Mbrojtja nga frakturat vertebruale është konfirmuar në metaanalizën e fundit e cila tregon se përshkrimi i njëkohshëm i teriparatide, alendronate, risedronat apo denosumab me glukokortikoide, mund të reduktoj incidentën e frakturave vertebruale me të dhëna tjera në reduktimin e frakturave jo vertebrale nga përdorimi i alendronatit dhe teriparatidit (Tabela 7) (267) (niveli i evidencës Ia & Ib).

Tabela 13. Efekti i terapisë së aprovuar për trajtimin e osteoporozës së induktuar nga Medikamentet

Terapia mbrojtjen kockore	për BMD e regionit t. ë shpin. Ës	BMD e regionit të femurit	Frakturat vertebrale	Frakturat vertebrale	jo Tëdhënët për epërsinë për BMD të pjesës lumbale dhe femurit
Ac.Alendronik	Ib	Ia	Ia	Ia	Inferior ndaj teripatidit (Ib)
Ac.Risedronik	Ib	Ia	Ia	NAE	Inferior ndaj Zoledronikut (Ia)
Ac.Zoledronik	Ib	Ib	Ia	NAE	Superior ndaj acidit risedronik (Ib)
Denosumab	Ib	Ia	Ia	NAE	Superior ndaj bisfosfonateve (IIa)
Teriparatide	Ib	Ib	Ia	Ia	Superior ndaj acidit alendronik(Ib)

NAE: Nuk ka dëshmi në dispozicion.

c. Duke marrë në konsideratë rritjen e rrezikut për fraktura që shoqëron marrjen e dozave të larta të glukokortikoideve, vlerësimi me FRAX, tregon probabilitetin e frakturave mbështetur në dozën kufitare të prednisolonit (2.5–7.5 mg/ditë apo ekuivalent), dhe dozës më të lartë (≥ 7.5 mg/ditë ose ekuivalent). Individët që marrin dozë kufitare të prednisolone <2.5 mg/ditë do të kenë rrezik më të ulët për fraktura, si dhe përshtatja sipas moshave në terapi te gratë pas

menopauzës dhe meshkujt mbi ≥ 50 vjeç (është treguar në tabelën 8) (82) (niveli i evidencës IIb). Për doza shumë të larta të glukokortikoideve p.sh. $>20\text{mg/ditë}$ prednisolone apo ekuivalenti i tij nevojitet përfshirje më komplekse me qëllim të vlerësimit të probabilitetit për fraktura (55) (niveli i evidencës IIa).

d. Kur modeli FRAX i Britanisë së Madhe shfrytëzohet dhe përdorimi i glukokortikoideve është në kufi të pragut të lejuar shfaqen 2 pikë në NOGG grafikon, një për dozën mesatare dhe një për dozat më të larta (të definuara si mbi). Vlerësimi i pragut (probabiliteti për fraktura përmes BMD) dhe pragut për ndërhyrje terapeutike (probabilitetit për fraktura për ndërhyrje terapeutike) shfrytëzohen në të njëjtën mënyrë siç janë përshkruar për gratë pas menopauzës dhe meshkujt e moshuar.

Tabela 14. Përshtatja e FRAX që rrjedh nga probabiliteti për fraktura, vlerësuar sipas dozës ditore të prednisolone

Doza	Prednisolone doza ekuivalente (mg/ ditë)	Shtatja mesatare për probabilitetin e frakturave të femurit	Përshtatja mesatare për probabilitetin për frakturat madhore osteoporotike (MOF)
I ulët	<2.5	-35%	-20%
Mesatar	2.5-7.5	None	None
Lartë	≥ 7.5	+20%	+15%

3.25 Përdorimi i terapisë deprimuese të androgenit tek meshkujt

3.25.1 Rekomandimet

NOGG mbështetë udhërrëfyesit e fundit të publikuar nga Brown et al 2020 268.

22. Të gjithë meshkujt që kanë filluar terapinë deprivuese të androgjeneve (ADT) duhet vlerësuar shkallën e rrezikut për fraktura, duke përdorur FRAX, duke marrë në konsideratë se përdorimi i ADT është shkak i osteoporozës sekondare, si dhe duhet bërë matjen densitetit kockor kur është e nevojshme (*rekomandim i fugishëm*).

23. Duhet marrë në konsideratë që meshkujt me rrezik të lartë për fraktura gjatë trajtimit të referohen drejt kujdesit sekondar për të vlerësuar dhe filluar trajtimin me bisfosfonate apo denosumab (*rekomandim me kusht*).

24. Meshkujt me probabilitet sipas FRAX afër por nën pragun e sipërm të lejuar, dhe pacientët që marrin terapi tjera shtesë sistemike në veçanti ata që përdorin glukokortikoide, duhet bërë FRAX dhe BMD pas 12-18 muaj pas fillimit që të rivlerësohet gjendja (*rekomandim me kusht*).

3.25.2 Përbledhje e të dhënave evidente

- a. Nuk ka të dhëna evidente që tregojnë se metabolizmi kockor në meshkuj dallon nga gratë në mënyrë fundamentale (269). Megjithatë shkaqet sekondare të osteoporozës janë të zakonshme në meshkuj dhe midis tyre hipogonadizmi është prominent (270). Terapija deprivuese androgjenike (ADT), që përdoret së pari te meshkujt e moshuar për të trajtuar kancerin e prostatës shoqërohet me humbje rapide të densitetit kockor brenda 6-12 muaj pas fillimit të terapisë me ADT (271) (niveli i evidencës Ic). Është vënë re një rritje signifikante e rrezikut nga frakturat në meshkujt me kancer të prostatës 5 vite pas fillimit të terapisë me ADT krahasuar me meshkujt që nuk marrin terapi deprivuese androgjenike (272) (niveli i evidencës Ic).
- b. Bisfosfonatet dhe Denosumabi janë medikamente efektive për pengimin e humbjes së densitetit kockor në meshkuj me kancer të prostatës që marrin terapi hormonale deprivuese të androgjenit megjithëse efektet në rrezikun nga frakturat nuk janë demonstruar. Programet e aktivitetit fizik janë alternativë pak efikase dhe të pamjaftueshme si të izoluara (273) (niveli i evidencës Ib).
- c. Në rishikimet sistematike dhe metaanalizat përmes rrjeteve sociale të gjitha mjekimet që janë evaluuar për humbjen kockore të nxitur nga ADT si bisfosfonatet dhe modulatorët selektivë të receptorëve estrogjenikë (SERM), janë efektivë në përmirësimin e densitetit kockor krahasuar me placebo. Megjithatë, acidi Zoledronik ka rezultuar të jep përmirësimë më të mëdha në densitetin kockor në të gjitha pikat e matjes së densitetit kockor, krahasuar me trajtimet tjera me përjashtim të acidit risedronik që ka treguar përmirësim më të madh të densitetit kockor krahasuar me acidin zoledronik në qafën e femurit. Kjo është vënë re në një studim të vogël (274) (niveli i evidencës IIa).
- d. Në konensusin e fundit të Britanisë së madhe për humbjen e masës kockore si pasojë e terapisë për kancer të prostatës, u konkludua se rreziku nga frakturat duhet kalkular përmes FRAX, duke e konsideruar terapinë derpivuese androgjenke ADT si shkak sekondar të Osteoporozës, dhe realizimin e BDM atje ku aparatura është e pranishme. BMD duhet gjithmonë të matet kur FRAX i llogaritur tregon rrezik sipas NOGG afër pragut terapeutik. Tek meshkujt kur kërkohet terapi protektive kockore, duhet referuar drejt kujdesit sekondar, për t'u ofruar trajtim adekuat, që të reduktohet rreziku për fraktura. Pacientët me FRAX probabilitet afër por nën pragun terapeutik, si dhe pacientët që marrin terapi shështë sistematike (në veçanti ata me glukokortikoide) duhet bërë FRAX me BMD përsëritëse pas 12-18 muajsh (268) (niveli i evidencës IIa).

3.26 Gratë që marrin terapi me inhibitorë të aromatazës

3.26.1 Rekomandimet

25. Të gjitha femrat që fillojnë terapinë me inhibitorë të aromatazës (AI) duhet vlerësuar me FRAX duke konsideruar këto medikamente si shkak sekondar i osteoporozës përfshirë matjet e densitetit kockor kur ekziston mundësia praktike (*rekomandim i fugishëm*).

26. Gratë me rrezik të lartë për frakturne duhet filluar me terapi për parandalimin e osteoporozës dhe frakturnave, me bisfosfonate apo denosumab (*rekomandim i fugishëm*,).

27. Femrat me FRAX probabilitet afër por nën pragun terapeutik dhe pacientët që marrin terapi shtesë sistemike (sidomos ata me glukokortikoide), duhet bërë FRAX me BMD të rivlerësuar pas 12-24 muajsh pas fillimit të terapisë me inhibitorë të aromatazës AI (*rekomandim me kusht*).

28. Nëse terapia agjuvante me bisfosfonate në doza të larta përdoret si pjesë e menaxhimit të kancerit të gjirit, duhet konsideruar vlerësimin e rrezikut nga frakturnat në fund të terapisë me bisfosfonate, sidomos nëse terapia me inhibitorë të aromatazës vazhdon (*rekomandim me kusht*).

3.26.2 Përbledhje e të dhënave

a. Përdorimi i inhibitorëve të aromatazës në gratë pas menopazës nxit humbjen kockore në mesatare 1-3% çdo vit në vendet e insertimit në trabekulën kockore. Humbja kockore vihet re më shumë në femrat e reja që marrin trajtim duke indukuar suprimimin e vezoreve në mesatare 7-8% për çdo vit (275) (niveli i evidencës IIa).

b. Në studimet kontroll-rast, incidenca e frakturnave tek gratë me kancer të gjirit që trajtohen me inhibitorë të aromatazës sillet diku 18-20% pas 5 viteve të përcjelljes (276). Sipas udhëzimeve të NICE për trajtimin e kancerit të hershëm të gjirit, ku dihet rreziku nga osteoporoza si pasojë e përdorimit të inhibitorëve të aromatazës, rekomandohet DXA Scan qysh në fillim, që të vlerësohet densiteti kockor në kohën kur terapia me AI fillohet (277) (niveli i evidencës IV). Qëndrimet ndërkombëtare të këshilleve sugjerojnë se rreziku për frakturne duhet vlerësuar, megjithëse përdorimi i inhibitorëve të aromatazës si shkak sekondar i Osteoporozës mund të mos tregoj saktë rrezikun nga frakturnat (278) (niveli i evidencës IIa), me përdorimin e terapisë për pengimin e humbjes kockore dhe frakturnave atëherë kur T-score < -2, apo më pak se 1.5 me një faktor shtesë të rrezikut, apo në ata me dy apo më shumë faktorë të rrezikut (pa BMD). Trajtimi duhet bërë me bisfosfonate (orale apo parenterale) apo denosumab, në doza sikuse tek osteoporoza pas menopauzës. Denosumab dhe acidi zoledronik që të dy çojnë në rritje të densitetit kockor BMD në pjesën lumbale dhe femurit në gratë pas menopazuës me kancer të gjirit që marrin inhibitorë të aromatazës. Dhe që të dy denosumab dhe acidi risedronik është treguar që reduktojnë rrezikun nga frakturnat (279) (niveli i evidencës

la).

3.27 Menaxhimi frakturave vertebrale simptomatike

3.27.1 Rekomandimet

1. Të administrohen analjetikët nga goja më parë sesa me rrugë parenterale kur është e mundur. Dhimbja duhet të përcillet rregullisht, analgjetiku të titrohet varësisht nga intensiteti i dhimbjes dhe efektet anësore, duke përdor medikamentin me efekt më të dobët për kohë sa më të shkurtër (*rekomandim i fuqishëm*).
2. Duhet shmangur përdorimi i antiinflamatorëvë josteroidë (NSAID) në pacientët e moshuar, por nëse përdoren, duhet përshkuar njëkohësisht edhe një inhibitor të pompës protonike dhe duhet monitoruar përfshirë efektet gastrointestinale, renale dhe kardiovaskulare (*rekomandim i fuqishëm*).
3. Të përshkruhet edhe terapi me laksativë siç janë kombinimi i terapisë që zbut masën fecale dhe stimulantëve, kur opiodet përdoren në të moshuar (*rekomandim i fuqishëm*).
4. Rekomandohet që programet e aktivitetit fizik-ushtrimeve të pasojnë frakturat vertebrale siç janë ushtrimet progresive përfshirë forcë muskulare, forcimi i muskujve ekstensorë të shpinës, apo ushtrimet e zgjatjes (*rekomandim i fuqishëm*).
5. Kur pacienti ka dhimbje mund të këshillohet që fillimi i ushtrimit të bëhen ushtrimet përfshirë muskuj ekstensorë por pa mbingarkesë (*rekomandim me kusht*).
6. Jep udhëzime të qarta sesi duhet adaptuar lëvizjet, sesi ushtrimet ndihmojnë në rregullimin e posturës dhe mënjanimin e dhimbjes, në pacientët me frakturne vertebrale (*rekomandim i fuqishëm*).
7. Sigurohu përfshirë parandalimin e shpejtë të frakturave sekondare duke filluar nga përcjellja e frakturës, përmes shërbimeve të caktuara, në të gjitha gratë pas menopauzës dhe meshkujt 50 vjeç apo më shumë, me diagnostikim të ri të frakturave vertebrale (*rekomandim i fuqishëm*).

Table 15: Monitorimi I terapisë kundër osteoporozës në femrat pas menopauzës dhe meshkujt e moshës 50 vjeçare apo mbi 50vjeç*

Rekomandimet	Fuqia e rekomandimit dhe skatësia e të dhënavë evidente †
--------------	---

6. Monitorimi

- 6.1. Ne sugerojmë realizimin e DXA scan tre vite pas fillimit të trajtimit farmakoterapik. Rekomandimet me kusht . Vërejtje: matja e densitetit kockore mund të përsëritet në intervale kohore me të afërtë në të dhëna evidente me siguri pacientët me shkaqe sekodare të osteoporozës, osteoporozë me frakturne të reja, faktorë të rinjë të ulët të rezikut, shoqëruar me humbje të masës kockore BMD:

‡

6.2. Tre vite pas ndërprerjes së terapisë me bisfosfonate (p.sh. pushim nga Medikamentet), ne sugjerojmë përsëritjen e BMD, vlerësimin e faktorëve të rrezikut, që të përcaktohet nevoja për terapi të reja. Ne sugjerojmë ndjekjen e rekomandimeve për vlerësimin e rrezikut dhe fillimin e farmakoterapisë.

Vërejtje: Vlerësimi i rrezikut në intervale kohore me të shkurtat mund të nevojitet në pacientët me rrezik të lartë për fraktura (si ata me frakturne paraprake të femurit, apo FRAX score të lartë ose CAROC score), shkaqet sekondare të Osteoporozës, frakturat e reja apo faktorët e rinjë të rrezikut shoqëruar me humbje të shpejt të masës kockore.

‡

6.3.4 Ne sugjerojmë që të mos bëhet monitorimi përmes markerëve të rimodelimit kockor, markuesve për pengimin e frakturave apo që të vendosim të rifillojmë terapinë në pacientët që kanë ndërprerë bisfosfonatet (pushim nga terapia)

6.4. Ne sugjerojmë që të mos përdoret FRAX ose CAROC për të monitoruar përgjigjen ndaj famakoterapisë.

6.5 Një praktikë e mirë përfshin vlerësim të rregullt klinik për mundësinë e shfaqjes së frakturave të reja si dhe faktorët e rinjë të rrezikut për fraktura si rëniet, jo përshtatja në terapi, toleranca dhe efektet anësore.

Shënim: Përshtatja në terapinë ndaj Osteoporozës dihet se është e ulët dhe mund të jetë shumë më e ulët në pacientët me sëmundje bashkëshoqëruese, medikamente tjera, efektet anësore, barna që nuk i mbulon sigurimi, apo mungesa e konceptit në lidhje më terapinë ndaj Osteoporozës.

6.6. Praktika e mirë përfshin monitorimin e simptomave të AFF and ONJ në terapi me bisfosfonate dhe denosumab.

Vërejtje: Faktorë të rrezikut për AFF përfshin terapinë më glukokortikoide, kohëzgjatjen e terapisë. Rreziku është i lartë në femrat që janë të dhëna origjinë aziatike. Dhimbyja e pashpjegueshme në kofshë dhe ije duhet të përcillet. Shëndeti i dobët dentar, kirurgjia invasive dentare dhe përdorimi i glukokortikoideve janë faktorë rreziku për ONJ; lezonet e kavitetit oral duhet të përcillen nga dentisti.

Shënim: AFF=atypical femur fracture, BMD=bone mineral density, CAROC=Canadian Association of Radiologists and Osteoporosis Canada tool, FRAX=Fracture Risk Assessment Tool, ONJ = osteonecrosis of the jaw.

Rekomandimet me kusht
të dhëna evidente me siguri
shumë të ulët

Të mos përdoret

Qëndrimi mirë praktik

Qëndrimi mirë praktik

3.27.2 Përbledhje e të dhënave

- a. Frakturat vertebale shkaktojnë dhimbje akute dhe kronike, humbje peshe, deformitet të shpinës dëmtim të formës së trupit, dëmtime funksionale dhe reduktim të kualitetit të jetës (14) (niveli i evidencës Ia).
- b. Analgetikët për dhimbje akute duhet të përdoren me kujdes vetëm me qëllim të kthimit të

funkcionit të lëvizjeve (280-282) (niveli i evidencës IIa).

- c. Në pacientët e pranuar në spital salmon calcitonina e dhënë deri në 4 javë (50-100 IU ditë subkutan ose intramuskular), është treguar efektive si analgetik kundër dhimbjes së përjetuar në lëvizje apo pushim, e lidhur me frakturat vertebruale (283) (niveli i evidencës IIa). Megjithatë efektet anësore (kryesisht fryerjet dhe çrrregullimet gastrointestinale) janë të zakonshme. Duhet kujdes, pasi përdorimi afatgjatë mund të shoqërohet me rritje të rezikut për kancer (284). Nuk ka të dhëna se salmon kalcitonina është trajtim efikas, për dhimbjen kronike që shoqëron frakturat vertebruale (283) (niveli i evidencës Ia). Duhet të cekim se në SPC kalcitonina indikohet për parandalimin e humbjes kockore si pasojë e imobilizimit si p.sh. në pacientët me fraktura osteoporotike, ndërsa shume rrallë vetëm për menaxhimin e dhimbjes.
- d. Një trial i vogël dyfish i randomizuar ka gjetë se dhënia 30 mg intravenoz e acidit pamidronik, është më shumë efikase sesa placebo në reduktimin e dhimbjes (285) (niveli i evidencës IIb). Me rëndësi të ceket se në SPC, acidi pamidronik indikohet për trajtimin e gjendjeve që shoqërohen me rritje të aktvititetit të ostoklasteve sesa për menaxhimin e dhimbjes.
- e. Ushtrimet e mbikqyrura nga fizioterapi pas një frakture vertebruale përmirësojnë performancën fizike dhe ulin dhimbjen (286) (niveli i evidencës Ib). Në prani të dhimbjes do të ishte e këshillueshme që fillimi i bëhen ushtrime për muskujt ekstenzorë të barkut në pozicion jo të sforcuar siç është me shpatulla (287) (niveli i evidencës Ia).
- f. Kombinimi i ushtrimeve me fizioterapi çon në edukim dhe mund të reduktoj frikën nga rrëzimet duke përmirësuar simptomat psikologjike që shoqërojnë individët me fraktura të vertebrave (163,288) (niveli i evidencës Ia).
- g. Për pacientët me fraktura vertebruale të shoqëruara me dhimbje, kemi të dhëna evidente me kualitet të ulët që sugjerojnë mbajtjen e korsetit të butë apo rigjid për 2 orë /24 orë çdo ditë brenda 6 muajve, që mund të përmirësojë forcën muskulare dhe të ulë dhimbjen (287). Aktualisht nuk ka të dhëna se mbajtja e korsetit rigjid apo të butë përmirëson ngjiten e kockës pas frakturës (289). Kështu që mbajtja rutinore e korsetit për trajtimin e frakturave vertebruale akute apo subakute nuk mund të rekomandohet (niveli i evidencës Ia).
- h. Të dhënët aktuale nuk mbështesin mbajten rutinore të balonit kifoplastik për trajtimin e frakturave vertebruale osteoporotike që shoqërohen me dhimbje apo vertebropastikën (287,290) (niveli i evidencës Ia).
- i. Në gra të moshuara me fraktura vertebruale dhe dhimbje kronike të shpinës për 6 muaj apo më shumë, një trial klinik i vogël i randomizuar ka treguar se stimulimi elektrik i nervit, administruar si terapi inferenciale apo horizontale 5 ditë në javë për dy javë mund të ulë dhimbjen për 14 javë (291) (niveli i evidencës IIb).
- j. Pacientët me fraktura aktuale të vertebrave kanë risk të lartë për fraktura fragjile në të ardhmen 51 (niveli i evidencës II b).

k. Nëse një frakturë vertebrale çon në përpaparim të deficiteve neurologjike ekzistuese, duhet referuar urgjent tek kirurgu spinal nëse indikohet..

3.28 Modelet e kujdesit për pengimin e frakturave

3.28.1 Rekomandimet

1. Kordinatori Multidisciplinar mbështetur në FLS rekomandon përcjelljen dhe identifikimin sistematik të meshkujve dhe femrave me fraktura fragjile duke vlerësuar periodikisht frakturnat, rrezikun nga thyerjet e kur është e nevojshme që të përjashtohen shkaqet sekondare të osteoporozës, hulumtimi radiologjik përfshirë matjen e densitetit kockor dhe fillimin e trajtimit farmakologjik dhe jofarmakologjik që të ulet rreziku nga rrëzimet dhe frakturnat (*rekomandim i fugishëm*).
2. FLS duhet të përfshijë sistemet lokale auditive të mbështetur nga të dhënrat për frakturna klinike që mundësojnë monitorimin dhe kujdesin ndaj pacientëve me frakturna [p.sh., Royal College of Physicians FLS-Database] (*rekomandimi i fugishëm*).
3. FLS duhet të përfshijë një numër të strategjive për identifikimin e pacientëve me frakturna fragjile (*rekomandim i fugishëm*).
4. Shërbimet diagnostike imazherike duhet në mënyrë rutinore të evaluojnë pjesën lumbale në të gjitha imazhet te gratë pas menopauzës dhe meshkujt ≥ 50 vjeç ku shpina vizualizohet si dhe duhet raportuar frakturnat vertebrale duke shfrytëzuar metodat standarde (*rekomandim i fugishëm*).
5. Pacientët që iu reakomandohen medikamente ndaj osteoporozës duhet t'u ofrohet informacion mbi osteoporozën dhe trajtimet si dhe rishikime të medikamenteve që të suportohet medikamenti, të diskutohen terapitë alternative, nëse ndodhin efekte anësore të papranueshme, rriten efektet anësore apo adherencë ndodh me vështirësi (*rekomandim i fugishëm*).
6. Klinikistët e mjekësisë primare duhet të kenë gjithmonë në mendje mundësinë për frakturna vertebrale në gratë pas menopauzës ≥ 50 vjeç që paraqiten me dhimbje akute të shpinës, në veçanti dhimbje torakale, nëse ata kanë faktorë të rrezikut për Osteoporozë (*rekomandim i fugishëm*).

3.28.2 FLS modelet e kujdesit

- a. Bashkëpunimi midis klinikistëve të kujdesit primar dhe sekondar, kirurgëve ortopedikë radiologjëve, farmacistëve, si dhe midis disciplinave mjekësore dhe jo mjekësore duhet të synoj programe të ngjajshme për pengimin e frakturnave.
- b. Prgami pës rhëbime të lidhjes së frakturnave (FLS) redukton shkallën e frakturnave duke përmirësuar mbijetesën 292,293 (niveli i evidencës Ia dhe IIb). Departamenti i Shëndetit dhe

NHS RightCare citon se FLS duhet bërë në të gjithë pacientët me frakturna fragile 294,295, që është në linjë me International Osteoporosis Foundation's global Capture the Fracture ® programme 296 si dhe Royal Osteoporosis Society (ROS) FLS Clinical Standards 297.

c. FLS duhet të jap kordinimet, modelet intensive të kujdesit për parandalimin e frakturnave sekondare. FLS modelet bëjnë identifikimin vlerësimin dhe fillimin e trajtimit rekomandimet e kujdesit primar, dhe janë klinikisht më efektive dhe kost-efektive në përmirësimin e prognozës krahasuar me qasjet tjera që përmbajnë identifikimin apo vetëm edukimin e pacientit (298) (Nivel i evidencës Ia). Qasja e duhur është FLS ku identifikimi vlerësimi dhe trajtimi i osteoporozës janë që të gjitha të lidhura brenda një rrjeti elektronik shëndetësor të mbikqyrur nga kordinatori duke shfrytëzuar databazën me performance që matet (296,298-300) (niveli i evidencës Ia).

d. FLS që iniciion trajtimin farmakologjik, para se të bëhen rekomandimet për trajtim për inicimin e kujdesit primar, kanë nivel më të lartë të inicimit të trajtimit (299) (niveli i evidencës Ia). FLS duhet po ashtu të inicojë trajtim adekuat jofarmakologjik dhe duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me profesionistët e kujdesit primar (297). FLS duhet të hartoj një program të koordinuar me një qasje të integruar për pengim të rënieve dhe frakturnave. Të gjithë individët me frakturna duhet të vlerësohen për rrezik nga rrëzimet dhe ndërrhyrje adekuate për të penguar rrëzimet duhet të bëhen (301). Pasi rreziku për refraktura është më i lartë menjehere pas një frakture fragile, parandalimi sekondar i frakturnave, vlerësimi dhe ndërrhyrja terapeutike duhet filluar sa më parë të jetë e mundur, jo më vonë se 16 javë pas frakturnës, siç rekomandohet nga Shoqata e osteoporozës Royal (51,297).

3.28.3 FLS identifikimi i pacientit

e. FLS duhet të zhillojë një numër të strategjive për gjetjen e rasteve, që të identifikohen pacientët me frakturna fragile dhe njerëzit me frakturna vertebrale që zakonisht nuk janë diagnostikuar. Arsyet për mosidentifikimin e frakturnave vertebrale, përfshijnë mungesën e rrezimeve si trigger për intervenim, mungesën e simptomave, ose kur këto simptoma i atribohen shkaqeve tjera. Për më shumë, në pacientët që kanë ekzaminime imazherike të shpinës, shfrytëzimi i terminologjisë së paqartë jo të standardizuar në raportet imazherike, dështimi për të përcjellë në mënyrë rutinore vertebrën në imazheri, apo sistemet tjera të trupit, mund të kontriboj në mosidentifikimin të frakturnave vertebrale. Shoqata e Osteoporozës Royal rekomandon që shërbimet radiologjike duhet të vendosin strukturat lokale që të sigurohen që shpina përcillet në vazhdimësi, për prezencën e frakturnave vertebrale në të gjitha imazhet e disponueshme dhe raportet që identifikojnë frakturnat vertebrale duhet standardizuar, duke shfrytëzuar fjalët 'frakturna vertebrale', janë aktive, dhe indikojnë trajtim në të ardhmen (302) (niveli i evidencës IV).

f. Kujdesi primar luan rol kyç në gjetjen e rasteve me frakturna osteoporotike, në veçanti

frakturat vertebrave që shfaqen si dhimbje akute e shpinës, dhimbja në pjesën torakale është ankesa më e shpështë. Shfrytëzimi i imazherisë spinale ndihmon në rirtjen e mundësisë për identifikim të rasteve, menaxhimin adekuat simptomatik dhe pengimin e frakturave sekondare.

3.28.4 Transmetimi i informatës tek pacienti, zbatimi dhe mbështetja

g. Pacientët që zbulohen nga çfarëdo shërbimi klinik, që të mund të hulumtohen më tej duhet t'u shpjegohet për osteoporozën, shkaktarët, pasojat dhe për mënyrat sesi mund të menaxhohet përmes ndërhyrjeve terapeutike dhe joterapeutike. Kur diskutohet për trajtimin farmakologjik duhet që pacientit t'i shpjegohet se pse rekomandohen medikamentet, benefitet, efektet anësore të zakonshme apo të rënda, rëndësia praktike e marrjes së medikamenteve dhe për sa kohë duhet të përdoren 303 (niveli i evidencës IV). Komunikimi me pacientë, shpjegimi i raportit benefit-risk, mundësia për të vendos, ka treguar një përmirësim në marrjen e vendimeve, duke reduktuar konfliktin gjatë vendimmarrjes për terapi, si dhe ka përmirësuar qasjen e pacientit ndaj rrezikut për fraktura (304) (niveli i evidencës Ib). Informacioni duhet t'u përshtatet nevojave të pacientit, andaj duhet të jetë i pranueshëm dhe i kuptueshëm, përfshirë edhe informacionin me shkrim (305).

h. Që të përcillet përshtatja ndaj mjekimit, profesionistët shëndetësorë duhet adresuar çdo benefit apo shqetësim që shoqërohet me uljen e përshtatjes ndaj medikamentit, duke tentuar të vendosim pritet reale nga trajtimi me pacientin (303,305). Asnjë nga tipet e terapisë nuk është demonstruar që të nxise përshtatjen ndaj medikamentit. Modelet me pjesëmarrje aktive të pacientit kanë më shumë efekte pozitive, modelet me kyçje direkte të pacientit kanë më shumë efekte pozitive (306,307) (niveli i evidencës Ia). FLS modelet me numër më të madh të pacientëve kanë treguar efekte klinike më të mëdha. 300 (niveli i evidencës Ia). NOGG mbështetë rekomandimet e Shoqatës Osteoporotike të Royal formë prospektive 16 javë dhe 52 javë pas frakturave që të rishikohet përdorimi i medikamenteve që risin rrezikun nga rëniet dhe frakturat, të sigurohemi për pëershkrimin e kalciumit dhe vitaminës D me medikamentet protektive kur indikohen, të përcillen efektet anësore dhe monitorohet përshtatja në terapi (297).

3.29 Rekomandimet për trajnim të pofesionistëve shëndetësorë

3.29.1 Rekomandimet

Rekomandohet që:

1. Trajnimet të janë personale duke përfshirë marrjen e vendimeve, kurrikulat e trajnimit në specialitetet e mjekësisë relevante dhe kirurgjike (*rekomandim i fuqishëm*).

2. Trajnimet për sëmundjet metabolike dhe osteoporozës janë komponencë e çdo specialiteti kirurgjik apo të mjekësisë relevante. Kurrikulat trajnuese profesionale dalin nga Kolegjet (*rekomandim i fugishëm*).
3. Mjekët e përgjithshëm duhet të kenë trajnime të mjaftueshme, me qasje në të dhënat evidente bazë si dhe në udhërrëfyesit, po ashtu, zhvillimin e vazhdueshëm profesional (CPD) me qëllim të ruajtjes dhe freskimit të njohurive (*rekomandim i fugishëm*).
4. Menaxhimi i Osteoporozës është pjesë e trajnimit në të gjitha disciplinat (*rekomandim i fugishëm*).
5. Trajnimi duhet bërë nga personeli i Shërbimit për Frakturat që të realizohet DXA me kualitet të lartë dhe të raportohet (*rekomandim i fugishëm*).
6. Trajnimet e përmirësimit me kualitet të lartë duhet bërë më tej prej personelit shëndetësor përgjegjës (*rekomandim i fugishëm*).

3.29.2 Përbledhje e të dhënave

- a. Menaxhimi i osteoporozës dhe rreziku nga frakturat fragjile nuk bëhet vetëm nga një specialitet i veçantë. Specialitetet relevante mjekësore dhe kirurgjike përfshirë praktikën e përgjithshme, reumatologjinë, kirurgjinë ortopedike, endokrinologjinë, mjekësinë metabolike, geriartrinë dhe obstetrikën me gjinekologji. Për më tepër, kujdesi për pacientët me osteoporozë është përgjegjësi e profesionistëve shëndetësorë të shumtë përfshirë infermieret, fizioterapistët, terapistët profesionistë, farmacistët dhe operatorët e DXA scan. Natyra multidisciplinare e osteoporozës ofron mundësi për trajnime të specialiteteve të ndryshme.
- b. Dihet se profesionistët e kujdesit primar kanë rol kryesor në identifikimin e popullatës me rrezik për frakturne fragjile, si dhe në menaxhimin afatgjatë të pacientëve me osteoporozë. Është më rëndësi se mjekët e kujdesit primar të kenë njohuri dhe trajnime të mjaftueshme në këtë fushë me qasje në udhërrëfyes dhe module online përfshirë freskim të njohurive.
- c. Roli i zakonshëm i profesionistëve të kujdesit shëndetësorë është që të formohen qendra për kujdes ndaj pacientit, angazhim kyç i dalë nga NHS arritur më 2023/24. Kujdesi i personalizuar është një partneritet që ndihmon njerëzit të mbahen të informuar dhe të zgjedhin për shëndetin e tyre, mirëqenien e tyre duke punuar dhe ndjekur informacionin klinik [Personalised Care Institute 2020].
- d. Ekzistojnë variacione të shumta sa i përket qasjes në shërbimet e DXA të vendosura sipas FLS. Përkundër iniciativave prej dy dekadave të trajnimeve përfshirë densitometrinë në Osteoporozë, shumë qendra kanë dështuar të plotësojnë standartet sipas kriterëve esencialë të Osteoporosës IOF-ISCD (308).

e. Përmirësimi i kualitetit të jetës në pacientët me osteoporozë dhe frakturna ndhmon në përmirësimin e kujdesit shëndetësor si dhe rrit sigurinë dhe efikasitetin. Përmirësimi kualitativ përfshin qasjen e koordinuar dhe sistematike për zgjidhjen e problemeve duke shfrytëzuar metodat specifike dhe mjetet me qëllim të përmirësimt të teknikave të matjes në qendrat e kujdesit shëndetësor (309), dhe mund të arrihet përmes përdorimit të mjeteve përkatëse (p.sh., *Royal Osteoporosis Society Fracture Liaison Service Implementation Toolkit*).

3.29.3 Shembuj nga trajnimi përkatës

Trajnimi në kujdesin e personalizuar

Insituti për kujdes të personalizuar është organizatë virtuale e njohur për zbatimin e standardeve për trajnime të evidentuara në kujdesin personal në Angli. Kurrikulumi i Insitutit për kujdes të personalizuar nxjerr në pah standartet për programet trajnuese që duhet akredituar me Institutin për kujdes të personalizuar. Ky Institut përmban modulet si shembull për ndarjen e vendimeve. Kurrikula është dizajnuar është personelin e kujdesit shëndetësor, brenda ekipeve të kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar si dhe ekipeve të komunitetit <https://www.personalisedcareinstitute.org.uk>.

3.29.4 Rekomandimet për komisionerët e kujdesit shëndetësor

Në vitin 2017, Grupi koordinues kombëtar për parandalimin e frakturave dhe rrëzimeve së bashku me departamentin e shëndetit publik të Anglisë kanë prodhuar konsensusin që ka për qëllim reduktimin e rrëzimeve dhe rrezikut nga frakturat, përmirsimin e menaxhimit të frakturave, përfshirë trajtimin sekondar (<https://www.gov.uk/government/publications/falls-and-fractures-consensus-statement>).

Udhëzuesi ka për qëllim senzibilizimin e komiteteteve lokale dhe vendeve strategjke duke i kujtuar për rëniet, shëndetin kockor, zhvillimin e frakturave, dhe rrëzimeve. Rruja e cila definon tri prioritet që komisionerët (<https://www.england.nhs.uk/rightcare/products/pathways/falls-and-fragility-fractures-path.way/>) përgjegjës përrëzime dhe frakturna fragjike duhet t'i konsiderojnë si prioritet.

1. Pengimi i rrëzimeve
2. Detektimi dhe menaxhimi i osteoporozës
3. Mbështetja optimale pas frakturave fragjile.

ROS ka zhvilluar Shërbimin për frakturna *Toolkit* (<https://theros.org.uk/healthcare-professionals/fracture-liaison-services/implementation-toolkit/>) të dizajnuar për të mundësuar punën e komisionerëve.

Në Angli lëvizja drejt Sistemit të Integruar (ICS) ka përparësi pasi nxit mekanizmat e kujdesit për pacientët me rrezik për frakturne fragjile, përfshirë rrezikun minimal për frakturne si pjesë e shërbimit rutinë, duke bërë të mundur referimet direkte të rasteve midis shërbimeve sekondare .

Kur foni për shërbime shëndetësore nuk ka arritur rekomandimet e mëposhtme përmes strukturave të komisionit, atëherë i drejtohen fondit për kujdes shëndetësor dhe bordeve lokale të shëndetësisë. Kështu në Uells këto rekomandime i drejtohen qeverisë së Uellsit dhe bordeve lokale të shëndetësisë (që rembursohen direkt nga Qeveria e Uellsit) si dhe planet e integruar afatmesme (IMTP). Në Irlandën Veriore kujdesi shëndetësor dhe Social është i integruar dhe është përgjegjësi e Departamentit të Shëndetësisë. Shërbimet shëndetësore janë të formuara nga Bordet për kujdes shëndetësor dhe social (HSCB) përmes grupeve të përbëra nga pesë Lidhje të Shoqatave për kujdes shëndetësor dhe Social.

3.29.5 Rekomandimet

Mbështetur në të dhënat evidente të prezantuara në këtë udhërrëfyes, NOG-ja ka bërë rekomandimet liderëve të shërbimeve dhe komisionerëve të kujdesit shëndetësor, si më poshtë:

1. Duhet ditur se frakturnat si pasojë e osteoporozës janë signifikante dhe një çështje në rritje e shëndetit publik me pasoja të mëdha në shëndet, nivel socio-ekonomik, si dhe duhet të sigurohemi që frakturnat fragjile të adresohen në programet lokale të kujdesit shëndetësor (*rekomandim i fugishëm*).
2. Duhet të sigurohemi se programet lokale të kujdesit shëndetësor i adresohen nevojës për reduktimin e prevalencës së faktorëve të rrezikut të osteoporozës dhe frakturnave të lidhura me rrëzimet dhe shëndetin e dobët kockor, kështu duhet ngritur rolin e të dyjave pra NHC-së dhe agjencioneve të tjera (*rekomandim i fugishëm*).
3. Duhet të sigurohemi se sistemet elektronike të regjistruara kanë FRAX, lidhje me faqen NOGG të integruar ku identifikohen pacientët dhe shënohet trajtimi i atyre me risk për frakturne në mënyrë elektronike. Është e nevojshme të mundësohet komunikimi midis qendrave primare shëndetësore dhe FLS (*rekomandim i fugishëm*).
4. Dosjet duhet të ruhen ashtu që pacientët me rrezik të lartë për frakturna kanë mundësinë t'i nështrohen hulumtimeve përkatëse (p.sh. vlerësimin e rrezikut nga frakturnat, rrezikut nga rrëzimet, matjen e densitetit kockor), stilin e jetesës (p.sh. dietat, ushtrimet dhe duhanpirja) si dhe Medikamentet për mbrojtjen kockore [NICE Quality Standards 149, 2017]. Më vonë është përfshirë edhe disponueshmëria e medikamenteve parenterale në kujdesin primar dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor (*rekomandim i fugishëm*).
5. Duhet që avokatëve të kujdesit shëndetësor dhe këshilltarëve profesionalë t'u sigurohet informacion i përditësuar në lidhje me ndërhyrjen terapeutike sidomos te gratë pas menopauzës dhe meshkujt ≥ 50 vjeç, kështu që pacienti të mund të marrë vendim në lidhje me trajtimin dhe

përshtatjen në trajtim (*rekomandim i fugishëm*).

6. Sistemet e integruar të Kujdesit (ICS) duhet adresuar në mënyrë specifike kufirin për frakturne fragjile në zonat lokale dhe të sigurojnë njerëzit se shërbimet për frakturna janë të disponueshme për të gjithë pacientët me frakturne fragjile (*Liaison Services*) (*rekomandim i fugishëm*).

7. ICS duhet të bëj bashkë specialistët lokal, mjekët e përgjithshëm dhe bartësit tjerë të çeshtjes përfshirë prezantuesit, që të pajtohen për trajtimet lokale si dhe për mekanizmat menaxhuese për osteoporozën dhe pengimin e frakturnave fragjile. Është shpesh e nevojshme që të identifikohen klinikistët udhëheqës si në kujdesin primar edhe atë sekondar. Këto rekomandime duhet të mbajnë të dhëna edhe për kost-efektivitetin, burimet lokale, udhërrëfyesit lokal duhet të përmbajnë të dhëna të paraqitura në këtë udhërrëfyes. Nëse udhërrëfyesit janë miratuar, ata duhet të shpërndajnë informacionin profesionistëve shëndetësorë dhe pacientëve, të shikohen ndryshimet eventuale e më pas të implementohen. Implementimi nuk duhet vonuar dhe ndryshimet praktike të nevojshme duhet bërë (*rekomandim i fugishëm*).

3.30 Rishikimi i kriterëve për përmirësim cilësor dhe afatgjatë

3.30.1 Standardet cilësore për Osteoporozë

Katër standarde cilësore për osteoporozën janë prodhuar nga *National Institute for Health and Care Excellence (NICE)* në vitin 2017 (QS149) (<https://www.nice.org.uk/guidance/qs149>).

Shtatë kualitete standarde për osteoporozën dhe pengimin e frakturnave fragjile janë prodhuar nga *Royal Osteoporosis Society* në vitin 2017 (<https://theros.org.uk/media/0dillsrh/ros-op-standards-novem-ber-2017.pdf>)

3.30.2 Kujdesi primar

Dosja për numrin e grave në postmenopauzë me moshë mesatare ≥ 50 vjeç, regjistruar nga praktika e përgjithshme:

- a) Numri kodues për frakturna, që ka për qëllim të vlerësoj nëse frakturna është fragjile (nga trauma e vogla)
- b) Me një apo më shumë faktorë të rrezikut për frakturne fragjile, e që marrin vlerësim formal për rrezikun nga frakturnat.
- c) Frakturnat primare fragjile, me DXA scan të regjistruar.
- d) Në individët që kanë marrë terapi, është llogaritur FRAX dhe ka rezultuar se rreziku për frakturna është i lartë.
- e) Incidencë për frakture të femurit në ndividët që kanë marrë terapi farmakologjike për osteoporozë 16 javë pas frakturnës.

- f) Pacientëve që iu është përshkruar terapi farmakologjike për Osteoporozën dhe që kanë konfirmuar përshtatjen në terapi brenda 12 muajve.
- g) Që iu është përshkruar terapi farmakologjike për osteoporozën dhe që janë përcjellur për 5-10 vite.
- h) Pacientëve që iu është përshkruar denosumab, të cilët kanë marrë injekzionin e radhës sipas protokolit (brenda 4 javësh të datës së radhës).
- i) Atyre që janë në terapi me glukokortikoide ≥ 3 muaj që u është vlerësuar reziku nga frakturat.
- j) Me diskutim të dokumentuar për vlerësimin e rrezikut nga frakturat dhe zgjedhjen e trajtimit.

3.31 Përkrahja e pacientit për vetëmenaxhim të sëmundjes

